



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 298 Akti

Nr. 307 Vendimi
Tiranë, më 12.10.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesuese
Olsi Komici	Relator
Pamela Qirko	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, në datën 9.10.2020, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Etleva Temo**, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Korçë, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, znj. Etleva Temo, vëzhguesin ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore publike, në tërësinë e tij, vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Etleva Temo, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, ushtron detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Apelit Korçë dhe në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.3.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, short nga i cili rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët, Pamela Qirko, Olsi Komici dhe Firdes Shuli. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioneri Olsi Komici.

3. Me vendimin nr. 1, datë 21.3.2019, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Etleva Temo, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe rivlerësimin e aftësisë profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Firdes Shuli. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes.

Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Branko Hrvatin.

4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim, Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim, ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim, DSIK) dhe Grupi i Punës në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.

5. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

6. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datë 22.9.2020, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Etleva Temo, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 22.9.2020 mbi përbërjen e trupit gjykues, mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfutuara nga hetimi kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

8. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me rezultatet e hetimit në datën 6.10.2020, ka dërguar nëpërmjet postës elektronike prapësimet, si dhe provat në lidhje me rezultatet e hetimit të dërguara nga Komisioni.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë në rrugë elektronike, në datën 7.10.2020.

10. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, datë 9.10.2020, ora 10:00, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin.

11. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe parashtroi shpjegimet e saj në seancë, si dhe i depozitoi ato me shkrim në Komision.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit znj. Etleva Temo, kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

12. Znj. Etleva Temo ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

13. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

14. Për subjektin e rivlerësimit, znj. Etleva Temo, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshin të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

15. Pavarësisht se në kreun IV të ligjit nr. 84/2016 2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me këtë vlerësim pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetues dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

16. Me shkresën nr. *** prot., datë 21.5.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Temo, i cili është subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së që prej vitit 2003, me numër indeksi ***, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të

zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

17. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2003 deri në vitin 2016 dhe referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë - shtojca 2, në datën 30.1.2017. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për çdo pasuri të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ILDKPKI-ja ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

18. Bazuar në ligjin nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Referuar neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- b) deklaratën e pasurisë - shtojca 2 dhe deklaratat periodike të pasurisë ndër vite;
- c) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkrese/dokumentet, të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, si nga: Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Banka e Shqipërisë dhe të gjitha bankat e nivelit të dytë, drejtoritë vendore të Kadastrës, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, drejtoritë rajonale të tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., shoqëria Ujësjellës-Kanalizime sh.a., zyra noteriale, DRSSH-të etj;
- e) deklarime dhe prova të dërguara nga subjekti i rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- f) shpjegimet me shkrim të subjektit, si dhe shpjegimet në seancën dëgjimore.

19. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, si dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të pasurive në pronësi apo përdorim; dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë situatë konflikti interesi, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

20. Në lidhje me dorëzimin e deklaratës së pasurisë - shtojca 2, në zbatim të nenit 31/1¹, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (duke përfshirë edhe personat e lidhur me të), në bazë të ligjit nr. 84/2016, në datën 27.1.2017, brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi.

- Pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *Vetting*

¹ Subjekti i rivlerësimit ka detyrim të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë pranë ILDKPKI-së.

1. Apartament banimi me sip. 79.7 m², ndodhur në rrugën “**”, Pogradec, sipas certifikatës së pronësisë, datë 10.8.2009, blerë me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 8.8.2009, me vlerë 4,303,800 lekë. Pjesa takuese: 50% në bashkëpronësi me bashkëshortin.**

1.1 Burimi i krijimit: (a) kredi në shumën 25,000 euro, sipas kontratës së kredisë², datë 9.7.2008; (b) nga shitja e apartamentit me sip. 56 m², ndodhur në Pogradec³, në shumën 1,700,000 lekë, sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 22.12.2008.

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

1.2 Apartamenti është deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të pasurisë të vitit 2008 (DIPP në vijim), si vijon: *“Apartament banimi me sip. 78.9 m², L. ***, Pogradec i paregjistruar, i porositur me kontratë paraprake me vlerë 4,300,000 lekë, datë 9.7.2008, me shitës G.K., në bashkëpronësi me bashkëshortin. Apartamenti është blerë nga shitja e banesës së mëparshme në shumën 1,700,000 lekë me kontratën⁴ e datës 22.12.2008 plus shuma e marrë kredi 25,000 euro”.*

1.3 Subjekti ka depozituar: (i) kontratën e shitblerjes⁵, datë 8.8.2009, me shitës G.K. dhe blerës Etleva Temo, për apartamentin me sip. 79.7 m² me adresë L. ***, rruga “****”, Pogradec, me çmimin 4,303,800 lekë, shumë e cila është paguar para redaktimit të kësaj kontrate jashtë zyrës noteriale; si dhe (ii) certifikatën e pronësisë, datë 10.8.2009, për këtë apartament.

1.4 ASHK-ja, Zyra Vendore Pogradec⁶ konfirmon regjistrimin në emër të znj. Etleva Temo të pasurisë së llojit “apartament” me sip. 79.7 m² dhe 12 m² sipërfaqe të përbashkëta, me adresë rruga “****”, sh. ***, ap. ***, Pogradec, i përfituar me kontratën e shitblerjes⁷, datë 8.8.2009, për çmimin 4,303,800 lekë, shumë e paguar përpara redaktimit të kontratës jashtë zyrës noteriale.

1.5 ILDKPKI-ja⁸ ka përcjellë pranë Komisionit dokumentacionin e depozituar nga subjekti kur është thirrur për të dhënë shpjegime në datën 30.3.2015, ku rezulton të jetë depozituar edhe kontrata e sipërmarrjes datë 9.6.2008⁹, të cilën nuk e ka depozituar së bashku me deklaratën Vetting. Kjo kontratë është lidhur me sipërmarrësin G.K. dhe porositës Etleva Temo për ndërtimin e apartamentit me sip. 79.7 m², me çmimin 54,000 lekë/m², pagesë e cila do likuidohet si vijon:

Kësti i parë prej 1,000,000 lekësh do t’i paguhet sipërmarrësit, sot ditën e redaktimit të kontratës; kësti i dytë prej 3,100,000 lekësh do të likuidohet në momentin e përfundimit si karabina të apartamentit dhe mureve ndarëse; dhe kësti i tretë prej 203,800 lekësh do të likuidohet pasi të jenë kryer të gjitha punimet për ndërtimin e apartamentit...etj.

² Kontrata nr. *** (lapsus nga subjekti, referencat janë të kontratës së kolateralit), kontrata e kredisë nr. ***, datë 9.7.2008. Për marrjen e kësaj kredie si kolateral është vendosur apartamenti në bashkëpronësi me bashkëshortin dhe prindërit e tij, e ndodhur në Pogradec në rrugën “****”, p. ***, ap. ***, shk. ***, k. ***, ndërtuar në vitin 1974 përfituar nga ligji për privatizimin.

³ Ndërtim i viteve 1980, z. k. ***, i blerë me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 20.6.2005, në shumën 1,300,000 lekë me shumën e dhënë hua nga motra E.N. sipas kontratës së huas nr. *** rep., datë 14.6.2005, shumën 1,000,000 lekë me afat 5-vjeçar pa interes³ dhe shumën 300,000 lekë kursime familjare).

⁴ Kontratën nr. ***, datë 22.12.2008.

⁵ Kontrata e shitblerjes së apartamentit me sip. 79.7 m² me nr. ***, datë 8.8.2009.

⁶ Zyra Vendore Pogradec me nr. *** prot., datë 19.5.2020.

⁷ Kontrata shitblerje apartamenti me sip. 79.7 m² me nr. ***, datë 8.8.2009.

⁸ ILDKPKI me nr. *** prot., datë 30.1.2020.

⁹ Kontrata e sipërmarrjes së apartamentit me sip. 79.7 m² me nr. ***, datë 9.6.2008.

1.6 Komisioni ka analizuar çmimin e blerjes së apartamentit me sip. 79.7 m², duke e krahasuar me çmimin referues të publikuar nga EKB-ja për vitin 2008¹⁰ dhe me çmime në kontrata të ngjashme të lidhura nga sipërmarrësi dhe, pavarësisht, çmimit relativisht më të lartë të blerjes nga subjekti nuk vlerësohet si situatë që përbën problematikë që e ngarkon me përgjegjësi atë.

1.7 Shoqëria “***” sh.p.k. (me administrator G.K.) ka konfirmuar se shtetasit A. (A.) T. dhe Etleva Temo nuk kanë detyrime ndaj shoqërisë.

Komisioni nuk ka konstatuar ndonjë problematikë në lidhje me çmimin e blerjes së apartamentit.

1.8 Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2009 nuk ka deklaruar kontratën e shitblerjes¹¹, datës 8.8.2009, për apartamentit me sip. 79.7 m².

Në lidhje me këtë konstatim, subjekti ka shpjeguar se: *“Në deklaratën periodike të vitit 2009, ashtu si edhe në deklaratimet e mëparshme kam deklaruar ‘kredi për blerje apartamenti’, dhe duke qenë se kam deklaruar detyrimet për blerjen e apartamentit dhe kontratën e sipërmarrjes, ndoshta kjo është një harresë nga ana ime, pasi në fakt është një formalizim i detyrimeve të deklaruara”.*

1.9 Në lidhje me pagesat e bëra shtetasit G.K. për apartamentin me sip. 79.7 m², subjekti ka shpjeguar se: *“Pagesat e bëra shtetasit G.K. për apartamentin me sip. 79.7 m², i provoj me mandatarkëtimet: datë 22.7.2008 dhe datë 29.12.2008, si edhe me nxjerrje llogarie, nga “Tirana Bank”, duke depozituar: (i) mandatarkëtim “***”, datë 22.7.2008, arkëtuar nga A.T. në shumën 24,490 euro për subjektin “***” sh.p.k., me përshkrim ‘likuiduar në Tirana Bank në datën 15.7.2008, në shumën 19,490 euro dhe datë 22.7.2008, në shumën 5,000 euro me kurs leuro/122 lekë, arkëtari E.K.; dhe (ii) nmandatarkëtimi nr. ***, datë 29.12.2008, arkëtuar nga A.T., në shumën 1,316,000 lekë për subjektin “***” sh.p.k., me përshkrim ‘likuidim kësti për blerje apartamenti’, arkëtari E.K.”.*

1.10 Nga përgjigjja e administruar nga “Tirana Bank”, është konfirmuar se në datën 15.7.2008 është transferuar në favor të shoqërisë “***” sh.p.k., shuma 19,490 euro me përshkrimin *“blerje apartamenti”* dhe në datën 22.7.2008 është transferuar shuma 5,000 euro në favor të shoqërisë “***” sh.p.k., me përshkrimin *“shlyerje detyrimi”* (në total shuma 24,490 euro).

1.11 Nga verifikimi kryer nga Komisioni në faqen zyrtare të QKB, rezulton se shoqëria “***” sh.p.k., është regjistruar në datën 16.8.2005 me ortak shtetasit G. dhe G.K. Shtetasi G.K. është bërë ortak dhe administratori i kësaj shoqërie në datën 5.2.2018 (G.K. është vëllai i G.K. konfirmuar ky fakt dhe nga vendimi i ortakut të vetëm të shoqërisë “***” sh.p.k., G.K. nr. ***, datë 26.1.2018).

1.12 Komisioni ka hetuar mbi ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit Etleva Temo me shtetasit G. e G.K. dhe shoqërinë “***” sh.p.k., duke kryer korrespondencë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe Gjykatën e Apelit Korçë.

1.13 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec¹² konfirmon se për periudhën 1997 – 2014, ku subjekti ka ushtruar detyrën e gjyqtarës, nuk rezulton që shtetasit G. e G.K., si dhe shoqëria “***” sh.p.k., të kenë pasur çështje gjyqësore pranë kësaj gjykate që të jenë gjykuar nga subjekti i rivlerësimit.

¹⁰ Udhëzimi nr.1, datë 20.8.2008, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërimit të banesave nga EKB-ja për vitin 2008.

¹¹ Kontratë e depozituar nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

¹² Gjykata e Rrethit Pogradec me nr. *** prot., datë 27.4.2020 dhe me nr. ***, datë 27.4.2020.

1.14 Gjykata e Apelit Korçë¹³ konfirmon se për periudhën 2014 dhe në vijim nuk rezulton që shoqëria “****” sh.p.k. dhe shtetasit G.K. dhe S.D. të kenë pasur çështje gjyqësore të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit.

Gjykata e Apelit Korçë¹⁴ konfirmon se shtetasi G.K. ka pasur pranë kësaj gjykate një çështje gjyqësore me të pandehur G.K. për veprën penale të ndërtimit të paligjshëm. Kjo çështje është gjykuar nga trupa gjykuese ku subjekti Etleva Temo ka qenë anëtare e saj. Gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr. ***, datë 16.12.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec për deklarimin e pafajshëm të G.K. Në vitin 2014, shtetasi G.K. nuk ka qenë administrator apo ortak i shoqërisë “****” sh.p.k.

Nuk është konstatuar situatë konflikti interesi e subjektit të rivlerësimit me shtetasit G. dhe G.K., si dhe me shoqërinë “**” sh.p.k.**

1.15 Komisioni, referuar deklarimit në lidhje me këtë pasuri, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar pasurinë apartament me sip.79.7 m², në DIPP-në e vitit 2009 (referuar kontratës së shitblerjes së këtij apartamenti, datë 8.8.2009).

Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera, se meqenëse në DIPP-në e vitit 2009, ashtu si edhe në deklaratimet e mëparshme ka deklaruar “kredi për blerje apartamenti” dhe duke qenë se ka deklaruar detyrimet për blerjen e apartamentit dhe kontratën e sipërmarrjes (ndoshta kjo është një harresë prej subjektit), pasi në fakt është një formalizim i detyrimeve të deklaruara.

1.16 Komisioni arrin në përfundimin se pavarësisht shpjegimeve të subjektit dhe faktit që ka deklaruar “kredi për blerje apartamenti”, si dhe detyrimet për blerjen e apartamentit dhe kontratën e sipërmarrjes, subjekti kishte detyrimin që të deklaronte pasurinë në DIPP-në për vitin 2009, sipas nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar. Ky mosdeklarim e bën këtë deklaratë të pasaktë në kuptim të pikës 5/a, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Por, duke qenë se mosdeklarimi nuk rezulton që të jetë bërë me qëllim fshehjen e pasurisë, Komisioni nuk e çmon këtë pasaktësi si një shkak më vete për dhënie të masës disiplinore, por e vlerëson atë në tërësinë e rrethanave të çështjes, në konsideratë edhe të pasaktësive të tjera të konstatuara për subjektin.

1.17 Analizë burimeve financiare të përdorura për blerjen e apartamentit me sip. 79.70 m², ndodhur në Pogradec.

1.17.1 Analizë burimit të parë – kredi në shumën 25,000 euro, sipas kontratës së kredisë, datë 9.7.2008¹⁵.

1.17.2 Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar: “Kontratë kredie bankare nr. ***, datë 9.7.2008, në shumën 20,000 euro për blerje apartamenti, kredi konsumatore 5,000 euro dhe kredi 100,000 lekë për visa card ...”.

1.17.3 Subjekti ka depozituar kontratën e kredisë bankare¹⁶, datë 9.7.2008, të lidhur me “Tirana Bank” si kredidhënës dhe shtetasve Etleva dhe A.T. si kredimarrës, me të dhënat si më sipër, për një afat 132 muaj për kredinë në shumën prej 20,000 euro dhe 120 muaj për kredinë konsumatore në shumën 5,000 euro. Për të garantuar shlyerjen e kredisë, kredimarrësit kanë

¹³ Gjykata e Apelit Korçë me nr. ***, datë 24.4.2020.

¹⁴ Gjykata e Apelit Korçë me nr. *** prot., datë 30.4.2020.

¹⁵ Kontrata e kredisë nr. ***, datë 9.7.2008.

¹⁶ Kontrata e kredisë nr. ***, datë 9.7.2008. “Tirana Bank”.

vënë në hipotekë (me kontratë hipotekimi të datës 9.7.2008) apartament me sip. 70 m² me adresë L. ***, “***”, në pronësi të shtetasve A., A. (A.), V. dhe Etleva Temo.

1.17.4 Nga transaksionet bankare rezulton se kreditë në shumat 20,000 euro dhe 5,000 euro i janë disbursuar subjektit në datën 15.7.2008 dhe po në këtë datë është transferuar në favor të shoqërisë “***” sh.p.k.m shuma 19,490 euro me përshkrimin “blerje apartamenti”, ndërsa në datën 22.7.2008, është transferuar shuma 5,000 euro në favor të shoqërisë “***” sh.p.k. me përshkrimin “shlyerje detyrimi”.

Komisioni nuk ka konstatuar problematika në deklaram dhe në dokumentacion në lidhje me kredinë e përdorur për blerjen e apartamentit.

1.17.5 Analizë për të ardhurat e përfituara nga shitja apartamentit me sip. 56 m², në Pogradec, që kanë shërbyer si burim krijimi për blerjen apartamentin me sip. 79.70 m²

1.17.6 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se: “*Apartamenti me sip. 56 m² është blerë me kontratën e shitblerjes, datë 20.6.2005¹⁷, për çmimin 1,300,000 lekë, me: (i) shumën e dhënë hua nga motra E.N. sipas kontratës së huas, datë 14.6.2005¹⁸, prej 1,000,000 lekësh me afat 5-vjeçar pa interes; dhe (ii) shumën 300,000 lekë kursime familjare*”.

1.17.7 Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar: “*Apartament me sip. 56m², L. ***, Pogradec, ndërtuar para vitit 1990, në vlerën 1,300,000 lekë*”. *Pjesa takuese: 100%*”. Nuk është deklaruar burim krijimi, ndërsa në DIPP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar: “*...nga shitja e apartamentit me sip. 56 m², ndodhur në Pogradec, në shumën 1,700,000 lekë sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 22.12.2008*”.

1.17.8 Subjekti ka depozituar: (i) kontratën e blerjes, datë 20.6.2005¹⁹, me shitës shtetasit B., M., A., B. dhe M.M. dhe blerës Etleva Temo për apartamentin me sip. 56 m² me çmimin 1,300,000 lekë; (ii) kontratën e shitjes së apartamentit, datë 22.12.2008²⁰, me shitës E.Z. dhe blerës S.D. për çmimin 1,700,000 lekë; dhe (iii) certifikatën për vërtetim pronësie në emër të shtetasit S.D., lëshuar në datën 29.1.2009.

1.17.9 Nga dokumentacioni i depozituar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Pogradec²¹, ka rezultuar se apartamenti me sip. 56 m² i përfituar nga subjekti Etleva Temo me kontratën e datës 20.6.2005 (për çmimin 1,300,000 lekë), i është shitur prej saj me kontratën e shitjes së datës 22.12.2008, z. S.D. me çmimin 1,700,000 lekë.

1.17.10 Komisioni ka analizuar çmimin e blerjes dhe atë të shitjes së apartamentit me sip. 56 m² prej subjektit, duke e krahasuar me çmimet e referencës sipas EKB-së nga ku rezultoi se çmimi i blerjes prej 1,300,000 lekësh është dukshëm më i ulët se çmimi i referencës të përcaktuar në Udhëzimin e vitit 2005²² prej 2,497,712 lekësh (56 m² x 44,602 lekë) dhe nga ana tjetër çmimi i shitjes nga subjekti prej 1,700,000 lekësh është përsëri dukshëm më i ulët se çmimi i referencës i përcaktuar me Udhëzimin e vitit 2008 prej 2,423,288 lekësh (56 m² x 43,273 lekë).

Në të dyja rastet, si në blerje ashtu dhe në shitjen e apartamentit me sip. 56 m², duket se nga subjekti nuk është pasqyruar çmimi real krahasuar me çmimet referuese të EKB-së.

¹⁷ Kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 20.6.2005.

¹⁸ Kontrata e huas nr. *** rep., datë 14.6.2005.

¹⁹ Kontrata e blerjes së apartamentit me sip. 56 m² me nr. ***, datë 20.6.2005.

²⁰ Kontrata e shitblerjes së apartamentit me 56 m² nr. ***, datë 22.12.2008.

²¹ ASHK-ja Pogradec me nr. *** prot., datë 9.6.2020.

²² Udhëzimi nr. 5, datë 23.11.2005, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB për vitin 2005”.

1.17.11 Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *“...apartamenti është ndërtim i viteve 80’ dhe jo ndërtim i ri. Në atë kohë po kërkonim apartament pasi për shkak të jetesës në një banesë bashkë me prindërit e bashkëshortit kishim sipërfaqeje të vogël banimi. Çmimi i ofruar na është dukur okazion dhe shitësja ka qenë në kushte ngutshmërie. Po kështu, edhe çmimi i shitjes së këtij apartamenti është më i ulët se ai referuar Udhëzimit të EKB, pasi ashtu si tek shitja edhe tek blerja e apartamentit janë patur në konsiderate rrethanat që u përmendën ... Po kështu, edhe lidhur me shitjen është mbajtur parasysh, kërkesë-oferta ... Këtë e tregon edhe fakti që si blerja ashtu edhe shitja janë nën çmimin referues të EKB”*.

1.17.12 Komisioni ka hetuar edhe mbi ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit Etleva Temo me shtetasit S.D., B., M., A., B. dhe M.M. dhe nga korrespondenca e kryer me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec²³ dhe Gjykatën e Apelit Korçë²⁴ nuk është konstatuar ndonjë situatë e tillë.

Komisioni arrin në përfundimin se për pasurinë apartament me sip. 56 m², në Pogradec blerë në vitin 2005 për vlerën 1,300,000 lekë dhe shitur në vitin 2008 në vlerën 1,700,000 lekë, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me diferencat e çmimit në këto transaksione me çmimet e referencës sipas EKB-së duke i argumentuar si me faktin se bëhet fjalë për një apartament në pallat të vjetër të ndërtuar përpara viteve 90 ashtu edhe në sigurimin e një çmimi okazion krahasuar me situatën kërkesë-ofertë.

1.18 Analizë çmimit të blerjes së apartamentit me sip. 56m²: (i) shuma prej 1,000,000 lekësh dhënë hua nga motra e subjektit, znj. E.N.; dhe (ii) shuma prej 300,000 lekësh kursime familjare.

i. Shuma prej 1,000,000 lekësh dhënë hua nga motra e subjektit, znj. E.N., sipas kontratës së huas, datë 14.6.2005, me afat 5-vjeçar pa interes²⁵.

1.18.1 Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti deklaroi se: *“Për blerjen e apartamentit me sip. 56 m² është marrë hua shuma prej 1,000,000 lekësh, sipas kontratës së huas nr. *** rep., datë 14.6.2005, për një periudhë 5-vjeçare ndaj huadhënëses E.N. Huamarrja e pashlyer pasi dorëzohet në fund të vitit çdo kështu”,* ndërsa në DIPP-në e vitit 2010 deklarohet shlyerja e detyrimit.

1.18.2 Subjekti, kur është thirrur për të dhënë shpjegime në ILDKPKI²⁶ në datën 30.3.2015, ka dorëzuar kontratën e huas me të dhënat si më sipër.

1.18.2.1 Gjithashtu, në ILDKPKI subjekti ka dorëzuar edhe dokumentin e datës 18.5.2011 “shpjegime lidhur me deklarin e shlyerjes së huas sipas kontratës datë 14.6.2005”, drejtuar ILDKPKI-së nga subjekti Etleva Temo, e cila deklaroi se: *“... duke sqaruar në këtë deklarin që në fund të çdo viti bëhet shlyerja e kështit prej 200,000 lekësh. Me sqarimin se shlyerja e kështit bëhet në fund të çdo viti e kam konsideruar të deklaruar shlyerjen e kështit për çdo vit. Shlyerja e huas është bërë çdo vit sipas kështit, në shumën 200,000 lekë me kursimet nga paga dhe me të ardhurat e mbetura nga shitja e makinës sipas kontratës nr. ***, datë 25.1.2007”*.

²³ Gjykata e Rrethit Pogradec me nr. ***, datë 27.4.2020.

²⁴ Gjykata e Apelit Korçë me nr. ***, datë 24.4.2020.

²⁵ Subjekti ka deklaruar se kontrata është dorëzuar në deklarin e vitit 2006, pasi sipas vërtetimit noterial të noterit T.B. mungon për shkak të kalimit të afatit të ruajtjes së dokumenteve.

²⁶ ILDKPKI-ja me nr. *** prot, datë 30.1.2020.

1.18.3 Komisioni i ka kërkuar subjektin të japë shpjegime në lidhje me mosdeklarimin shlyerjes së huas prej 1,000,000 lekësh për çdo vit nga 200,000 lekë²⁷ në DIPP-të 2005 - 2008.

Subjekti ka shpjeguar se: *“Duke qenë se kam shënuar në momentin e marrjes së huas që do shlyhet çdo vit në shumën 200.000 lekë dhe duke qenë se e kam deklaruar në përfundim, të shlyer, ndoshta në kuadër të një gabimi duke e menduar si përsëritje në çdo deklaratë nuk e kam shënuar. Pra, me deklarimin se, shlyerja bëhet në fund të çdo viti e kam menduar të deklaruar shlyerjen e këstit për çdo vit”.*

1.18.4 Komisioni ka kërkuar nga subjekti që të provojë me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të të ardhurave të motrës, znj. E.N., për shumën e dhënë hua prej 1,000,000 lekësh.

Subjekti ka shpjeguar se: *“Motra ime, E.N. dhe bashkëshorti i saj kanë pasur kursime familjare si në Shqipëri, prej vitit 1996 kur edhe kanë lidhur martesën, ashtu edhe të sjella kur kanë ardhur nga SHBA”.*²⁸

1.18.5 Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale, datë 22.4.2020,²⁹ me deklaruese znj. E.N., e cila deklaron: *“...se në vitin 2005...i kam dhënë hua nga kursimet familjare motrës sime Etleva Temo shumën prej 1.000.000 lekësh, për blerjen e një apartamenti. Unë kam jetuar së bashku me bashkëshortin A.N. në një banesë me prindërit e mi në Pogradec, ku edhe kam lënë kursimet familjare në gjendje cash, të mbledhura si nga puna në Shqipëri ashtu edhe në SHBA...Kemi rënë dakord që shlyerja të bëhet çdo vit për pesë vjet, në shumën 200,000 lekë, pa caktuar ndonjë datë. Kjo shumë është shlyer plotësisht në vitin 2010, dhe për shkak të marrëdhënieve familjare nuk kemi mbajtur dokumentacion për shlyerjet, shuma të cilat janë lënë tek prindërit ...”.*

1.18.6 Subjekti ka depozituar dokumentacionin ligjor provues për të ardhurat familjare të motrës, znj. E.N. dhe bashkëshortit të saj, z. A.N., fillimisht jo në formën e kërkuar nga ligji me vulë apostile/përkthyer/noterizuar, por që është plotësuar dhe depozituar në Komision me përgjigjet mbi rezultatet e hetimit. Subjekti nuk ka depozituar dokumentacion provues në lidhje me kursimet familjare të motrës dhe bashkëshortit të saj të krijuara në Shqipëri, por nga dokumentacioni për të ardhurat e krijuara në SHBA, të analizuar në vijim, rezulton se personi i lidhur me subjektin ka pasur mundësi të krijojë shumën prej 1,000,000 lekësh.

Subjekti ka depozituar formularët e taksave të Departamentit të Thesarit (të SHBA) për vitet 2001 – 2005, në lidhje me të ardhurat e krijuara në SHBA nga shtetasit E. dhe A.N.

1.18.7 Analiza financiare të të ardhurave të motrës së subjektit, znj. E.N.

Për periudhën 2001 – maj 2005, znj. E.N. dhe bashkëshorti i saj kanë përfituar të ardhura *bruto* në shumën 152,557 USD. Për vitin 2005 të ardhurat janë llogaritur deri në muajin maj, pasi referuar kontratës së huas, huaja është dhënë në datën 14.6.2005. Shpenzimet jetike³⁰ për një familje me 4 anëtarë për periudhën 2001 – maj 2005, janë në shumën 82,934 USD, nga ku mundësia për kursime (*bruto*, para pagesës së taksave) rezulton në shumën 69,622 USD.

²⁷ Në datën 30.3.2015, subjekti ka deklaruar në ILDKPKI se: *“... në fund të çdo viti bëhet shlyerja e këstit prej 200,000 lekë”*, ndërkohë në DPV-në e 2010 ka deklaruar *“detyrimi nga kontrata e huas, i shlyer komplet”*.

²⁸ Subjekti ka bashkangjitur dokumentacionin provues të të ardhurave familjare të motrës E.N. dhe bashkëshortit të saj A.N.; ‘lëvizje llogarie’ me datë hapje 6.4.2007, për A.N. nga ‘ProCredit Bank’, si edhe taksat për vitin 2005 nga Departamenti i Shtetit SHBA, jo në formën e kërkuar nga ligji për shkak të situatës së Covid-19.

²⁹ Deklaratë noteriale e dhënë para noterit publik A.Gj., në shtetin e Floridas.

³⁰ SOURCE: U.S. Bureau of the Census, Current Population Survey, Annual Social and Economic Supplements. For information on confidentiality protection, sampling error, nonsampling error, and definitions, see Weighted Average Poverty Thresholds for Families of Specified Size: 1959 to 2018.

1.18.8 Subjektit i janë kërkuar shpjegime në lidhje me mënyrën e dhënies/dërgimit të shumës së dhënë hua, si dhe të vërtetojë pagesat e bëra nga subjekti çdo vit për shlyerjen e huas motrës së saj.

Subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera, se kursimet e motrës dhe bashkëshortit të saj i kanë mbajtur në shtëpinë e prindërve (ku ka banuar dhe kanë qenë në një ekonomi të përbashkët), nga ku i janë dhënë më pas në formë *cash*, por nuk është mbajtur dokument ligjor.

1.18.9 Komisioni ka kërkuar nga subjekti shpjegime në lidhje me burimin e pagesave të kryera për shlyerjen e huas.

Subjekti ka shpjeguar se: *“Burimi i të ardhurave për pagimin e huas kanë qenë kursimet familjare nga të ardhurat nga pagat, për vitet 2005 – 2010 ... ”*, duke shpjeguar kursimet për çdo vit.

Komisioni arrin në përfundimin se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me mënyrën e shlyerjes e huas në shumën 1,000,000 lekë.

Referuar analizës financiare për vitet 2003 – 2016³¹, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj rezultojnë më mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e pasurisë, mbulimin e shpenzimeve dhe pagesën e detyrimeve financiare për shlyerjen e huas në vitin 2007 dhe në vitet 2009 – 2010, në shumën -756,327 lekë .

ii. Shuma 300,000 lekë kursime familjare

1.18.10 Në DIPP-në e vitit 2004, subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash*. Po kështu në DIPP-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar si burim për blerjen e apartamentit me sip. 56 m² në shumën 1,300,000 lekë, vetëm huan e marrë nga motra, znj. E.N., në shumën 1,000,000 lekë. Në DIPPP-në e vitit 2005, subjekti deklaron: *“Mbyllje e llogarisë bankare prej 300,000 lekësh, në ProCredit Bank”*.

1.18.11 “ProCredit Bank”³² konfirmon llogaritë bankare në emër të subjektit të rivlerësimit dhe nga veprimet bankare rezulton se subjekti ka tërhequr nga llogaritë në datën 16.11.2005 shumat 54,430 lekë; 63,870 lekë dhe 757 USD (konvertuar në 79,265 lekë)³³, totali i të cilave është 197,565 lekë. Në momentin e blerjes së apartamentit në datën 20.6.2005, këto shuma kanë qenë të depozituara në llogari dhe nuk janë përdorur për blerjen e tij.

1.18.12 Në vitin 2005, deri në datën e blerjes së pasurisë (20.6.2005), subjekti ka pasur në dispozicion shumën prej 405,409 lekësh të ardhura nga pagat me të cilat ka përballuar shpenzimet jetike në shumën 219,114 lekë, si dhe ka pasur mundësi të kursejë shumën 186,295 lekë. Kjo shumë duket se është e pamjaftueshme për të plotësuar shumën 300,000 lekë duke rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme të kursimeve në shumën 113,705 lekë.

Nga analiza e ligjshmërisë së dy burimeve të krijimit huas prej 1,000,000 lekësh dhe kursimeve familjare në shumën 300,000 lekë, si dhe referuar analizës financiare, duket se subjekti ka mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e apartamentit me sip. 56 m² në shumën 113,705 lekë.

1.19 Komisioni gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se:

Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pagesat në shumën prej 200,000 lekësh/çdo vit për shlyerjen e huas në shumën 1,000,000 lekë.

³¹ Shikoni analizën financiare gjithëpërfshirëse 2003 – 2016.

³² Shkresë nr. Prot. ***, datë 31.1.2020, e “ProCredit Bank”.

³³ Konvertuar sipas kursit të BSH-së 1 USD=104.71 lekë, datë 16.11.2005.

Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti, kanë mungesë burimesh të ligjshme të kursimeve familjare në shumën 113,705 lekë për krijimin e shumës 300,000 lekë të deklaruara si burim për blerjen e apartamentit me sip. 56 m².

Në lidhje me këto konstatime, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime se:

1.19.1 Në lidhje me mosdeklarimin e pagesave në shumën prej 200,000 lekësh/çdo vit për shlyerjen e huas në shumën prej 1,000,000 lekësh, subjekti ka shpjeguar se ka shënuar në momentin e marrjes së huas që do shlyhet çdo vit në shumën 200,000 lekë, në kuadër të një gabimi duke e menduar si përsëritje në çdo deklaratë nuk e ka shënuar. Pra, me deklarimin se shlyerja bëhet në fund të çdo viti, subjekti deklaroi se e ka menduar të deklaruar shlyerjen e këstit për çdo vit. Gjithashtu, subjekti deklaroi se shpjegimet e saj përputhen edhe me deklaratën noteriale të datës 22.4.2020 me deklaruese znj. E.N. të lartpërmendur.

1.19.2 Në lidhje me mungesën e burimeve financiare në shumën 113,705 lekë (referuar burimit nga kursimet familjare 300,000 lekë që janë përdorur për të blerë apartamentin me sip. 56 m²), subjekti ka shpjeguar se ashtu si konfirmohet nga “ProCredit Bank”, nga veprimet bankare rezulton se janë tërhequr nga llogaritë në datën 16.11.2005 shumat 54,430 lekë; 63,870 lekë dhe 757 USD (konvertuar në 79,265 lekë), totali i të cilave është 197,565 lekë. Është e vërtetë se në momentin e blerjes së apartamentit në datën 20.6.2005, këto shuma kanë qenë të depozituara në llogari dhe, si të tilla, nuk janë konsideruar si hua prej motrës, pasi ka shpjeguar se ka jetuar së bashku me familjen e saj me prindërit dhe kanë rënë dakord që në një moment të dytë të tërhiqen prej saj, për t’ua dhënë prindërve diferencën sipas nevojës. Këtë e tregon edhe fakti që këto shuma janë tërhequr në një ditë, për të shlyer diferencën dhe ndonjë shpenzim të vogël për banesën.

1.20 Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

1.20.1 Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacionin në formën e kërkuar nga ligji, i cili provon burimin e ligjshëm të të ardhurave të realizuara nga personi tjetër i lidhur me subjektin, motra E.N. dhe bashkëshorti A.N., për huan dhënë subjektit në shumën 1,000,000 lekë, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

1.20.2 Subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me mosdeklarimin e shlyerjes së huas çdo vit me nga 200,000 lekë. Subjekti në deklaratat periodike ka deklaruar marrjen e huas dhe shlyerjen përfundimtare të saj. Shlyerjet e huas me nga 200,000 lekë/vit janë pasqyruar nga Komisioni në analizën financiare për periudhën 2003 – 2016.

1.20.3 Subjekti nuk ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme në shumën -113,705 lekë (pjesë e shumës 300,000 lekë, deklaruar si burim krijimi për apartamentin me sip. 56 m² si kursime familjare). Gjatë hetimit subjekti ka ndryshuar dhe burimin e krijimit të shumës prej 300,000 lekësh, nga kursime familjare, në kursime të motrës të lëna te prindërit, të cilat më pas i janë dhënë motrës në një moment të dytë dhe kjo shumë nuk është konsideruar si hua prej motrës.

Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e shumës 300,000 lekë duke rezultuar me një mungesë financiare në shumën 113,705 lekë.

2. Apartament banimi, ndodhur në rrugën “**”, p. ***, ap. ***, shk. ***, k. ***, 2+1, Pogradec, i ndërtuar në vitin 1974, me vlerë 13,950 lekë në bashkëpronësi me prindërit e bashkëshortit dhe bashkëshortin.**

Burimi i krijimit: përfituar nga ligji nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, me kontratën privatizim banese, datë 10.8.1993. Shuma është paguar nga prindërit e bashkëshortit dhe bashkëshorti.

2.1 Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti në deklaratën e pasurisë të vitit 2003.

2.2 Subjekti ka depozituar kontratën e privatizimit të banesës, datë 10.8.1993, për çmimin 13,950 lekë dhe certifikatën për vërtetim pronësie, datë 5.6.2008, me bashkëpronarë A., A., Etleva dhe V.T.

2.3 ASHK-ja, Zyra Vendore Pogradec³⁴ konfirmon regjistrimin e kësaj pasurie në pronësi të shtetasve V., A., A. dhe Etleva Temo.

Komisioni vlerëson se deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me dokumentacionin justifikues ligjor për këtë pasuri.

3. Tokë “arë” me sip. 10,850 m², ndodhur në *, Pogradec, z. k. ***, vol. ***, f. ***, në bashkëpronësi me motrën, znj. E.N., sipas certifikatës së pronësisë, datë 23.6.2014.**

Tokë “arë+pemëtoare” me sip. 18,730 m², ndodhur në *, Pogradec, z. k. ***, vol. ***, f. ***, në bashkëpronësi me motrën, znj. E.N., sipas certifikatës së pronësisë, datë 23.6.2014.**

Sipërfaqe pylli prej 13,000 m², ndodhur në *, Pogradec, z. k. ***, vol. ***, f. ***, në bashkëpronësi me motrën, znj. E.N., sipas certifikatës së pronësisë, datë 23.6.2014.**

Burimi i krijimit: trashëgimia nga babai, z. H.Z.. Këto sipërfaqe toke janë kthyer me vendimin nr. ***, datë 1.3.2006, të Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (ZRKKP), Qarku Korçë.

3.1 Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar pasuritë e mësipërme në bashkëpronësi me motrën e saj, znj. E.N., të përfituara nga trashëgimia ligjore e babait, z. H.Z.

3.2 Subjekti ka depozituar dokumentacionin ligjor për përfitimin e këtyre pasurive, konkretisht vendimin nr. ***, datë 1.3.2006, të ZRKKP-së, Qarku Korçë, që u ka njohur të drejtën e pronësisë trashëgimtarëve të ish-pronarit N.Z. (gjyshi i subjektit), përfshirë këtu dhe babanë e subjektit, z. H.Z.³⁵ dhe regjistrimin pas ndarjes së pjesëve takuese, në emër të z. H.Z., në ZVRPP-në Pogradec³⁶, të pasurive 18,730 m², 13,000 m² dhe 10,850 m², si dhe regjistrimin e tyre në bashkëpronësi të shtetasve Etleva Temo (Zgjani) dhe E.N.(Z.), si pasojë e regjistrimit të dëshmisë së trashëgimisë të vitit 2014³⁷ në ZVRPP-në Pogradec, pas vdekjes së babait të tyre, z. H.Z.³⁸.

3.3 ASHK-ja, Zyra Vendore Pogradec³⁹ konfirmon se shtetasit Etleva Temo dhe E.N. kanë të regjistruar pasurinë e llojit “arë” me sip. 10,850 m², nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***; pasurinë e llojit “pyll” me sip. 13,000 m², nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***; pasurinë e llojit “arë” me sip. 18,730 m², nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***.

3.4 Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë statusin aktual të këtyre pasurive, nëse subjekti dhe e motra kanë ndërtuar në këto prona, i përdorin vetë apo i kanë dhënë me qira dhe, nëse po, a janë paguar detyrimet tatimore për to, duke i shoqëruar me dokumentacionin ligjor përkatës.

³⁴ Zyra Vendore Pogradec me nr. *** prot., datë 19.5.2020.

³⁵ Vendimin nr. ***, datë 1.3.2006, të KKKP-së që u njeh trashëgimtarëve të N.Z. në fshatin G. pronat: korije më sip. 6.5 ha, 1.35 ha, 9.1 ha, 4.34 ha. Nga këto prona përfitojnë me pjesë takuese H. Z. 1/5 etj.

³⁶ 3 Certifikata pronësie në emër të H.Z., datë 10.8.2006, për pasuritë e ndodhura në G.: arë+pemëtoare me sip.18,730 m²; pyll me sip.13,000 m²; arë me sip.10,850 m².

³⁷ Dëshmi trashëgimie, datë 7.5.2014, për trashëgimlënësin H.Z. ku përcakton trashëgimtarë të radhës së parë Zh.Z. (bashkëshortja), Etleva Temo (Zgjani) dhe E.N. (Z.) (bijat) që trashëgojnë 1/3 pjesë. Trashëgimtarja Zh. Z. me datë 23.8.2013 ka hequr dorë nga trashëgimi i pjesës së saj në favor të Etleva Temo (Zgjani) dhe E.N. (Z.) të cilat trashëgojnë nga ½ secila.

³⁸ 3 Certifikata pronësie, datë 23.6.2014, për 3 pasuritë e pasqyruara në pikën 36 në bashkëpronësi të Etleva Temo (Zgjani) dhe E.N.(Z.) me nga ½ pjesë.

³⁹ Zyra Vendore Pogradec me nr. *** prot., datë 19.5.2020.

Subjekti ka dhënë shpjegime se këto pasuri nuk shfrytëzohen dhe se pavarësisht kësaj janë paguar taksat për pasurinë sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 28.4.2020, të lëshuar nga Bashkia Pogradec.

Komisioni arrin në përfundimin se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e depozituar nga subjekti dhe me atë të përcjellë nga ASHK-ja Pogradec, si dhe nuk konstatohen problematika për këto pasuri.

4. Shitur automjeti tip “Fiat Lancia”, i vitit 1999, me targa *, blerë me kontratën nr. ***, datë 2.9.2015⁴⁰. Të ardhura të realizuara nga shitja sipas kontratës së shitjes, datë 30.6.2016,⁴¹ në shumën 1,000 euro. Pjesa takuese: 50% me bashkëshortin.**

4.1 Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar: “*Blerje automjeti ‘Fiat Lancia’, viti i prodhimit 1999, me kontratë nr. ***, datë 2.9.2015, në vlerën 800 euro, me pjesë takuese 100%*”. Ndërsa në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar: “*Shitjen e këtij mjete me kontratën e shiblerjes nr. ***, datë 30.6.2016, në vlerën 1,000 euro, me pjesë takuese 50% e pandarë me bashkëshortin*”.

4.2 Subjekti ka depozituar: (i) kontratën e shitjes, datë 2.9.2015, me shitës A.A. dhe blerëse Etleva Temo për automjetin “Fiat Lancia”, me targa ***, me çmimin 800 euro; (ii) kontratën e shitjes, datë 30.6.2016, me shitës Etleva Temo dhe blerës V.M. për çmimin 1,000 euro, paguar jashtë zyrës noteriale.

4.3 DPSHTRr-ja⁴² ka depozituar dosjen e automjetit me targa ***, ku vërtetohen transaksionet e kryera për këtë automjet si më lart.

4.4 Komisioni ka kërkuar nga subjekti shpjegime në lidhje me burimin e krijimit të këtij automjeti, si dhe të provojë nëse është paguar tatimi mbi të ardhurat për diferencën ndërmjet çmimit të shitjes dhe blerjes sipas ligjit për tatimin mbi të ardhurat.

Subjekti ka shpjeguar se: “*Burimi i të ardhurave për blerjen e automjetit të tipit ‘Fiat Lancia’, në vitin 2015, kanë qenë kursimet nga të ardhurat bashkëshortore*”.

4.5 Komisioni ka analizuar mundësinë financiare të subjektit në momentin e blerjes së automjetit tip “Fiat Lancia”, datë 2.9.2015, me burim krijimi kursimet nga të ardhurat bashkëshortore nga ku rezulton me balancë negative në shumën 494,561 lekë, sipas tabelës. Tabela nr. 1

	Përshkrim	Vlera në lekë
A	Të ardhurat	1,283,983
1	Gjendje <i>cash</i> më 1.1.2015	500,000
2	Gjendje në llogari bankare më 1.1.2015 (overdraft)	-164,217
3	Të ardhura nga paga 1.1.2015 – 31.8.2015	902,426
4	Të ardhura nga paga 1.1.2015 – 31.8.2015	45,774
B	Shpenzime	1,626,022
1	Shpenzime jetike 1.1.2015 – 31.8.2015	598,069
2	Shpenzime shkollimi Nehemia	51,000
3	Shpenzime kredie	264,233
4	Shpenzime <i>TIMS</i> më 31.8.2015	712,720
C	Pasuri	152,522

⁴⁰ Kontrata e blerjes e automjetit “Fiat Lancia” me nr. ***, datë 2.9.2015.

⁴¹ Kontratë shitje nr. ***, datë 30.6.2016.

⁴² DPSHTRr-ja me shkresën nr. *** prot., datë 30.1.2020.

1	Gjendje në llogari bankare më 31.8.2015	41,114
2	Blerë automjet “Fiat Lancia”, shuëa 800 euro, datë 2.9.2015	111,408
	Mundësia financiare në momentin e blerjes së mjetit datë 02.09.2015 (A-B-C)	-494,561

4.6 Në lidhje me pagesën e tatimit mbi të ardhurat për diferencën ndërmjet çmimit të shitjes dhe atij të blerjes së automjetit tip “Fiat Lancia” sipas ligjit për tatimin mbi të ardhurat⁴³, subjekti ka shpjeguar se: *“Referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, i ndryshuar, unë dhe bashkëshorti jemi subjekti i këtij ligji, vetëm për sa i takon tatimit mbi pagën. Kjo diferencë nuk bën pjesë në të ardhurat e tatueshme sipas nenit 8 të këtij ligji ...”*.

4.7 Në lidhje me konstatimin e Komisionit se:

i) subjekti duket nuk ka pasur burime të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e automjetit tip “Fiat Lancia” në datën 2.9.2015, pasi nga analiza financiare rezulton me balancë negative në shumën 494,561 lekë;

ii) subjekti nuk ka paguar tatimin mbi të ardhurat për diferencën 200 euro, si diferencë e çmimit të shitjes prej 1,000 euro me çmimin e blerjes prej 800 euro.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se automjeti tip “Fiat Lancia” është blerë me kursimet familjare. Këto kursime mund të kenë qenë që nga viti paraardhës ku veç të ardhurave është deklaruar edhe shuma 1,000 USD dhuratë nga motra e bashkëshortit. Balanca negative është rezultat i shpenzimeve të llogaritura për hyrje-daljet nga sistemi *TIMS*, ku pothuaj gjithë udhëtimet kanë qenë familjare në Ohër dhe Strugë⁴⁴, ndërsa djali ka udhëtuar për në Gjermani nëpërmjet aeroportit të Selanikut ku e ka shoqëruar bashkëshorti.

4.7.1 Subjekti ka shpjeguar se duke u llogaritur këto shpenzime sipas deklaramit janë në vlerën rreth 350,000 mijë lekë. Gjithashtu, balanca negative ka ardhur edhe si rezultat i mos llogaritjes së huas dhënë nga shtetasi S.K. prej 8,000 euro, për të cilën ka paraqitur dokumentacion shtesë, për të provuar faktin se kjo familje ka mundësi financiare për këtë hua, sqaruar hollësisht më poshtë

4.7.2 Lidhur me mospagimin e tatimit mbi të ardhurat për diferencën prej 200 euro midis çmimit të blerjes me atë të shitjes, subjekti ka deklaruar se kjo shumë nuk bën pjesë në të ardhurat e tatueshme referuar ligjit, nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, mbajtur parasysh faktin që kjo shumë në fakt nuk përbën fitim për sa kohë është përdorur për mirëmbajtjen e automjetit dhe çmimi i shitjes reflekton këto shpenzime

4.8 Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

4.8.1 Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse, në lidhje me shpenzimet e udhëtimit të deklaruara sipas saj në shumën 350,000 lekë, pasi nuk janë të mbështetura në prova dhe dokumentacion ligjor, por mbeten vetëm në kuadër deklarativ.

Gjithashtu, subjekti nuk ka dhënë shpjegime bindëse, në lidhje me mosllogaritjen nga Komisioni të huas prej 8,000 euro marrë shtetasit S.K. si e ardhur për blerjen e automjetit, ndërkohë që Komisioni ka evidentuar se huaja prej 8,000 euro nuk është deklaruar më parë nga subjekti si burim për blerjen e këtij automjeti.

⁴³ Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”.

⁴⁴ Subjekti ka deklaruar: *“... këto hyrje-dalje kanë qenë të gjitha për ne Maqedoninë e Veriut dhe një pjesë e vogël për në Greqi. Pothuajse të gjitha udhëtimet për jashtë vendit kanë qenë udhëtime familjare për në Ohër dhe Strugë, për disa orë, me shpenzime minimale, për shkak të afërsisë që kanë me qytetin e Pogradecit dhe për plotësimin e nevojave të ndryshme, si ato shëndetësore etj., fenomen ky i njohur për të gjithë banorët e qytetit të Pogradecit. Qyteti i Ohrit dhe Strugës janë rreth 20-25 km larg nga qyteti i Pogradecit”*.

4.8.2 Subjekti, gjithashtu, nuk ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me mospagimin e tatimit mbi të ardhurat për diferencën në çmimin e blerjes me atë të shitjes. Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar, në nenin 8, “e ardhura e tatueshme”, pika “g”, parashikon: “*Të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë*”.

Ky qëndrim i Komisionit është konsoliduar edhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit me qëndrimin e mbajtur në vendimin nr. 11/2019, ku është konkluduar se: “*Për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e automjeteve (diferenca mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së automjetit) për sa kohë nuk u provua pagimi i detyrimit tatimor mbi këtë fitim, vlera e fitimit të realizuar vlerësohet si e ardhur e paligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016*”.

Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka paguar tatimin mbi të ardhurat për diferencën midis blerjes dhe shitjes së mjetit, në përputhje me nenin 8 të ligjit nr. 8438/1998, i ndryshuar. Në analizën financiare të vitit 2016, është marrë në konsideratë si e ardhur nga shitja e automjetit vetëm vlera prej 800 euro, që është çmimi i blerjes së automjetit, duke afektuar analizën financiare për vitin 2016 që rezulton me një balancë financiare negative në shumën prej 386,760 lekësh⁴⁵.

5. Automjet tip “Ford Mondeo”, i vitit 2006, me targa *, blerë me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 27.11.2013, nga shitësit K.F. dhe I.G. në shumën 4,000 euro.**

Burimi i krijimit i deklaruar nga subjekti: (a) shitja e automjetit “Mercedez-Benz”, me targa ***, me çmimin 3,500 euro; (b) kursime familjare.

5.1 Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar: “*Blerje automjeti tip ‘Ford Mondeo’ nga shitësat K.F. dhe I.G., A.T. (bashkëshorti) në shumën 4,000 euro, sipas kontratës së shitblerjes me nr. *** kol, datë 27.11.2013. Blerë nga shitja e automjetit tip ‘Mercedes-Benz’ me targa ***, në shumën 3,500 euro dhe 500 euro nga kursimet*”. *Vlera: 4000 euro. Në bashkëpronësi me bashkëshortin*”.

5.2 Subjekti ka depozituar kontratën e shitblerjes së mjetit, datë 27.11.2013,⁴⁶ për çmimin 4,000 euro.

5.3 DPSHTR-ja⁴⁷ ka depozituar dosjen e automjetit tip “Ford Mondeo”, me targa ***, ku konfirmohet pronësia e këtij automjeti në emër të personit të lidhur me subjektin, bashkëshortit A.T., i blerë në datën 27.11.2013, nga shtetasit I.G. dhe K.F., me çmimin 4,000 euro.

5.4 Subjekti ka deklaruar si një nga burimet e krijimit, të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, në shumën 3,500 euro, shitur me kontratën e datës 31.7.2013⁴⁸. Ky automjet është blerë më parë me çmimin 1,850 euro në datën 16.5.2007⁴⁹.

5.5 Subjekti nuk ka provuar me dokumentacion ligjor pagesën e tatimit për diferencën e çmimit të shitjes me atë të blerjes së këtij automjeti dhe konkretisht të shumës prej 1,650 euro që vjen nga diferenca (3,500 -1,850 euro), duke bërë që kjo shumë të mos plotësojë kushtin e të ardhurave të ligjshme⁵⁰ dhe në analizë financiare si burim i ligjshëm për të blerë automjetin tip “Ford Mondeo” është llogaritur vetëm vlera e blerjes 1,850 euro.

⁴⁵ Shikoni analizën financiare në pikën 21 të vendimit.

⁴⁶ Kontrata e blerjes së automjetit “Ford Mondeo” nr. ***, datë 27.11.2013.

⁴⁷ DPSHTR-ja me nr. *** prot., datë 30.1.2020.

⁴⁸ Kontrata e shitblerjes së automjetit “Mercedes-Benz” me nr. ***, datë 31.7.2013.

⁴⁹ Kontrata e shitblerjes së automjetit “Mercedes-Benz” me nr. ***, datë 16.5.2007.

⁵⁰ Ky konstatim iu kalua si barrë prove në pikën 6 ku është analizuar gjerësisht automjeti targa ***.

5.6 Në lidhje me kursimet familjare në shumën 500 euro, të deklaruara nga subjekti si burim krijimi për blerjen e automjetit, Komisioni vlerësoi mundësinë financiare të subjektit për krijimin e tyre. Referuar analizës financiare për vitin 2013⁵¹, duket se subjekti ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të kursyer shumën prej 500 euro.

5.7 Me analizimin e ligjshmërisë së dy burimeve të krijimit: (i) të ardhurat nga shitja e automjetit prej 3,500 euro; dhe (ii) kursimeve familjare në shumën 500 euro, si dhe referuar analizës financiare, duket se subjekti ka mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e automjetit tip “Ford Mondeo”, me targa ***, në shumën -231,525 lekë referuar tabelës nr. 2, si vijon:

Tabela nr. 2

	Përshkrim	Vlera në lekë
A	Të ardhurat	329,475
1	Të ardhura nga shitja e mjetit me targa ***, vlera 3,500 euro, datë 31.7.2013, 1,850 euro x 140.2	259,370
2	Kursime familjare 500 euro	70,105
B	Pasuri	561,000
1	Automjeti me targa ***, vlera 4,000 euro x 140.25	
	Mundësia për burime të ligjshme për blerjen e automjetit *** (A-B)	-231,525

5.8 Pas kalimit të barrës së provës, në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime, ndër të tjera, se lidhur me tatimin mbi vlerën 1,650 euro përfituar nga çmimi i shitjes, kjo shumë nuk bën pjesë në të ardhurat e tatueshme referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, mbajtur parasysh faktin që kjo shumë nuk përbën fitim për sa kohë është përdorur për mirëmbajtjen e automjetit në vite (6 vjet) dhe çmimi i shitjes reflekton këto shpenzime. Në këto kushte kjo shumë e përfituar nga shitja e automjetit prej 3,500 euro shtuar edhe kursimet në shumën 500 euro është përdorur për blerjen e automjetit tip “Ford Mondeo”.

5.9 Vlerësimi i çështjes nga trupi gjyqës

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me mospagimin e tatimit në burim për diferencën midis çmimit të blerjes dhe shitjes së automjetit. Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, në nenin 8, “e ardhura e tatueshme”, pika “g”, parashikon: “... të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë”.

Kjo praktikë është konsoliduar dhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelit me qëndrimin e mbajtur prej tij me vendimin nr. 11/2019, ku ka konkluduar se: “Për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e automjeteve (diferenca mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së automjetit), për sa kohë nuk u provua pagimi i detyrimit tatimor mbi këtë fitim, vlera e fitimit të realizuar vlerësohet si e ardhur e paligjshme në kuptim të nenit D, pika 3, e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016”.

Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka paguar tatimin mbi të ardhurat për diferencën në çmim midis blerjes dhe shitjes së mjetit, prej 1,650 euro, në përputhje me nenin 8 të ligjit nr. 8438/1998, i ndryshuar. Në analizën financiare⁵² është

⁵¹ Shikoni analizën financiare 2003-2016 në faqe nr. 64.

⁵² Shikoni analizën financiare në pikën 21 të vendimit.

marrë në konsideratë si e ardhur nga shitja e automjetit vetëm vlera prej 1,850 euro që është sa çmimi i blerjes së këtij mjeti.

6. Automjete të mëparshëm të tjetërsuar (shitur, shkëmbyer)

6.1 Automjet tip “Mercedes-Benz” , i blerë me kontratën e shitblerjes⁵³, datë 27.9.2002, në shumën 200,000 lekë.

6.1.1 Në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, subjekti ka deklaruar: “Autoveturë “Mercedes-Benz” i përdorur i vitit 1996, tip 201, me vlerë 200,000 lekë. Blerë me kursimet e përbashkëta me bashkëshortin me kontratën e datës 27.9.2002”. Subjekti nuk e ka depozituar kontratën e blerjes së këtij automjeti.

6.1.2 DPSHTRr-ja⁵⁴ ka depozituar dosjen e automjetit me targa ***⁵⁵. Autojeti “Mercedes-Benz” është i tipit 190 D me vit prodhimi 1986. Konfirmohet se ky automjet ka qenë në pronësi të shtetasit A.T., i cili është përfitur nga kontrata e shitblerjes së datës 27.9.2002⁵⁶ me shitës B.B. me çmimin 200,000 lekë. Shtetasi A. (A.) T. ka paguar taksën doganore në vlerën 151,520 lekë.

DPSHTRr-ja ka depozituar dhe kontratën⁵⁷ e datës 13.9.2005, ku shtetasi A. (A.) T. ka shitur automjetin “Mercedes-Benz”, me targa *, blerësit F.Ç. me çmimin 250,000 lekë.** Më tej, me kontratën e datës 17.5.2006, shtetasi F.Ç. e shet këtë automjet dhe, në vijim, janë kryer veprime të tjera në DPSHTRr.

6.1.3 Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime në lidhje me burimin e krijimit të të ardhurave për blerjen e këtij automjeti.

Subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera, se:” *Burimi i krijimit të të ardhurave për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz” në datën 27.9.2002, janë nga kursimet familjare ...*”.

6.1.4 Komisioni analizoi mundësinë e subjektit për blerjen e automjetit në datën 27.9.2002 me të ardhurat e vitit 2001 dhe 2002. Duket se subjekti ka pasur burime të mjaftueshme për blerjen e mjetit në vitin 2002.

Tabela nr. 3

	Përshkrim	Vlera në lekë
A	Të ardhurat	1,134,960
1	Të ardhura nga paga 1.1.2001 – 27.9.2002	
B	Shpenzime	652,457
1	Shpenzime jetike 1.1.2001 – 27.9.2002	
C	Pasuri	351,520
1	Automjet tip “Mercedes-Benz”, ***, më 27.9.2002	200,000
2	Pagesë për zhdoganimin e mjetit	151,520
	Mundësia financiare në momentin e blerjes së mjetit 21.9.2002 (A-B)	130,983

⁵³ Kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 27.9.2002.

⁵⁴ DPSHTRR me nr. ***, datë 21.4.2020; nr. *** prot., datë 18.5.2020.

⁵⁵ (me targë aktuale ***).

⁵⁶ Kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 27.9.2002.

⁵⁷ Kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 13.9.2005.

6.1.5 Komisioni, gjatë hetimit ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shitjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa *, në DIPP-në e vitit 2005, në vlerën 250,000 lekë.**

Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, pas kalimit të barrës së provës me rezultatet e hetimit, subjekti ka dhënë shpjegime se automjeti tip “Mercedes-Benz”, me targa *** i blerë në datën 27.9.2002 është shkëmbyer me automjetin me targa ***, sipas kontratës së shkëmbimit të datës 13.9.2005 dhe nuk disponohet asnjë kontratë shitje e këtij mjeti. Subjekti, vijon se është vënë në dijeni që janë dy kontrata të lidhur në të njëjtën ditë vetëm nga rezultatet e hetimit dhe se prej saj dhe bashkëshortit disponohet vetëm kontrata e shkëmbimit te noter Th. B.

6.1.6. Subjekti shpjegon se sipas shpjegimeve të bashkëshortit nuk ka pasur asnjë kontakt me shtetasin F.Ç. dhe nuk ka realizuar asnjë kontratë shitje. Kjo kontratë është hartuar pa dijeninë e tij dhe nuk është nënshkruar prej tij. Për këtë kontratë është ndjekur rruga ligjore duke paraqitur kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pogradec sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 2.10.2020.

6.1.7 Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me kontratën e shitjes, datë 13.9.2005, të automjetit “Mercedes-Benz” tip 190D, me targa *** dhe mosdeklarimin e saj. Subjekti në shpjegimet e tij deklaroi se nuk ka pasur dijeni për ekzistencën e kontratës së shitjes të vitit 2005 dhe se bashkëshorti i saj nuk ka qenë në dijeni dhe nuk e ka firmosur atë kontratë. DPSHTRr-ja ka përcjellë dosjen e plotë të automjetit “Mercedes-Benz” tip 190D, i cili është blerë nga shtetasi A.T. në vitin 2002 dhe ka vijuar më pas me kontratën e shitjes së vitit 2005 shtetasit F.Ç. Pra, në këtë dosje është i gjithë dokumentacioni i këtij automjeti në emër të shtetasit A.T. deri në shitjen e tij në vitin 2005. Më pas, në vijimësi janë kryer veprimet nga pronarë të tjerë tek të cilët ky automjet është tjetërsuar. Fakti i transferimit të dosjes origjinale të këtij automjeti nga emri i A.T. tek F.Ç., përjashton pretendimin e subjektit se ajo dhe bashkëshorti nuk kanë dijeni në lidhje me këtë transaksion.

Ndërsa në dosjen e automjetit me targa ***, i cili është këmbyer me automjetin “Mercedes-Benz” tip 190 D, me targa ***, rezultoi dokumentacioni i automjetit me targa *** dhe vetëm kontrata e këmbimit dhe më pas e shitjes së këtij mjeti nga shtetasi A.T.

*Komisioni vlerëson se duke qenë se kjo është një pasuri e vënë gjatë martesës, me kontribut të përbashkët, të dy bashkëshortët përfitojnë të drejta dhe marrin përsipër detyrime në lidhje me të. Nga ana e personit të lidhur me subjektin, bashkëshorti A.T., janë kryer veprime fiktive në lidhje me automjetin “Mercedes-Benz” tip 190D, me targa ***, me pasojë pasaktësi në deklaram, pasi në të njëjtën ditë (datë 13.9.2005), ka lidhur kontratë shitje të këtij automjeti me shtetasin F.Ç., si dhe kontratë shkëmbimi me shtetasin G.A. Pavarësisht se veprimet fiktive janë kryer nga bashkëshorti, subjekti i rivlerësimit duhet të ishte në dijeni të veprimeve të tij duke mos lejuar kryerjen e veprimeve që vijnë në kundërshtim me ligjin, si dhe duke garantuar një etikë sa më të lartë të figurës së gjyqtarit.*

Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shitjen e automjetit sipas kontratës së shitjes, datë 13.9.2005, në DIPP-në e vitit 2005:-

Subjekti i rivlerësimit nuk ka paguar tatimin mbi të ardhurat për diferencën në çmim midis blerjes dhe shitjes së automjetit prej 50,000 lekësh në përputhje me nenin 8 të ligjit nr. 8438/1998, i ndryshuar. Në analizën financiare është marrë në konsideratë si e ardhur nga shitja e automjetit vetëm vlera prej 200,000 lekësh që është sa çmimi i blerjes së këtij mjeti.

6.2 Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa *, këmbyer me automjetin “Mercedes-Benz” blerë me kontratën, datë 27.9.2002 (me targa ***), sipas kontratës së shkëmbimit nr. ***, datë 13.9.2005**

6.2.1 Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar: “Autovetura “Mercedes-Benz” me targa *** është këmbyer me autoveturën e deklaruar në vitin 2004, sipas kontratës së këmbimit nr. ***, datë 13.9.2005. Pjesa takuese ½ me bashkëshortin”. Ndërsa në DIPP-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar: “...shitja e automjetit të mëparshëm me kontratën e datës 25.1.2007, në shumën 9000 euro”.

6.2.2 Subjekti ka depozituar: (i) kontratën e shkëmbimit⁵⁸, datë 13.9.2005, ku shtetasi A.T. shkëmben automjetin e tij “Mercedes-Benz” me targa ***, me automjetin me targa ***, në pronësi të shtetasit G.A.; (ii) kontratë shitje⁵⁹, datë 25.1.2007, me shitës A.T. dhe blerës S.Z. për automjetin tip “Mercedes-Benz” me targa ***, me çmimin 9,000 euro (jashtë zyrës noteriale është shlyer vlera 5,000 euro ndërsa pjesa tjetër prej 4,000 euro do shlyhet pas një muaji dhe do bëhet me deklaratë noteriale nga shitësi).

6.2.3 DPSHTRr-ja⁶⁰ ka përcjellë dosjen e automjetit me targa *** nga ku rezulton se automjeti “Mercedes-Benz” është i tipit 250 TD, i vitit 1996. Gjithashtu, rezulton se automjeti me targa *** me kontratën e datës 14.2.2004⁶¹ nga shtetasi A.Sh. i është shitur shtetasit G.A. me çmimin 500,000 lekë.

Në dokumentacionin e përcjellë nga DPSHTRr-ja për automjetin me targa *, rezulton dhe kontrata e shitjes⁶², datë 30.3.2008, me shitës A.T. dhe blerës A.B., me çmimin 2,000 euro, paguar përpara redaktimit të kontratës.**

6.2.4 Komisioni, me pyetësin nr. 2, i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime: (a) për faktin që automjeti prodhim i vitit 1996, i blerë në shumën 200,000 lekë është këmbyer në vitin 2005 me një automjet që është shitur në vitin 2007 me çmimin 9,000 euro me një vlerë që nuk e ka logjikën normale të tregut të makinave; (b) arsyen që blerësi i automjetit nuk ia ka paguar shtetasti S.Z. të gjithë vlerën prej 9,000 euro bashkëshorti, por i ka paguar fillimisht 5,000 euro dhe pjesën tjetër prej 4,000 euro pas një muaji; (c) të depozitohet deklaratë noteriale për marrjen e shumës 4,000 euro nga blerësi (parashikuar në kontratën e shitblerjes).

Subjekti ka shpjeguar: “Mjeti tjetër i të njëjtit tip ka qenë mjet disa vite më i ri në prodhim, (rreth vitit 1999), i plotësuar me të gjithë dokumentacionin, por ky i fundit ka qenë me difekt në motor (kamio), si dhe i përplasur në pjesën e prapme. Meqënëse bashkëshorti kishte biseduar dhe gjetur në varrezë makinash një pjesë që i përshatej (kamio) kësaj makine ka hyrë në bisedime për shkëmbimin e makinave. Makina është mbajtur një vit duke ju bërë riparimet e nevojshme si në pjesën e mbrapsmë të përplasjes ashtu edhe në përshatjen e kamios dhe më pas është shitur në shumën 9,000 euro. Tregu i makinave të kësaj natyre ka qenë në kushte informaliteti.

Blerësit i është treguar gjendja e makinës dhe rregullimet përkatëse, ndaj edhe ka paguar vetëm vlerën 5,000 euro në fillim, me qëllim për ta mbajtur në provë për një muaj. Pasi makina nuk ka dhënë difekt është paguar edhe pjesa prej 4,000 euro.

Për pagimin e pjesës së mbetur prej 4,000 euro është mbajtur një deklaratë e thjeshtë midis A.T. dhe S.Z. Meqënëse detyrimi është parashikuar në kontratë dhe, si i tillë, bëhet i kërkueshëm mbi bazën e kontratës në rast mospërmbushje, është mbajtur vetëm deklarata e thjeshtë e datës 27.2.2007 (bashkangjitur deklarata e datës 27.2.2007)”.

⁵⁸ Kontrata e shkëmbimit të mjeteve nr. ***, datë 13.9.2005.

⁵⁹ Kontrata e shitjes së automjetit me tagra ***, nr. ***, datë 25.1.2007.

⁶⁰ DPSHTRr-ja me nr. ***, datë 21.4.2020.

⁶¹ Kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 14.2.2004.

⁶² Kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 30.3.2008, me shitës A.T. dhe blerës A.B.

6.2.5 Subjekti ka depozituar një deklaratë dore të datës 27.2.2007 me deklarues shtetasin A.T., i cili deklaroi se në datën 27.2.2007 ka marrë diferencën prej 4,000 euro nga shitja e automjetit sipas kontratës së datës 25.1.2007 nga shtetasi S.Z. Kjo deklaratë është nënshkruar edhe nga shtetasi S.Z.

6.2.6 Komisioni ka hetuar dhe çështjen e konfliktit të interesit të subjektit Etleva Temo me shtetasit G.A. dhe S.Z., duke kryer korrespondencë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe Gjykatën e Apelit Korçë.

6.2.7 Gjykata së Rrethit Gjyqësor Pogradec⁶³ konfirmon se shtetasit G.A. dhe S.Z. nuk kanë pasur çështje të gjykuara nga subjekti Etleva Temo.

6.2.8 Gjykatës së Apelit Korçë⁶⁴ konfirmon se për shtetasin S.Z. nuk ka pasur çështje të gjykuara nga subjekti, ndërsa për shtetasin G.A., subjekti ka qenë pjesë e trupës që ka gjykuar çështjen civile në vitin 2018 me paditës G.A. dhe i paditur UK Pogradec me objekt dëmshpërblim page, e cila ka përfunduar më lënie në fuqi të vendimit në favor të shtetasit G.A.⁶⁵. Subjekti ka qenë, gjithashtu, pjesë e trupës në gjykimin e çështjes me kërkues G.A., person i tretë UK Pogradec me objekt plotësim vendimi, e cila ka përfunduar me pranimin e kërkesës së shtetasit G.A.⁶⁶.

6.2.9 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës me rezultatet e hetimit nga Komisioni, duket se:

a) ka veprime fiktive referuar kontratës së shkëmbimit, datë 13.9.2005, e cila ka shërbyer për ndërrimin e pronësisë së automjetit me targa *** nga shtetasit G.A. në A.T., pasi automjeti me targa ***, rezultoi i shitur nga shtetasi A.T. po në të njëjtën datë (13.9.2005), një shtetasi tjetër, në Berat;

b) personi i lidhur me subjektin, bashkëshorti A.T., nuk ka deklaruar kontratën e shitjes së datës 13.9.2005, të automjetit me targa ***, në DIPP-në e vitit 2005 dhe as në deklaratën *Vetting*;

c) ka mospërputhje deklarimi në pyetësorët drejtuar subjektit të rivlerësimit me të dhënat e DPSHTRr-së referuar dy automjeteve që u shkëmbyen sepse duke krahasuar tipin, fuqinë motorrike dhe vitin e prodhimit nuk ka logjikë ekonomike/financiare të tregut të automjeteve të bëhet një shkëmbim i tillë:

-subjekti ka deklaruar se automjetet ishin të të njëjtit tip, mjeti i saj me targa *** i vitit të prodhimit 1996 ndërsa mjeti tjetër me targa *** me vit prodhimi 1999;

-DPSHTRr-ja pasqyron të dhënat se automjeti me targa *** është i tipit 190 D, i vitit 1986, ndërsa automjeti me targa *** është i tipit 250 D dhe i vitit 1996.

d) ka veprime fiktive referuar kontratës së shitjes, datë 25.1.2007, ku shtetasi A.T. ka shitur automjetin me targa ***, blerësit S.Z. me çmimin 9,000 euro:

- kontrata e shitjes e datës 25.1.2007 nuk është depozituar dhe regjistruar në DPSHTRr;

- në DPSHTRr, për automjetin me targa *** rezultoi e depozituar dhe e regjistruar kontrata e shitjes, datë 30.3.2008, ku z. A.T. ia ka shitur këtë mjet z. A.B. për çmimin 2,000 euro.

e) personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, bashkëshorti A.T., nuk ka deklaruar kontratën e shitjes, datë 30.3.2008, me blerës A.B. në DIPP-në e vitit 2008;

⁶³ Gjykatat e Rrethit Pogradec me nr. *** prot., datë 17.4.2020.

⁶⁴ Gjykata e Apelit Korçë me nr. *** prot., datë 9.4.2020.

⁶⁵ Vendimi nr. ***, datë 18.4.2018, me paditës G.A. dhe i paditur UK Pogradec me objekt dëmshpërblim page.

⁶⁶ Vendimi nr. ***, datë 4.7.2018, me kërkues G.A. dhe person i tretë UK Pogradec me objekt plotësim vendimi.

f) subjekti nuk ka provuar me dokumentacion ligjor shërbimet (e supozuara të kryera sipas deklaramëve të saj në pyetësor) që i janë bërë automjetit me targa *** dhe që kanë ndikuar me rritjen e vlerës së tij (u shit në vlerën 9,000 euro).

g) subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me deklaratë noteriale (sipas parashikimit të kontratës së datës 25.1.2007) pagesën e pjesës së mbetur të çmimit prej 4,000 euro nga shuma totale prej 9,000 euro, por ka depozituar një deklaratë dore me deklarues vetëm shtetasin A.T. dhe me konfirmim nënshkrimi nga shtetasi S.Z.;

h) subjekti i rivlerësimit, është në kushtet e konfliktit të interesit si pjesë e trupës gjyquese në çështjen e gjykuar me palë G.A. dhe duhej të kishte deklaruar heqjen dorë nga gjykimi i dy çështjeve;

i) mungon burimi i krijimit për përfitimin e automjetit me targa *** në momentin e shkëmbimit, për arsye se automjeti me targa *** tashmë ishte shitur,

marrë në konsideratë dhe deklaramët në seancë dëgjimore, ka dhënë shpjegime të njëjta me ato në pyetësorë.

6.2.10 Ndër të tjera, subjekti ka shpjeguar se automjeti “Mercedes-Benz” me targa *** është këmbyer me automjetin “Mercedes-Benz”, blerë në datën 27.9.2002, me targa ***, sipas kontratës së shkëmbimit të vitit 2005.

6.2.11 Në lidhje me ekzistencën e dy kontratave të lidhura në të njëjtën datë, subjekti ka prapësuar se prej saj dhe bashkëshortit disponohet vetëm kontrata e shkëmbimit te noter Th. B., Pogradec, si dhe sipas shpjegimeve bashkëshorti nuk ka pasur asnjë kontakt me shtetasin F.Ç. dhe nuk ka realizuar asnjë kontratë shitje. Në këtë moment janë vënë në dijeni për këtë kontratë që është hartuar pa dijeninë e bashkëshortit. Ndër të tjera, subjekti prapëson se veprimet e vetme kanë qenë ato për shkëmbimin e mjetit, i cili pasi është marrë dhe është lidhur kontrata, është regjistruar në DPSHTRr. Edhe në sensin logjik nuk ka asnjë arsye të përpilohen dy kontrata në të njëjtën ditë për të njëjtin send nga shitësi.

6.2.12 Në lidhje me shkëmbimin e mjeteve, subjekti ka dhënë po të njëjtat shpjegime si në pyetësorë lidhur me defektin e automjetit, riparimin e kryer dhe pagimin e pjesës së mbetur të çmimit prej 4,000 euro, pas përdorimit të automjetit për njëfarë kohe dhe mospërsëritjes së defektit.

6.2.13 Në lidhje me pagesën e shumës 9,000 euro në dy pjesë, subjekti ka prapësuar se blerësit i janë shpjeguar në fillim defektet që ka pasur mjeti dhe ka paguar në fillim shumën 5,000 euro dhe më pas e ka mbajtur provë 1 muaj dhe pasi makina nuk ka dhënë defekt është paguar edhe pjesa prej 4,000 euro. Sipas subjektit nuk ka arsye të dyshohet për veprime fiktive duke qenë se kjo shumë nuk është deklaruar prej saj për të mbuluar një shpenzim të caktuar apo si burim për krijimin e një pasurie

6.2.14 Subjekti në lidhje me pagimin e pjesës prej 4,000 euro nga shtetasi S.Z., ka depozituar deklaratën e dorës datë 27.2.2007.

6.2.15 Lidhur me kontratën e shitjes së automjetit me targa ***, datë 30.3.2008, blerësit A.B. për çmimin 2,000 euro, subjekti sqaron se bashkëshorti i ka shpjeguar se ky shtetas i ka thënë se e kishte marrë makinën nga shtetasi S.Z., por ky i fundit nuk e kishte regjistruar në DPSHTRr, prandaj dhe nuk po bënte dot kalimin e pronësisë. Ndodhur në këto rrethana dhe për çregjistrimin e mjetit nga emri i tij, fakt për të cilin ka ardhur në dijeni në këtë moment duke u konfirmuar nga të dy këta shtetas, është kryer ky veprim juridik nga bashkëshorti duke u konsideruar formal dhe me qëllim çregjistrimin e mjetit jo pronë e tij nga DPSHTRr-ja.

Në përfundim, subjekti shpjegon se: *“Pavarësisht ndonjë pasaktësie apo problematike, të para dhe në kontekstin e kohës dhe tregut të makinave, këto janë veprime juridike të kryera nga*

*bashkëshorti si shpjegova më sipër. Nënvizoj se kjo shumë nuk është deklaruar nga ana ime për të mbuluar një shpenzim të caktuar apo si burim për krijimin e një pasurie. Deklarimi im i vetëm është që nga shitja e kësaj makine është marrë shuma prej 1,850 euro për blerjen e mjetit me targa ***, e cila është në kufij minimalë të çmimit të shitjes së makinës në fjalë.”*

6.2.16 Në lidhje me çështjen e konfliktit të interesit, subjekti ka prapësuar, ndër të tjera, se kontrata e shkëmbimit ka qenë në vitin 2005 dhe në asnjë moment nuk ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit me shtetasin G.A. Në pjesëmarrjen e saj në trupën gjyqësore në vitin 2018, subjekti shpjegon se nuk ka pasur asnjë lidhje apo konflikt interesi sipas nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile. Veprimi juridik i shkëmbimit të mjeteve ka qenë i përfunduar 13 vjet më parë, ku megjithëse nuk ka pasur asnjë pengesë ligjore për pjesëmarrjen në gjykim, edhe në aspektin kohor në kushtet kur nuk ka qenë pjesë e veprimit juridik nuk mund të ketë qenë në dijeni se ka qenë i njëjti person. Në rrethanat kur nuk ka asnjë njohje apo e lidhur me asnjë lloj veprim juridik me këtë shtetas nuk ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit me shtetasin G.A.

6.2.17 Në lidhje me përfitimin e automjetit me targa ***, subjekti ka shpjeguar se burimi i krijimit është nga shkëmbimi me automjetin “Mercedes-Benz” blerë me kontratën e datës 27.9.2002 (me targa ***) .

6.2.18 Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

6.2.18.1 Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me ekzistencën e dy kontratave të hartuara në të njëjtën ditë për të njëjtin automjet në pronësi të shtetasit A.T., përkatësisht ajo e shitjes së automjetit me targa ***, datë 13.9.2005, në Berat, shtetasit F.Ç. dhe ajo e shkëmbimit po e datës 13.9.2008, me shtetasin G.A., në Pogradec.

6.2.18.2 Kontrata e shitjes, datës 13.9.2005, është depozituar në DPSHTRr ku është bërë regjistrimi në pronësi të blerësit F.Ç. dhe më pas ka pësuar transaksione të tjera. Nga verifikimi i dosjes së DPSHTRr, Komisioni vëren se dosja e automjetit me targa ***, pasqyron dokumentacion të plotë që nga pronari i parë, shtetasi B.B., kalimi i pronësisë në emër të shtetasit A.(A.) T., transferimi nga ky i fundit te blerësi F.Ç. dhe transaksione të tjera të mëpasshme.

6.2.18.3 Sipas kësaj procedure, nëse veprimi i shkëmbimit do të ishte veprim i rregullt sipas pretendimit të subjektit, dosja origjinale e automjetit me targa ***, në DPSHTRr, do të ishte në emër të shtetasit G.A. meqenëse ky shtetas e ka përfutur këtë atomjet me anë të shkëmbimit.

6.2.18.4 Subjekti i rivlerësimit, kur është pyetur për kontratën e shkëmbimit ka dhënë deklarime kontradiktore në lidhje me karakteristikat e mjeteve, referuar të dhënave që pasqyronin dokumentet e DPSHTRr-së.

6.2.18.5 Subjekti ka deklaruar se këmbimi i mjeteve është bërë meqenëse automjetet ishin të të njëjtit tip vetëm me ndryshimin e vitit të prodhimit, ku automjeti me targa *** ishte i vitit 1996, ndërsa automjeti i shtetasit G.A. i vitit 1999. Dokumentacioni i DPSHTRr-së pasqyron të dhëna të tjera, ku automjeti me targa ***, është i tipit 190D dhe vit prodhimi 1986, ndërsa automjeti me targa ***, i tipit C Class 250D i vitit 1996. Pra, ka një diferencë të theksuar të dy automjeteve duke krahasuar tipin, fuqinë motorrike dhe vitin e prodhimit.

6.2.18.6 Po kështu, referuar veprimit të shkëmbimit të mjeteve, krahasuar tipin, fuqinë motorrike dhe vitin e prodhimit, nuk ka llogjikë ekonomike/financiare të tregut të makinave të bëhet një shkëmbim i tillë ku shtetasi G.A. përfiton një mjet 10 vjet më të vjetër, me fuqi motorrike më të ulët nga mjeti që dispononte (pra, me humbje nga ky transaksion). Shpjegimet e subjektit se automjeti në pronësi të shtetasit G.A. ka qenë me difekt para shkëmbimit dhe atij i janë bërë riparime dhe më pas është shitur për çmimin 9,000 euro, nuk janë bindëse.

6.2.18.7 Referuar kontratarës së shitjes së datës 25.1.2007, ku shtetasi A.T. ia shet automjetin me targa ***, shtetasit S.Z. në shumën 9,000 euro, subjekti nuk ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me çmimin e shitjes 9,000 euro, kur subjekti i është referuar faktit se nga bashkëshorti janë bërë shërbime dhe riparime që i kanë rritur vlerën mjetit, ndërkohë që subjekti nuk depozitoi asnjë dokument ligjor që të provonte kryerjen e këtyre shërbimeve.

6.2.18.8 Në lidhje me pagesën e bërë nga shtetasi S.Z. si pagesë e dytë në shumën 4,000 euro (pasi shuma prej 5,000 euro që sipas deklaramit është paguar në fillim) nuk rezulton se pagesa prej 4,000 euro është paguar duke u shoqëruar me deklaratë noteriale sipas përcaktimit të kontratës së shitjes së datës 25.1.2007. Subjektit ka depozituar një deklaratë dore të datës 27.2.2007 me deklaruës A.T. i cili deklaroi se ka marrë diferencën prej 4,000 euro nga S.Z.

6.2.18.9 Lidhur me kontratën e shitjes së datës 30.3.2008 të ndodhur në dosjen e DPSHTRr-së të lidhur me shtetasin A.B., subjekti nuk ka dhënë shpjegime bindëse kur ka shpjeguar se kjo është lidhur në kushtet kur ndryshimi i pronësisë nuk ishte bërë nga S.Z. dhe është bërë nga bashkëshorti si veprim formal me qëllim çregjistrimi. Komisioni vëren që edhe pse ky ka qenë veprim formal i pretenduar, duhej të ishte deklaruar nga subjekti me shpjegimet përkatëse.

6.2.18.10 Komisioni krijon bindjen se personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit, ka kryer veprime fiktive duke lidhur dy kontrata shitblerje për të njëjtin automjet, konkretisht, kontratën e shitblerjes, datë 25.1.2007, me vlerë 9,000 euro me blerësin S.Z., e cila nuk rezulton të jetë depozituar dhe regjistruar në DPSHTRr dhe kontratën e shitblerjes, datë 30.3.2008, me blerës A.B. për çmimin 2,000 euro, kontratë kjo e depozituar në DPSHTRr, por që nuk është deklaruar asnjëherë nga subjekti i rivlerësimit në DIPP. Ky fiktivitet përforcohet edhe nga fakti se bashkëshorti i subjektit, për të njëjtin automjet brenda një periudhe kohore prej 14 muajsh, përveçse firmos dy kontrata shitje, pasqyron në to një diferencë çmimi nga 9,000 euro në kontratën e datës 25.1.2007, në 2,000 euro në kontratën e datës 30.3.2008, një diferencë komplet e pajustificuar (pa dhënë asnjë arsye) për intervalin kohor kur janë firmosur këto kontrata dhe për logjikën e çmimeve në tregun e automjeteve.

6.2.18.11 Komisioni vëren se automjeti “Mercedes-Benz”, me targa *** nuk është disponuar nga bashkëshorti i subjektit në datën 13.9.2005, kur është bërë shkëmbimi, pasi po në këtë datë, shtetasi A. T. ia ka shitur këtë automjet shtetasit F.Ç. dhe në këto kushte mungon burimi i krijimit të këtij automjetit me targa ***.

6.2.18.12 Pavarësisht shpjegimeve të subjektit dhe pavarësisht se për automjetin me targa *** veprimet janë kryer nga personi i lidhur me subjektin, bashkëshorti A.T., Komisioni vlerësoi se është pasuri në bashkëpronësi e vënë gjatës martesës dhe të dy bashkëshortët gëzojnë si të drejta ashtu edhe detyrime në lidhje të. Gjykimi i çështjes gjyqësore në vitin 2018, nga subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, me palë ndërgjyqëse G.A., i cili ka rezultuar fitues, marrë për bazë nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile⁶⁷, është kryer në situatë konflikti interesi të subjektit me këtë shtetas sepse sipas rrethanave konkrete vërtetohen arsye serioze njëanshmërie, pasi vërtetohet që personi i lidhur me subjektin, bashkëshorti dhe subjekti, kanë përfituar automjetin me targa *** nga shtetasi G.A. me anë të veprimit të shkëmbimit, veprim ky dukshëm në favor të bashkëshortit të subjektit, pasi automjeti në pronësi të shtetasit G.A., ka qenë 10 vjet më i ri se mjeti në pronësi të shtetasit A. T., ka qenë me defekte të rënda dhe i aksidentuar dhe pas riparimit është shitur nga bashkëshorti i subjektit jashtë çdo logjike ekonomike në lidhje me çmimet e makinave të të njëjtit model dhe të njëjtit vit prodhimi, për çmimin 9,000 euro (në një kohë kur pas 14 muajsh bashkëshorti i subjektit firmos një tjetër kontratë shitje për këtë automjet

⁶⁷ Neni 72 i Kodit të Procedurës Civile “Rastet e përjashtimit të gjyqtarit” parashikon në pikën 1 se gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështje kur “1. ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë gjykim; dhe pika 6 “në çdo rast tjetër kur vërtetohen sipas rrethanave konkrete arsye serioze njëanshmërie”.

për çmimin 2,000 euro), dhe për më tepër, mjete që supozohet t'i ketë kaluar nëpërmjet këmbimit shtetasit G.A., rezultojnë t'i jetë shitur në të njëjtën ditë shtetasit F.Ç., çka do të thotë se bashkëshorti i subjektit nuk ka dhënë automjet tjetër në shkëmbim.

6.2.18.13 Komisioni krijoi bindjen se nga personi i lidhur me subjektin, bashkëshorti A.T., janë kryer veprime fiktive dhe deklarim i rremë në lidhje me automjetin tip “Mercedes- Benz”, me targa ***, pasi ky automjet është përfituar nga këmbimi, por që faktikisht subjekti dhe personi i lidhur me të nuk rezultojnë t'i kenë dhënë këmbyesit automjet tjetër në këmbim, pasi është shitur në po të njëjtën ditë blerësit F.Ç.

6.2.18.14 Nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshorti A.T., janë kryer veprime fiktive në lidhje me shitjen e automjetit me targa ***, në shumën 9,000 euro, pasi subjekti nuk vërtetoi shpenzimet dhe riparimet e këtij automjeti me dokumente ligjore, që kanë shërbyer për rritjen e vlerës së mjetit, kontrata e shitjes e datës 25.1.2007, nuk vërtetoi pagesën e diferencës së shumës prej 4,000 euro nga shtetasi S.Z., si dhe kjo kontratë nuk ka rezultuar e regjistruar në DPSHTRR dhe, për më tepër, që bashkëshorti i subjektit, pas 14 muajsh në datën 30.3.2008, firmos një tjetër kontratë shitje për të njëjtin automjet, përkundrejt çmimit 2,000 euro. Edhe sikur të merret i mirëqenë pretendimi i subjektit se veprimi është kryer prej bashkëshortit, kjo nuk përjashton detyrimin e subjektit që të verifikojë dhe të ndalojë veprime të bashkëshortit që vijnë në kundërshtim me ligjin, aq më tepër që veprimet fiktive të kryera prej tij janë një rast i përsëritur. Kjo është vlerësuar nga Komisioni edhe në kontekstin e ligjit nr. 9043/2003, i ndryshuar, apo edhe të ligjit nr. 84/2016, të cilët jo më kot kanë parashikuar detyrimin për deklarim edhe të bashkëshortëve/bashkëjetuesve të subjekteve.

6.2.18.15 Komisioni vëren se subjekti dhe bashkëshorti kanë deklaruar vetëm kontratën e shitblerjes së mjetit në datën 25.1.2007 për çmimin 9,000 euro dhe jo kontratën e shitblerjes për të njëjtin automjet, datë 30.3.2008, për çmimin 2,000 euro dhe kjo pasaktësi në deklarim, marrë shkas nga konsiderimi si shitjes së mjetit në datën 25.1.2007, për çmimin 9,000 euro, si veprim fiktiv, gjithashtu, edhe për faktin se në DPSHTRR rezultojnë e regjistruar vetëm kontrata e shitblerjes së po të njëjtit mjet për çmimin 2,000 euro passjell marrjen në konsideratë në analizë financiare vetëm të shumës 2,000 euro.

6.2.18.16 Subjekti i rivlerësimit është ndodhur në situatën e konfliktit të interesit kur ka gjykuar çështje me palë shtetasin G.A. në vitin 2018, pasi lidhja e kontratës së shkëmbimit ndërmjet bashkëshortit të subjektit A.T. dhe shtetasit G.A., veprim ky dukshëm në favor të bashkëshortit të subjektit, përbën një rrethanë konkrete që të krijon bindjen se ekziston një arsye serioze njëanshmërie për të cilën subjekti duhet të kishte hequr dorë nga gjykimi i çështjes.

6.3 Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa *, blerë me kontratën e datës 16.5.2007, në vlerën 1,850 euro (i shitur)**

6.3.1 Në DIPP-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar: *“Autoveturë tip ‘Mercedes-Benz’ me targa ***, në vlerën 1,850 euro në bashkëpronësi me bashkëshortin, pjesë 50%. Blerë me kontratën e datës 16.5.2007, nga shitja e automjetit të mëparshëm në shumën 9,000 euro”*.

Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar: *“Blerje automjeti ‘Ford...’ blerë nga shitja e automjetit ‘Mercedes-Benz’, me targa ***, në shumën 3,500 euro dhe 500 euro nga kursimet”*.

6.3.2 Subjekti ka depozituar: (i) kontratën e blerjes⁶⁸, datë 16.5.2007, me shitës F. Ç. dhe blerës A.T. për automjetin ‘Benz Daimler Chrysler’, me targa *** me çmimin 1,850 euro; (ii) kontratën e shitjes⁶⁹, datë 31.7.2013, me shitës A.T. dhe blerës G.L. për automjetin ‘Mercedes-Benz’, me targa ***, me çmimin 3,500 euro”.

⁶⁸ Kontrata e blerjes nr. ***, datë 16.5.2007.

⁶⁹ Kontrata e shitjes së mjetit me targa ***, nr. ***, datë 31.7.2013.

DPSHTRr-ja ka depozituar dosjen e automjetit “Mercedes-Benz C180”, me targa ***, viti i prodhimit 1995, që fillimisht është blerë nga shtetasi F.Ç. në shtetin gjerman në datën 26.3.2007, me çmim 1,390 euro dhe në datën 13.5.2007, ka paguar taksën doganore në shumën prej 224,529 lekësh. Në total automjeti ka kushtuar 173,821 lekë (1,390 euro = kursi ditor 126.49 lekë/euro) + 224,529 lekë = 400,350 lekë.

Pas 3 ditësh pasi u pagua taksa doganore, me kontratën e datës 16.5.2007, shtetasi F. Ç. ia shet A.T. me çmimin 1,850 euro ose 232,008 lekë (1,850 euro =125.41 lekë/euro) dhe praktikisht me humbje në shumën 168,342 lekë. Më pas, ky mjet në datën 31.7.2013 iu shit shtetasit G.L. në shumën 3,500 euro.

6.3.3 Subjekti ka deklaruar si burim për blerjen e automjetit “Mercedes-Benz”, me targa ***, të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, me çmimin 9,000 euro.

6.3.4 Komisioni ka kërkuar nga subjekti të provojë pagesën e tatimit mbi të ardhurat për diferencën ndërmjet çmimit të shitjes dhe atij të blerjes, sipas ligjit për tatimin mbi të ardhurat, pasi automjeti është blerë nga bashkëshorti i subjektit në shumën 1,850 euro në vitin 2007 dhe është shitur më pas në vitin 2013 në shumën 3,500 euro.

Subjekti ka shpjeguar se: *“Referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, i ndryshuar, unë dhe bashkëshorti jemi subjekt i këtij ligji, vetëm për sa i takon tatimit mbi pagën. Kjo diferencë nuk bën pjesë në të ardhurat e tatueshme sipas nenit 8 të këtij ligji”.*

6.3.5 Komisioni ka hetuar dhe mbi ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit Etleva Temo me shtetasin F.Ç. duke kryer korrespondencë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec⁷⁰ dhe Gjykatën e Apelit Korçë⁷¹ dhe nga përgjigjet e administruara nuk u konstatua ndonjë situatë e tillë.

6.3.6 Komisioni ka verifikuar pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (PPKKKO) nëse shtetasi F.Ç. ka qenë person nën hetim apo në procedim pranë kësaj prokurorie dhe nga hetimi⁷² nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.

6.3.7 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar:

- duket se ka pasur veprime fiktive në lidhje me blerjen dhe shitjen e këtij automjeti nga personi i lidhur me subjektin, bashkëshorti A.T. Blerë me çmim më të lirë se është blerë nga shitësi dhe shitur me çmim më të shtrenjtë pas 6 vjetësh përdorim. Shitja e automjetit nga shtetasi A.T. me çmimin 3,500 euro, pothuaj sa dyfishi i çmimit të blerjes (1,850 euro) pas 6 vjetësh, përbën veprim financiar të pajustificuar;

- subjekti i rivlerësimit nuk ka paguar tatimin mbi të ardhurat për diferencën e çmimit të shitjes me atë të blerjes prej 1,650 euro, duke deklaruar se nuk është objekt i ligjit për pagimin e tatimit mbi të ardhurat për diferencën midis çmimit të blerjes dhe shitjes të automjetit;

- duket se ka mungesë të burimit të krijimit për mjetin me targa ***, pasi veprimi i shitjes në datën 25.1.2007 me çmimin 9,000 euro është veprim fiktiv dhe krijohet bindja se këto të ardhura nuk janë përfituar.

Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës me rezultatet e hetimit, ka dhënë shpjegime se:

6.3.7.1 Çmimi i blerjes dhe i shitjes së automjetit janë pasojë vetëm e tregut dhe të asnjë faktori tjetër. Fakti që makina është shitur me çmim më të ulët se është blerë mund të jetë edhe pasojë e problemeve financiare apo të tjera të shitësit. Nuk ka ndikuar asnjë faktor tjetër veç tregut dhe

⁷⁰ Gjykatat e Rrethit Pogradec me nr. *** prot., datë 17.4.2020.

⁷¹ Gjykata e Apelit Korçë me nr. *** prot., datë 9.4.2020.

⁷² PPKKKO me nr. *** prot., datë 21.9.2020.

gjendjes teknike të makinës dhe me këtë çmim është rënë dakord midis shitësit dhe bashkëshortit.

6.3.7.2 Lidhur me tatimin mbi vlerën 1,650 euro përfituar si diferencë nga çmimi i blerjes me të shitjes së automjetit ***, subjekti ka prapësuar se kjo shumë nuk bën pjesë në të ardhurat e tatueshme referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, mbajtur parasysh faktin që kjo shumë në fakt nuk përbën fitim për sa kohë është përdorur për mirëmbajtjen e automjetit në vite dhe çmimi i shitjes reflekton këto shpenzime.

6.3.7.3 Në lidhje me mungesën e burimit të krijimit të automjetit me targa *** përfituar nga shitja e automjetit me targa ***, në shumën 9,000 euro, subjekti ka sqaruar se ka dhënë shpjegime kur është analizuar automjeti me targa ***.

6.3.8 Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

6.3.8.1 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me çmimin e blerjes dhe shitjes së automjetit me targa ***. Për sa i përket çmimit të blerjes së automjetit nga bashkëshorti i subjektit, ku shitësi vetëm pas tre ditësh nga pagesa e doganës ia ka shitur me një humbje prej 168,342 lekësh, Komisioni e konsideron atë një çmim fiktiv.

Komisioni nuk konstatoi ndonjë situatë konflikti interesi të subjektit me shitësin e automjetit, z. F.Ç.

6.3.8.2 Lidhur me çmimin e shitjes së automjetit me targa ***, pas 6 vjetësh përdorimi me vlerë 3,500 euro (ndërkohë që është blerë nga A.T. me çmimin 1,850 euro), Komisioni e konsideron si veprim financiar të pajustificuar. Subjekti nuk ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me shitjen e automjetit për një çmim më të lartë, pasi shpenzimet e mirëmbajtjes nuk janë shpenzime kapitali, por shpenzime të cilat shërbejnë për të mbajtur automjetin në gjendje normale pune, shpenzime këto që nuk janë provuar me dokumentacion nga subjekti i rivlerësimit.

6.3.8.3 Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me mospagimin e tatimit për diferencën midis çmimit të shitjes me atë të blerjes së automjetit. Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar, në nenin 8, “e ardhura e tatueshme”, pika “g” parashikon: *“Të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë”*.

Kjo praktikë është konsoliduar dhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelit me qëndrimin e mbajtur prej tij me vendimin nr. 11/2019, ku ka konkluduar se: *“Për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e automjeteve (diferenca mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së automjetit) për sa kohë nuk u provua pagimi i detyrimit tatimor mbi këtë fitim, vlera e fitimit të realizuar vlerësohet si e ardhur e paligjshme në kuptim të nenit D, pika 3, e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016”*.

Komisioni krijon bindjen se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e automjetit me targa ***, pasi burimi i krijimit i deklaruar nga subjekti ka qenë shuma prej 9,000 euro e përfituar nga shitja e automjetit me targa ***, shitje e cila është konsideruar nga Komisioni si veprim fiktiv i kryer nga personi lidhur me subjektin, për më tepër që po ky automjet është shitur përsëri nga bashkëshorti i subjektit pas 14 muajsh nga shitja e parë për çmimin 2,000 euro. Subjekti ka pasur mungesë burimesh financiare në shumën 1,850 euro për blerjen e automjetit me targa ***.

Komisioni arrin në përfundimin se nga personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, bashkëshorti A.T., janë kryer veprime të pajustificueshme financiare të blerjes dhe shitjes së automjetit me targa *, blerë në vlerën 1,850 euro në vitin 2007 dhe shitur në vlerën**

3,500 euro në vitin 2013, veprime këto që, gjithsesi, penalizojnë dhe subjektin e rivlerësimit.

Subjekti nuk ka paguar tatimin mbi të ardhurat për diferencën midis blerjes dhe shitjes së automjetit me targa *, në përputhje me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, si dhe vendimit nr. 11/2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Për këtë arsye nga Komisioni, në analizën financiare të vitit 2013, është marrë në konsideratë si e ardhur nga shitja e automjetit vlera deri në masën e çmimit të blerjes prej 1,850 euro.**

6.4 Automjet tip “Daimler Chrysler”, me targa *, blerë me kontratën nr. ***, datë 1.8.2013, në vlerën 3,800 euro, kthyer shitësit për shkak defekti teknik.**

6.4.1 Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti nuk e ka deklaruar blerjen e këtij mjetei.

6.4.2 Subjekti ka depozituar: (i) kontratën e blerjes së automjetit me targa ***, datë 1.8.2013⁷³, me shitës Th.V. dhe blerës A.T., me çmimin 3,800 euro, nga i cili 800 euro është paguar para redaktimit të kontratës, ndërsa 3,000 euro do të paguheshin brenda datës 1.10.2013; (ii) deklaratën noteriale⁷⁴, datë 10.8.2013, me deklarues Th.V. dhe A.T. të cilët deklarojnë se janë dakord të shfuqizojnë kontratën e shitjes (datë 1.8.2013), pasi automjetit iu konstatuan të meta teknike në motor. Blerësit A.T. iu kthye shuma prej 800 euro që ishte pjesë e çmimit të paguar prej tij ndërsa automjeti iu kthye shitësit Th.V. pa vërejtje për gjendjen në të cilën ndodhet.

6.4.3 DPSHTRr⁷⁵ ka depozituar dosjen e automjetit “Mercedes-Benz”, me targa ***, ku rezulton se fillimisht ka qenë në pronësi të shtetasit Th.V., i cili me kontratën e shitjes, datë 1.8.2013, ia shet shtetasit A.T. Më pas me kontratën datës 27.9.2013⁷⁶ shitësi A.T. ia shet përsëri Th.V. me çmimin 3,800 euro paguar përpara redaktimit të kontratës.

6.4.4 Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime në lidhje me arsyen se përse në kontratën e shitjes datë 1.8.2013, personi i lidhur me të bashkëshorti A.T. ka paguar vetëm 800 Euro ndërsa 3000 Euro do paguheshin brenda 2 muajsh; Përse nuk është deklaruar kontrata e shitjes datë 27.9.2013 (kontratë e depozituar në DPSHTRR) që A.T. ka lidhur me Th.V.

Subjekti ka shpjeguar se: “Për mjetein e blerë me kontratën e shitjes, datë 1.8.2013, shitësi Th.V. i ka bërë me dije bashkëshortit tim se mjetei ka qenë me defekt teknik dhe ishte riparuar nga Th.V. Për këtë arsye është paguar fillimisht shuma prej 800 euro për t’u mbajtur mjetei në provë dhe shuma tjetër do të paguhej brenda dy muajve. Meqenëse mjetei brenda këtij afati shfaqti përsëri defektin, u bë kthimi i mjeteit dhe palët shkuan në gjendjen e mëparshme. Meqenëse veprimi juridik i shitjes nuk është realizuar, palët kanë shkuan në gjendjen e mëparshme dhe nga ana ime është konsideruar veprim juridik nul, i cili nuk ka sjellë asnjë pasojë. Në këto kushte nuk është deklaruar një veprim i tillë”.

6.4.5 Komisioni ka hetuar dhe mbi ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit Etleva Temo me shtetasin Th.V. duke kryer korrespondencë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec⁷⁷ dhe Gjykatën e Apelit Korçë⁷⁸ dhe nga përgjigjet e kthyer, nuk u konstatua ndonjë situatë e tillë.

⁷³ Kontrata e blerjes së mjeteit “Mercedes-Benz”, me targa *** me nr. ***, datë 1.8.2013.

⁷⁴ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 10.8.2013.

⁷⁵ DPSHTRr-ja me nr. *** prot., datë 30.1.2020.

⁷⁶ Kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 27.9.2013.

⁷⁷ Gjykatat e Rrethit Pogradec me nr. *** prot, datë 17.04.2020

⁷⁸ Gjykata e Apelit Korçë me nr. *** prot., datë 9.4.2020.

6.4.6 Komisioni ka verifikuar pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (PPKKKO) nëse shtetasi Th.V. ka qenë person nën hetim apo në procedim pranë kësaj prokurorie dhe nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë⁷⁹.

6.4.7 Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me mosdeklarimin e automjetit me targa ***, i cili është blerë nga personi i lidhur me subjektin, bashkëshorti A.T. dhe i është kthyer përsëri shitësit po brenda vitit për shkak defekti.

Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me mosdeklarimin e automjetit “Mercedes-Benz”, me targa *, gjithashtu, nuk u konstatua ndonjë situatë konflikti interesi i subjektit me shitësin Th.V.**

7. Llogari kursimi individuale në “ProCredit Bank” e mbyllur në datën 20.5.2016. Tërhequr shuma 13,826 lekë si pasuri bashkëshortore.

7.1 “ProCredit Bank”⁸⁰ konfirmon llogarinë e depozitës në emër të subjektit e cila në datën e maturimit 13.2.2016 është në vlerën 13,826 lekë.

Komisioni konstatoi se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin bankar.

8. Llogari bankare në BKT, ku bëhej kalimi i pagës së subjektit, e cila është përdorur për shkak të urgjencës për dërgimin e shumës 13,979 USD në datën 14.5.2013, nga z. A.N., bashkëshorti i motrës, me banim në SHBA, në favor të babait (të ndjerit H.Z.) për ndërhyrje kirurgjikale – shuma është tërhequr po atë ditë – kjo shumë nuk hyn në të ardhurat e subjektit.

8.1 BKT-ja⁸¹ konfirmon transfertën në hyrje në llogarinë bankare në USD të subjektit në shumën 13,979 USD, ose konvertuar⁸² në 1,513,926 lekë, në datën 14.5.2013, të urdhëruar nga shtetasi A.N. Kjo shumë është tërhequr *cash* po në datën 14.5.2013 nga shtetasi B.K., sipas prokurës së posaçme nr. ***, datë 13.5.2013.

8.2 Subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2013 shumën e transferuar në llogarinë bankare në monedhën USD, në të cilën nuk rezultojnë veprime të tjera përveç veprimit të transferimit dhe tërheqjes *cash* të shumës 13,979 USD në datën 14.5.2013.

8.3 Subjekti ka depozituar faturën tatimore nr. ***, datë 14.5.2013, në emër të të ndjerit H.Z., të lëshuar nga Spitali A. për shërbimin mjekësor në shumën 7,400 euro ose 1,042,290 lekë.

8.4 Komisioni i ka kërkuar subjektin të shpjegojë lidhjen me shtetasin B.K., arsyen e tërheqjes së kësaj shume nga ky person, destinacionin e përdorimit, si dhe të depozitohet prokurën e posaçme nr. ***, datë 13.5.2013.

Subjekti ka shpjeguar se: *“Ky shtetas është fis me babanë tim të ndjerë ... Kemi qenë në kushte urgjence dhe unë dhe bashkëshorti im duhej të largoheshim për në Spitalin A. Tiranë... Për këtë arsye i është dhënë prokura këtij shtetasi në kushte edhe të besimit dhe gatishmërisë, i cili pasi ka tërhequr këtë shumë e ka sjellë tek mamaja ime në Spitalin A. Tiranë. Kjo shumë është përdorur për gjithë shpenzimet e operacionit në zemër që ka kryer babai im i ndjerë.”*

Subjekti ka depozituar prokurën e posaçme datë 13.5.2013⁸³, dhënë shtetasit B.K., ku i jep te drejtën e tërheqjes së shumës 14,000 USD në llogarinë e saj në BKT.

⁷⁹ PPKKKO me nr. *** prot., datë 21.9.2020.

⁸⁰ Shkresë nr. Prot. ***, datë 31.0.2020, e “ProCredit Bank”.

⁸¹ Shkresë nr. *** prot., datë 6.2.2020, e BKT-së.

⁸² Konvertuar sipas BSH-së me kursin e këmbimit 108.3, të datës 14.5.2013.

⁸³ Prokurë nr. ***, datë 13.5.2013.

8.5 Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime: (i) në lidhje me diferencën e mbetur në shumën 471,636 lekë (nga shuma prej 13,949 USD ose e konvertuar në 1,513,926 lekë, nga të cilat janë përdorur për të ndjerin H.Z. 7,400 euro ose 1,042,290 lekë); (ii) të shpjegojë nëse shuma e dërguar nga shtetasi A.N. ishte shumë e dhënë hua apo dhurim; (iii) të provojë me dokumentacion në formën e kërkuar nga ligji burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetasit A.N. për krijimin e shumës 13,949 USD, dërguar në llogarinë e subjektit në BKT.

Subjekti ka shpjeguar se: “(i) *totali i shumës së shpenzuar ka qenë 1,615,868.20 lekë. Kjo shumë rezulton nga ‘aktmarrëveshja me Spitalin A. datë 13.4.2018 dhe përfaqëson të gjitha shpenzimet e kryera për shërbimet shëndetësore të pacientit H.Z. Pra, nuk ka asnjë diferencë të mbetur nga shuma e mësipërme.*

(ii) kjo është shumë e dhuruar (e dhënë për ndërhyrje kirurgjikale) babait tim të ndjerë; (iii) lidhur me burimin e të ardhurave të A.N. (bashkëshorti i motrës) po paraqes dokumentin ‘taksa për vitin 2013’.”

8.6 Subjekti ka depozituar deklaratën e pagës dhe të taksave⁸⁴ për shtetasin A.N. në vitin 2013, nga ku rezulton se të ardhurat *neto* të përfituara, pasi janë zbritur të gjitha pagesat për taksat dhe kontributet, janë në shumën 38,555.38 USD, si dhe deklaratën e pagës dhe të taksave për shtetasin E.N., nga ku rezulton se për vitin 2013 të ardhurat *neto* të përfituara, pasi janë zbritur të gjitha pagesat për taksat dhe kontributet, janë në shumën 20,602.96 USD. Të ardhurat *neto* të krijuara nga shtetasit A. dhe E.N. janë në shumën 59,158.34 USD.

Shpenzimet jetike⁸⁵ për vitin 2013 për një familje me 4 anëtarë në SHBA janë në shumën 23,834 USD, ku mundësia për kursime është 35,324.30 USD (59,158.34 USD - 23,834 USD). Deri në datën 14.5.2013, të dërgimit të shumës, shtetasja E.N. dhe bashkëshorti i saj kanë pasur mundësi të kursejnë shumën 12,968.37 USD, duke rezultuar me një mungesë burimesh afërsisht prej 1,000 USD.

Në deklaratë noteriale të datës 22.4.2020⁸⁶, shtetasja E.N. deklaroi se: “...*Familja ime e përbërë nga bashkëshorti dhe dy vajza jeton prej vitit 2001 në Jacksonville të SHBA-së dhe gjatë gjithë periudhës kemi qenë dhe jemi në marrëdhënie të rregullta pune, duke realizuar të ardhura rregullisht.*”

8.7 Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime bindëse dhe ka depozituar dokumentacion provues ligjor burimin dhe destinacionin e shumës 13,979 USD, duke mos u konstatuar ndonjë problematikë në lidhje me këtë deklaram.

9. Kontratë huaje midis bashkëshortit të subjektit dhe shtetasit S.K., në shumën 8,000 euro, sipas kontratës noteriale datë 19.1.2015⁸⁷, e vendosur në bankën “Societe Generale Albania”, pasi është kërkuar si garanci për marrjen e vizës në Ambasadën Gjermane për studime për djalin A.T.

⁸⁴ W-2 Form Wage and Tax statement.

⁸⁵ SOURCE: U.S. Bureau of the Census, Current Population Survey, Annual Social and Economic Supplements. For information on confidentiality protection, sampling error, nonsampling error, and definitions, see Weighted Average Poverty Thresholds for Families of Specified Size: 1959 to 2018.

⁸⁶ Deklaratë noteriale e dhënë para noterit publik A.Gj., shteti Florida.

⁸⁷ Kontratë noteriale nr. ***, datë 19.1.2015.

Subjekti ka deklaruar gjithashtu: *kthyer shuma prej 8,000 euro (sipas deklaratës noteriale datë 9.9.2015⁸⁸). Detyrim i shlyer ku shuma e përdorur prej 1,254 euro për pagesë shkollimi është kompensuar me kursimet familjare.*

9.1 Në DIPP-në e vitit 2015, personi i lidhur me subjektin/bashkëshorti A.T. ka deklaruar: *“Marrje huaje nga z. S.K., sipas kontratës noteriale datë 19.1.2015, e vendosur pranë bankës ‘Societe Generale Albania’ në shumën 8,000 euro për vënie si garanci për marrjen e vizës në Ambasadën Gjermane për studim për fëmijën A.T. Kthyer shuma prej 8,000 euro sipas deklaratës noteriale të datës 9.9.2015⁸⁹”.*

9.2 Subjekti ka depozituar: (i) kontratën e huas datë 20.1.2015⁹⁰, me huadhënës S.K. dhe huamarrës A.T., ku huadhënësi deklaroi se i ka dhënë huamarrësit shumën prej 8,000 euro për një afat 4-vjeçar, i cili fillon nga data 20.1.2015. Kjo shumë e marrë hua do të përdoret për të përballuar shpenzimet për vazhdimin e studimeve të djalit të tij A.T. në shtetin gjerman; (ii) deklaratën noteriale datë 9.9.2015⁹¹, ku shtetasi S.K. deklaroi se iu kthye shuma prej 8,000 euro, e cila ishte depozituar nga deklaruesi A.T. si garanci bankare për të marrë vizë studimesh pranë shtetit gjerman.

9.3 OTP Bank⁹² konfirmon se shtetasi A.T. ka pasur një depozitë në vlerën 8,000 euro të hapur në datën 20.1.2015 dhe të mbyllur më 3.8.2015. Gjatë kësaj periudhe depozita është pakësuar me 400 euro, shumë e cila ka shërbyer për kryerjen e pagesës për studime në favor të Universitetit të Frankfurtit, në shumën 355 euro dhe 45 euro komisione bankare. Me maturimin e depozitës në datën 3.8.2015, mbajtësi i saj ka kryer një pagesë në favor të B.K. për qira në shumën 753.50 euro dhe 45 euro komisione bankare. Me shumën e mbetur prej 6,750 euro është hapur depozitë me afat për periudhën 3.8.2016 – 25.8.2015.

9.4 Komisioni i ka kërkuar subjektit të provojë me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetasit S.K., të cilat kanë shërbyer për krijimin e kësaj shume.

Subjekti, në lidhje me burimin e ligjshëm për krijimin e shumës 8,000 euro, ka depozituar: (a) certifikatë familjare për kryefamiljarin S.K., ku tregohet lidhja familjare me shtetasit L.K. dhe M.K.; (b) certifikatë regjistrimi të personit të tatueshëm L.K., Person Fizik, me NIPT ***; (c) formularët e deklarimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitet 2014 dhe 2015, me të dhënat në tabelën si vijon:

Tabela nr. 4

Viti	Të ardhurat	Shpenzimet	Fitimi	Tatimi
2014	1,457,730	1,200,000	257,73	25,000
2015	456,000	220,464	235,536	25,000
Total	1,913,730	1,420,464	493,266	50,000

- Llogari bankare me gjendje 506 lekë në datën 20.1.2015, në BKT, e Personit Fizik “L. K.”.
- Certifikatë regjistrimi e personit të tatueshëm “****” sh.p.k., me NIPT ***, me administrator dhe ortak të vetëm shtetasin M.K.

⁸⁸ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 9.9.2015.

⁸⁹ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 9.9.2015.

⁹⁰ Kontratë huaje nr. ***, datë 20.1.2015.

⁹¹ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 9.9.2015.

⁹² OTP me nr. *** prot., datë 27.1.2020.

- Llogari bankare me gjendje 5,776.50 lekë në datën 20.1.2015, në BKT, e Personit Juridik “***” sh.p.k.

9.5 Komisioni, pasi ka bërë verifikimet në sistemin e QKB-së, sipas faqes zyrtare <http://www.qkr.gov.al>, në lidhje me të dhënat financiare për subjektin “***” sh.p.k., ka konstatuar se ky subjekt nuk ka shpërndarë dividendë dhe që nga viti 2013 ka rezultuar me humbje.

9.6 DRT-ja Korçë⁹³ konfirmon se subjekti “L.K.”, Person Fizik, është regjistruar prej datës 21.12.2007 si biznes i vogël, me status aktiv dhe ushtron aktivitet në fushën e aktiviteteve ndihmëse për prodhimet blegtorale. Kjo drejtori ka vënë në dispozicion formularët e deklaramit të tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël për vitet 2010 - 2011, formularët e deklaramit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitet 2014 - 2015, si dhe formularin e detyrimeve në kohë reale, nga ku rezulton se ky subjekt nuk ka detyrime tatimore të papaguara. Të dhënat financiare të formularëve paraqiten si vijon:

Tabela nr. 5

Viti	Të ardhurat	Shpenzimet	Fitimi	Tatimi
2010	1,840,600	1,604,100	236,500	23,650
2011	1,130,000	893,498	236,502	
2014	1,457,730	1,200,000	257,730	25,000
2015	456,000	220,464	235,536	25,000
Total	4,884,330	3,918,062	966,268	

9.7 Komisioni ka hetuar edhe çështjen e konfliktit të interesit të subjektit Etleva Temo me shtetasin S.K., duke kryer korrespondencë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe Gjykatën e Apelit Korçë dhe nga hetimi i kryer^{94/95} nuk u konstatua ndonjë situatë e tillë.

9.8 Komisioni ka verifikuar në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (PPKKKO) nëse shtetasi S.K. ka qenë person nën hetim apo në procedim pranë kësaj prokurorie dhe nga hetimi⁹⁶ nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.

9.9 Komisioni, gjatë hetimit, ka konstatuar se subjekti nuk ka provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetasit S.K. për krijimin e shumës 8,000 euro, dhënë hua bashkëshortit të subjektit.

Në lidhje me këtë konstatim, pas kalimit të barrës së provës me rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentet si vijon:

- a) certifikatë familjare të shtetasit S.K., ku tregohet lidhja me shtetasit L. dhe M.K.;
- b) certifikatë regjistrimi të personit të tatueshëm L.K., Person Fizik, me NIPT ***;
- c) formularët e deklaramit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitet 2014 dhe 2015; llogari bankare në BKT e personit fizik L.K.;
- ç) certifikatë regjistrimi të personit të tatueshëm “***” sh.p.k., me NIPT ***, me administrator dhe ortak të vetëm shtetasin M.K.;
- d) llogari bankare me gjendje 5,776.50 lekë në datën 20.1.2015, në BKT, e personit juridik “***” sh.p.k.

⁹³ DRT-ja Korçë me nr. *** prot., datë 26.5.2020.

⁹⁴ Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Pogradec me nr. *** prot., datë 17.4.2020.

⁹⁵ Gjykata e Apelit Korçë me nr. *** prot., datë 9.4.2020.

⁹⁶ PPKKKO me nr. *** prot., datë 21.9.2020.

9.10 Subjekti ka shpjeguar se në datën 23.4.2014 janë kryer veprime bankare të tërheqjes *cash* në shumën 700,000 lekë dhe tërheqja e shumës 400,000 lekë në datën 24.4.2014 nga administratori i shoqërisë.

Subjekti, përveç dokumentacionit të lartpërmendur, ka paraqitur edhe kontratat e sipërmarrjes/porosisë ndër vite të shoqërisë “***” sh.p.k., me drejtues ligjor S.K., i cili ushtron të drejta ligjore për shitjen e apartamenteve sipas kontratave⁹⁷. Subjekti ka prapësuar se: “*Shuma prej 8,000 euro, duke mos qenë shumë e madhe, mund të jetë edhe rezultat i kursimeve familjare në cash, ku siç rezulton në këtë periudhë, kjo familje ka realizuar mjaft të ardhura që përkojnë edhe me kohën e dhënies së kredisë*”.

9.11 Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

9.11.1 Shtetasi S.K., nën cilësinë e huadhënësit, bazuar në pikën 14 të nenit 3 dhe pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, konsiderohet person tjetër i lidhur me subjektin dhe, si rrjedhojë, ka për detyrim të justifikojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës 8,000 euro.

Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion të plotë ligjor burimin e ligjshëm të shumës 8,000 euro dhënë nga shtetasi S.K.

9.11.2 Rezultoni se për vitin 2015 nuk ka asnjë veprim bankar të kryer në llogarinë bankare të personit fizik L.K. Veprimi i fundit në llogari është i datës 23.4.2014, i tërheqjes *cash* të shumës 700,000 lekë.

9.11.3 Në vitin 2015 nuk ka asnjë veprim të kryer në llogarinë bankare të personit juridik “***” sh.p.k. Veprimi i fundit i kryer është në datën 24.4.2014, i tërheqjes së shumës 400,000 lekë nga administratori i shoqërisë.

9.11.4 Komisioni vëren se fitimi i realizuar në vitet 2010, 2011 dhe 2014 nga Personi Fizik L.K. në një total prej 730,732 lekësh, është i pamjaftueshëm për të përballuar shpenzimet jetike për familjen K. dhe për t’i dhënë hua shumën 8,000 euro subjektit të rivlerësimit.

9.11.5 Gjithashtu, pas dërgimit të barrës së provës, subjekti, si burim të krijimit të shumës 8,000 euro, ka vënë në dispozicion kontratat e porosisë/sipërmarrjes të lidhura nga shoqëria “***” sh.p.k. për periudhën 2009 – 2012, nga ku pretendohet se janë përfituar të ardhura. Komisioni vëren se të ardhurat nga kontratat e lartpërmendura janë vetëm në kuadër deklarativ dhe nuk provohet me dokumentacion marrja e këtyre shumave nga subjekti tregtar, për më tepër këto të ardhura i referohen një periudhe të largët nga data e dhënies së huas, janar të vitit 2015.

9.11.6 Komisioni vëren se subjekti nuk ka provuar burimin e ligjshëm të shumës 8,000 euro marrë hua nga shtetasi S.K., por duke qenë se kjo shumë e depozituar në llogarinë bankare është përdorur në një pjesë të vogël dhe më pas i është kthyer huadhënësit, nuk ka ndikim në analizën financiare.

Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor burimin e të ardhurave të realizuara në shumën 8,000 euro nga shtetasi S.K., në përputhje me pikën 3, të nenin D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016. Duke qenë se si veprim, marrja e huas dhe kthimi i saj kanë ndodhur brenda vitit, ajo nuk ka ndikim në analizën financiare.

PERSONI I LIDHUR ME SUBJEKTIN/BASHKËSHORTI A.T.

10. Shuma 1,000 USD dhuratë nga motra D.T., e tërhequr në datën 7.7.2014 nga BKT-ja, me pjesë takuese 100%; shuma 3,000 USD dhuratë nga motra D.T., e tërhequr në lekë

⁹⁷ Kontratë porosisë nr. ***, datë 23.8.2009; kontratë sipërmarrje nr. ***, datë 23.12.2009; kontratë sipërmarrje nr. ***, datë 23.6.2010; kontratë porosisë nr. ***, datë 16.4.2012; kontratë porosisë nr. ***, datë 9.2.2010.

në shumën 358,162.80 lekë, sipas transfertës bankare datë 7.9.2016, në bankën “Societe Generale”.

10.1 Në DIPP-në e vitit 2014, personi i lidhur me subjektin/bashkëshorti, ka deklaruar: *“Dërguar nëpërmjet BKT-së dhuratë nga motra (D.K.) 1,000 USD, datë 7.7.2014. Pjesa takuese: 100 %”.*

Në DIPP-në e vitit 2016, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: *“3,000 USD dhuratë nga motra D.T. të tërhequra nga banka në lekë në shumën 358,162.80 lekë, sipas transfertës bankare datë 7.9.2016, në bankën ‘Societe Generale’”.*

10.2 Nga verifikimi në BKT⁹⁸ konfirmohet tërheqje *cash* në datën 7.7.2014, nga shtetasi A.T. i shumës 1,000 USD, me përshkrimin “tërheqje nga Money Gram”. Subjekti ka depozituar dokumentin e tërheqjes nga Money Gram, ku konfirmohet dërgimi nga shtetasja D.K. në emër të z. A.T. të shumës 358,162.8 lekë (i barasvlershëm me 3,000 USD).

10.3 Komisioni i ka kërkuar subjektit të provojë me dokumentacion burimin e ligjshëm të krijimit të shumave 1,000 USD dhe 3,000 USD, të dhuruara nga motra e bashkëshortit D.K. (T.) në shtetin amerikan.

10.4 Si dokumentacion provues është depozituar deklarata e pagës dhe e taksave⁹⁹ për shtetasen D.K. në vitin 2014, nga ku rezulton se të ardhurat *neto* janë në shumën 27,316 USD. Shpenzimet jetike për vitin 2014 për një person janë në shumën 12,316 USD.

Me mundësinë për kursime në vitin 2014 në shumën 15,000 USD, shtetasja D.K. ka pasur të ardhura të mjaftueshme për t’i dhuruar të vëllait shumën 1,000 USD më 7.7.2014 (mundësia për kursime deri në qershor të vitit 2014 është në shumën 7,500 USD).

10.5 Gjithashtu, subjekti ka depozituar deklaratën e pagës dhe të taksave¹⁰⁰ për shtetasen D.K. në vitin 2016, nga ku rezulton se ajo ka përfituar të ardhurat *neto* në shumën 26,328.33_USD. Shpenzimet jetike për vitin 2015 për një person janë në shumën 12,486 USD.

Me mundësinë për kursime në vitin 2016 në shumën 13,842.33 USD, shtetasja D.K. ka pasur të ardhura të mjaftueshme për t’i dhuruar të vëllait shumën 3,000 USD më 7.9.2016 (mundësia për kursime deri në gusht të vitit 2016 është në shumën 9,228.22 USD).

Komisioni arrin në përfundimin se shumat 1,000 USD dhe 3,000 USD, dhënë dhuratë nga motra e bashkëshortit, janë krijuar me të ardhura të ligjshme, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, duke mos u konstatuar ndonjë problematikë në lidhje me këtë deklaram.

11. Të ardhura të përfituara si dëmshpërblim në shumën 555,400 lekë, për largimin nga puna nga ALBtelecom sh.a., me vendimin gjyqësor nr. *, datë 14.1.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, lënë në fuqi me vendimi nr. ***, datë 5.6.2014, të Gjykatës së Apelit Korçë .**

11.1 Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar: *“Të ardhura për bashkëshortin, të përfituara si rezultat i largimit nga puna, me vendimin gjyqësor nr. ***, datë 14.1.2014. Shuma: 555,400 lekë në cash”.*

11.2 Subjekti ka depozituar vendimin nr. ***, datë 14.1.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr. ***, datë 5.6.2014. Në total shuma e përfituar është 556,906 lekë.

⁹⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 6.2.2020, e BKT-së.

⁹⁹ W-2 Form Wage and Tax statement.

¹⁰⁰ W-2 Form Wage and Tax statement.

11.3 Subjekti ka depozituar edhe një nxjerrje llogarie nga BKT-ja, datë 10.3.2015, ku pasqyrohet kalimi i shumës prej 555,400 lekësh nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor nëpërmjet shërbimit përmbartimor në emër të shtetasit A.T. (nga shuma 556,906 lekë është mbajtur komisioni bankar vlera 1,506 lekë dhe shuma e transferuar është 555,400 lekë).

Komisioni arrin në përfundimin se deklarimi i subjektit në deklaratën *Vetting* përputhet me dokumentacionin e vënë në dispozicion nga banka në lidhje me transferimin e kësaj shume në llogari të BKT-së.

PERSONI I LIDHUR ME SUBJEKTIN/DJALI A.T.

12. Gjendje llogarie në datën 20.1.2017, sipas vërtetimit të “T. Bank” në Frankfurt, Gjermani, ku pasqyrohen veprimet nga momenti i hapjes së llogarisë për shkollim me datë 30.9.2015, në shumën 5,669.9 euro.

Burimi i krijimit: kursimet e prindërve dhe dhuratë për shkollimin nga shtetasit E. dhe A.N. (tezja dhe bashkëshorti) sipas transfertës datë 26.8.2015, në shumën 5,973.90 USD, në bankën “Societe Generale Albania”.

12.1 Në DIPP-në e vitit 2016, personi i lidhur me subjektin/djali A.T. ka deklaruar: *“Gjendje llogarie në datën 31.12.2016 në ‘T. Bank’, Zustandige filiale Frankfurt Gjermani’ (shumë e dhënë nga prindërit për studim sipas deklarimit të deklaruesit). Shuma: 7,252.94 euro. Pjesa takuese: 100 %”.*

12.2 Nga veprimet bankare të dokumentuara me nxjerrjen e llogarisë në emër të djalit, A.T. në “T. Bank”, konfirmohet gjendje e llogarisë në shumën 6,738.7 euro, në datën 31.12.2016.

12.3 Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë mënyrën e transferimit të ndihmës financiare dërguar djalit në Gjermani dhe mosdeklarimin e kësaj llogarie në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2015.

Subjekti ka shpjeguar se: *“Ndihma financiare i është dhënë djalit në formë cash kur ka ikur për në Gjermani. Në vitin 2015 djali A.T. ka shkuar për të filluar shkollën në Gjermani. Është deklaruar shuma, por jo në llogari, sepse fillimisht është hapur përkohësisht në këtë shumë dhe nga një provim varej qëndrimi në Gjermani dhe llogaria do të mbyllet.”*

12.4 Komisioni i ka kërkuar subjektit që të specifikojë shumën e kursimeve familjare që kanë shërbyer si burim për këtë llogari, si dhe të përcaktojë burimin e krijimit për balancën e çeljes së llogarisë së djalit në shumën 5,000 euro.

Subjekti ka shpjeguar se: *“Kursimet familjare që kanë shërbyer si burim për këtë llogari, përveç shumës së dërguar nga shtetasit E. dhe A.N. për shkollim, derdhur pranë bankës ‘Societe Generale Albania’ në datën 24.8.2015, shuma 5,988 USD, kanë qenë kursimet familjare të deklaruara në deklaratën e vitit 2014, në shumën 500,000 lekë, përfituar nga largimi nga puna e bashkëshortit, 1,000 dollarë dhuratë nga motra D.K. dhe kursime nga pagat deri në momentin e hapjes së llogarisë. Burimi krijimit për balancën e çeljes së llogarisë në shumën 5,000 euro ka qenë shuma e dërguar nga shtetasit E. dhe A.N. për shkollim, derdhur pranë bankës ‘Societe Generale Albania’ në datën 24.8.2015, shuma 5,988 USD”.*

12.5 Në lidhje me kursimet familjare, nga analiza financiare gjithëpërfshirëse për vitet 2014 - 2015 duket se subjekti nuk ka pasur burime të mjaftueshme të ligjshme për pagesën e shpenzimeve, krijimin e pasurisë dhe të likuiditeteve.

12.6 OTP Bank konfirmon në datën 25.8.2015 transfertën në mbërritje të shumës 5,988 USD nga shtetasi A.N., me përshkrimin *“family support”* në llogarinë e A.T. Në po të njëjtën datë A.T. ka tërhequr shumën e mbetur pas zbritjes së komisioneve në shumën 5,973.90 USD.

12.7 Komisioni i ka kërkuar subjektit të provojë me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetasve E. dhe A.N. për dhurimin e shumës 5,988 USD personit të lidhur/djalit të subjektit, A.T.

Subjekti ka shpjeguar se: “*Motra ime E.N. dhe bashkëshorti i saj A. N. jetojnë në SHBA që prej vitit 2001. Për të provuar burimin e të ardhurave që ka krijuar shumën e mësipërme, po ju paraqes: taksat për vitin 2015 nga Departamenti i Shtetit SHBA...*”.

12.8 Subjekti ka depozituar dokumentacion për burimin e ligjshëm të të ardhurave të motrës, sipas formularit të taksave të Departamentit të Thesarit (të SHBA-së) për vitin 2015. Të ardhurat bruto nga pagat të familjes së shtetasve A. dhe E.N. janë në shumën 69,198 USD. Shpenzimet jetike¹⁰¹ për vitin 2015 për një familje me 4 anëtarë në SHBA janë në shumën 24,257 USD, ku mundësia për kursime para zbritjes së taksave është 44,941 USD (69,198 USD - 24,257 USD). Deri në datën e dhurimit 25.8.2016, shtetasja E.N. dhe bashkëshorti i saj kanë pasur mundësi të kursejnë shumën 29,960 USD, duke rezultuar me burime të mjaftueshme për dhurimin e shumës 5,988 USD.

12.9 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ndër të tjera, ka konstatuar se:

- Personi i lidhur me subjektin/djali A.T. nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015 llogarinë bankare në “T.Bank” në shumën 4,510.50 euro.

12.9.1 Subjekti ka depozituar formularët e taksave të Departamentit të Thesarit të SHBA-së për vitin 2015 për të provuar burimin e ligjshëm të shumës 5,988 USD, dhënë dhuratë nga motra dhe bashkëshorti i saj E. dhe A.N. në formën e kërkuar nga ligji, me vulë apostile/të noterizuara dhe të përkthyer.

12.9.2 Në lidhje me mosdeklarimin e kësaj shume nga djali A.T., subjekti ka prapësuar se është deklaruar shuma, por jo në llogari, sepse fillimisht është hapur përkohësisht në këtë shumë dhe qëndrimi në Gjermani varej nga një provim dhe llogaria do të mbyllej, prandaj është mjaftuar me deklarimin e shumës (nisur nga pasiguritë e qëndrimit). Ky ka qenë edhe viti i parë kur ka filluar deklarimin e pasurisë djali i subjektit dhe në vijimësi janë deklaruar rregullisht të gjitha lëvizjet sipas llogarisë në “T. Bank”, duke specifikuar hapjen e saj dhe duke u përfshirë edhe shuma fillestare në të gjitha lëvizjet apo shpenzimet të deklaruara çdo vit.

12.10 Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

12.10.1 Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacionin që provon burimin e ligjshëm të të ardhurave të realizuara nga motra dhe bashkëshorti, E. dhe A.N., në shumën 5,988 USD, dhënë dhuratë subjektit.

12.10.2 Lidhur me mosdeklarimin e llogarisë në vitin 2015 nga personi i lidhur/djali A.T., subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme, për sa kohë kjo llogari është deklaruar prej saj në deklaratën *Vetting*.

Komisioni arrin në përfundimin se shuma 5,988 USD, dhënë dhuratë subjektit nga motra dhe bashkëshorti i saj, E. dhe A.N., është krijuar me të ardhura të ligjshme, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

13. Llogari në vlerën 34.8 euro në “Societe Generale Albania” – depozitë e mbyllur në datën 25.8.2015, e cila është bërë për efekt të vendosjes së garancisë për marrjen e vizës në Ambasadën Gjermane në shumën 8,000 euro, deklaruar nga z. A.T., në deklarimin e pasurisë si shumë e marrë hua nga z. S.K.

¹⁰¹ SOURCE: U.S. Bureau of the Census, *Current Population Survey, Annual Social and Economic Supplements. For information on confidentiality protection, sampling error, nonsampling error, and definitions, see Weighted Average Poverty Thresholds for Families of Specified Size: 1959 to 2018.*

13.1 Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar: “*Llogari pranë ‘Societe Generale Albania’ në vlerën 34.8 euro. Pjesa takuese: 100 %*”.

13.2 OTP Bank¹⁰² konfirmon gjendjen e llogarisë në shumën 34.8 euro në emër të A.T. Nga veprimet bankare rezulton se në datën 20.1.2015 z. A.T. ka depozituar *cash* në llogarinë e A.T. shumën 8,000 euro, me përshkrimin “burim të ardhura marrë hua sipas kontratës së huas nr. ***, datë 20.1.2015.

Komisioni arrin në përfundimin se deklarimi i subjektit përputhet me deklaratën *Vetting* me dokumentacionin e vënë në dispozicion nga BKT-ja.

14. Mbetur pa shlyer shuma që përfaqëson qiranë, sigurimin shëndetësor dhe shkollimin deri në përfundim të vitit shkollor, tetor të vitit 2017, në shumën 3,014.8 euro.

Depozituar dokumentacioni si vijon:

- vërtetimi i “*T.Bank*” Frankfurt, Gjermani, datë 20.1.2017;
- kontratë qiraje datë 15.7.2016;
- dokumenti i sigurimit datë 13.7.2016;
- vërtetimi shkollor datë 13.7.2016 dhe karta e studentit.

14.1 Në DIPP-në e vitit 2016, personi i lidhur me subjektin/djali A.T. ka deklaruar: “*Mbetur pa shlyer shuma që përfaqëson qiranë, sigurimin shëndetësor dhe shkollimin deri në përfundim të vitit shkollor, tetor 2017. Shuma e shlyer: 3,950 euro, mbetur pa shlyer shuma 3,014.8 euro, në total për qiranë dhe sigurimin shëndetësor.*”

Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar shumën 1,254 euro pagesë për shkollim të fëmijës A.T. nëpërmjet OTP Bank,¹⁰³ pagesë e cila konfirmohet edhe nga banka.

14.2 Komisioni nuk ka analizuar detyrimet e mbetura në shumën 3,014.8 euro të deklaruara nga personi i lidhur me subjektin/djali A.T., por ka pasqyruar në mënyrë të përmbledhur shpenzimet e deklaruara prej tij dhe subjektit në deklaratat periodike dhe pyetësorë, si dhe shpenzimet e identifikuar nga pasqyra e llogarisë bankare në “T.Bank”.

14.3 Për vitin 2015 rezulton se totali i shpenzimeve është në shumën:

- 4,931.50 euro nga dokumentacioni bankar;
- 1,254.00 euro nga deklaratimet periodike;
- 2,332.00 euro nga përgjigjet në pyetësorë.

14.4 Për vitin 2016 rezulton se totali i shpenzimeve është në shumën:

- 7,960.03 euro nga dokumentacioni bankar;
- 7,000.00 euro nga deklaratimet periodike;
- 7,991.00 euro nga përgjigjet në pyetësorë.

14.5 Komisioni, gjatë hetimit, ka konstatuar se ka mospërputhje deklarimi në lidhje me shpenzimet e kryera në Gjermani nga djali i subjektit për vitin 2015, pasi në DIPP-në e vitit 2015 ka deklaruar shumën 1,254 euro (pagesa nga OTP Bank), në pyetësorë ka deklaruar shumën 2,332 euro, ndërsa nga dokumentacioni bankar rezulton shuma 4,931.5 euro.

Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ka dhënë shpjegime se lidhur me shpenzimet e kryera referuar lëvizjeve të llogarisë, ka deklaruar: “*Shuma 974 euro qiraja, tërhequr shuma prej 3,000 euro e vënë garanci më vonë për zgjatje vize, nga e cila është shpenzuar për ushqim shuma 1,000 euro. Pra, nga shuma e tërhequr prej 3,000 euro sipas dokumentacionit bankar janë shpenzuar vetëm 1,000 euro,*

¹⁰² OTP Bank, me nr. *** prot., datë 21.1.2020.

¹⁰³ Ish-banka “Societe Generale Albania”.

ndërsa shuma e mbetur prej 2,000 euro cash është kursyer dhe përdorur në vitin pasardhës, prandaj nuk është llogaritur shpenzim. Mbajtur parasysh këtu që prej vitit 2015, djali A.T. ka qëndruar gjithsej rreth 3 muaj në Gjermani. Shuma e dërguar me OTP-në prej 1,254 euro përfaqëson, 2 qira ose kaucion 487 euro, plus 243.5 euro qiraja e muajit shtator, plus tarifa e shkollimit për semestrin e parë 279.5 euro. Pra, shpenzimet 2,332 euro përfaqësojnë: (a) shpenzime personale në vlerën 1,000 euro; (b) shpenzime qiraje (shtator-tetor-nëntor-dhjetor) 974 euro; (c) shpenzime shkollimi, semestri i parë 358 euro”.

14.6 Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me mospërputhjet e shpenzimeve për vitin 2015, pasi subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015 kursime *cash* nga tërheqjet bankare të kryera nga personi i lidhur me subjektin/djali A.T.

Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë deklaram të saktë në përputhje me ligjin, bazuar në pikën 5/a të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

KONSTATIME TË TJERA

15. Në lidhje me llogarinë rrjedhëse të subjektit të rivlerësimit në “ProCredit Bank” ku janë kryer depozitime *cash* nga shtetasit L.M. dhe A.M., përkatësisht në shumat 192,400 lekë dhe 417,830 lekë (gjatë periudhës 2008 – 2011)

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

15.1 Komisioni, në pyetësin nr. 2, i ka kërkuar subjektit të shpjegojë lidhjen që ka me këta shtetas, të cilët kanë kryer për një periudhë të gjatë kohe pagesa periodike në llogarinë e saj, si dhe qëllimin e kryerjes së këtyre pagesave.

Subjekti ka shpjeguar se: *“Shtetasit L.M. dhe A.M. kanë qenë dhe aktualisht janë punonjës të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, respektivisht me detyrë sanitare dhe nëpunës gjyqësor. Në periudhën 2008 - 2011 unë kam ushtruar funksionin e gjyqtarës pranë kësaj gjykate dhe kam pasur marrëdhënie shoqërore me ta. Nisur nga këto marrëdhënie dhe në rastet kur kryenin veprime jashtë gjykatës si dërgimi i akteve apo njoftimeve, në raste të veçanta ju është dhënë nga ana ime pagesa për shkollimin e fëmijëve, e cila bëhej në mënyrë periodike”.*

15.2 Subjekti ka bashkëngjitur si provë deklaratat noteriale¹⁰⁴ të këtyre shtetasve dhe vërtetimet që janë punonjës të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, të cilat i janë vënë në dispozicion prej tyre.

16. Në lidhje me llogarinë e pagës së subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank”, ku për periudhën 2.6.2009 – 2.11.2011, shtetasja F. M. ka kryer me prokurë tërheqjet e pagave të subjektit në shumën 2,434,500 lekë.

16.1 Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë lidhjen që ka me shtetasen F.M., arsyen e tërheqjes së kësaj shume nga kjo shtetase, destinacionin e përdorimit, si dhe të depozitohet prokurën për të.

Subjekti ka shpjeguar se: *“Shtetasja F.M. prej vitit 2000 ka qenë dhe është në marrëdhënie pune pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, me detyrë ekonomiste, arkëtare dhe arkiviste. Në periudhën 2.6.2009 – 2.11.2011 unë kam ushtruar funksionin e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe me këtë shtetase kam pasur marrëdhënie shoqërore. Kësaj shtetaseje i është dhënë prokurë nga ana ime për të tërhequr pagën në ‘Raiffeisen Bank’, pasi*

¹⁰⁴ Deklaratë e përbashkët noteriale nr. ***, datë 29.4.2020.

ka shkuar për të kryer veprime në këtë bankë që i vinin nga detyra dhe njëkohësisht bënte edhe tërheqjen e pagave...”.

16.2 Subjekti ka depozituar prokurën nr. 968/679, datë 2.6.2009, ku subjekti autorizon shtetasen F.M. për tërheqjen e pagës së tyre çdo muaj.

17. Në lidhje me llogarinë e kredisë të subjektit të rivlerësimit në “Tirana Bank”, ku rezulton se janë kryer depozitime cash nga shtetasit A.M. dhe G.D., përkatësisht në shumat 6,298 euro dhe 1,075 euro (gjatë periudhës 2008 – 2011).

17.1 Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë lidhjen me shtetasit e lartpërmendur dhe qëllimin e këtyre pagesave në mënyrë periodike të kryera prej tyre në llogarinë e saj.

Subjekti ka shpjeguar se: *“Shtetasi A.M., që prej vitit 1996 është punonjës i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, me detyrë (ftues), nëpunës gjyqësor. Unë kam ushtruar funksionin e gjyqtarës në këtë gjykatë për periudhën 1993 – 2014 dhe me këtë shtetas kam pasur marrëdhënie shoqërore pune. Për shkak të marrëdhënieve shoqërore i është dhënë nga ana ime shuma për pagimin e kësteve të kredisë në raste të veçanta kur kam qenë në pamundësi. Shuma ka shkuar për pagimin e kësteve të kredisë. Shtetasi G.D. është shok fëmijërie me bashkëshortin tim dhe kanë marrëdhënie të ngushta shoqërore. Në këto rrethana i është dhënë në raste të caktuara kur bashkëshorti ka qenë në pamundësi, shuma për t’u paguar kësti i kredisë. Shuma ka shkuar për pagimin e kësteve të kredisë”.*

17.2 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, për pikat 15, 16 dhe 17, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar burimet njerëzore të institucionit për interesa personale. Në lidhje me këtë konstatim subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime me ato në pyetësorët e lartpërmendur.

Ndër të tjera, subjekti nënvizon faktin se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka ushtruar funksionin e gjyqtarës dhe jo të titullarit të institucionit apo punëdhënës i shtetasve si më sipër, duke mos pasur kështu asnjë lloj marrëdhënieje interesi apo shfrytëzimi të burimeve njerëzore. Kryerja e pagesave është bërë vetëm brenda kuadrit shoqëror.

17.3 Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni arrin në përfundimin se kryerja e veprimeve në interesin privat të gjyqtarit, subjekt rivlerësimi (tërheqje page, pagesa kredie, pagesa shkollimi) nga nëpunës të administratës së gjykatës ku ky subjekt ka ushtruar funksionin e gjyqtarit gjatë orarit zyrtar, pavarësisht marrëdhënieve shoqërore mes tyre, pavarësisht se janë joprofesionale, nuk mund të konsiderohen deri në atë masë sa të përbëjnë shkak për t’u konsideruar si cenim të etikës së figurës së gjyqtarit.

18. Në lidhje me depozitat bankare në “ProCredit Bank” në emër të subjektit të rivlerësimit në shumat: 50,000 lekë, krijuar në datën 22.1.2004; 2,000 USD, krijuar në datën 5.2.2004; dhe 60,000 lekë, krijuar në datën 17.6.2004.

18.1 Në DIPP-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar: *“Depozitë në të holla në ‘ProCredit Bank’ në shumat 110,000 lekë dhe 700 USD”.* Subjekti nuk ka deklaruar burim krijimi për këto depozita.

18.2 Nga pasqyrat e llogarive¹⁰⁵ në “ProCredit Bank” në emër të subjektit të rivlerësimit konfirmohen depozitat bankare në shumat: 50,000 lekë, krijuar në datën 22.1.2004; 2,000 USD krijuar në datën 5.2.2004 dhe 60,000 lekë krijuar në datën 7.4.2004.

¹⁰⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 31.1.2020, e “ProCredit Bank”.

18.3 Në datën 22.1.2004 subjekti ka depozituar *cash* në llogari shumën 50,000 lekë për hapje depozite 6-mujore, e cila pas maturimit ka vazhduar të qëndrojë në depozitë deri më 16.11.2005 kur është tërhequr përfundimisht në vlerën 54,430 lekë.

Në datën 5.2.2004 subjekti ka depozituar *cash* në llogari shumën 2,000 USD për hapje depozite 6-mujore, e cila në datën e maturimit është rinovuar automatikisht deri sa është transferuar në llogari rrjedhëse në datën 1.11.2004 dhe ku është tërhequr shuma 1,250 euro në po të njëjtën ditë. Shuma e mbetur 757 USD në llogarinë rrjedhëse në vitin 2004 është tërhequr përfundimisht në datën 16.11.2005.

Në datën 17.6.2004 subjekti ka depozituar *cash* në llogari shumën 60,000 lekë për hapje depozite 1-vjeçare, e cila pas maturimit ka vazhduar të qëndrojë në depozitë deri më 16.11.2005, kur është tërhequr përfundimisht në vlerën 63,780 lekë.

18.4 Komisioni, me pyetësorin nr. 4, i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime në lidhje me burimin e krijimit të këtyre depozitave dhe destinacionin e përdorimit të tyre.

Subjekti ka shpjeguar se: *“Burimi i krijimit të depozitave është nga kursimet nga pagat..., kemi jetuar në një banesë me prindërit e bashkëshortit, por me ekonomi të ndarë dhe shpenzimet për jetesë kanë qenë të ulëta. Këto depozita janë përdorur për nevojat familjare, duke plotësuar edhe shumën për blerje apartamenti në vitin 2005.”*

18.5 Referuar deklaratës së pasurisë së vitit 2003 subjekti nuk ka pasur kursime *cash*.

Komisioni ka analizuar mundësinë financiare të subjektit për të krijuar këto depozita sipas shpjegimeve të dhëna për burimin e krijimit, të paraqitur si vijon:

Tabela nr. 6

	Përshkrim	Vlera në lekë
A	Të ardhurat	65,618
1	Kursime më 1.1.2004	0
2	Të ardhura nga paga e subjektit, periudha 1.1.2004 – 31.1.2004	61,658
3	Të ardhura nga asistenca janar, bashkëshorti	3,960
B	Shpenzime	31,288
1	Shpenzime jetike, periudha 1.1.2004 – 31.1.2004	31,288
C	Pasuria	262,260
1	Depozita 50,000 lekë, më 22.1.2004	50,000
2	Depozita 2,000 USD, më 5.2.2004	212,260
	Mundësia financiare për krijimin e depozitave (A-B-C)	-227,930

Për depozitim e shumës 60,000 lekë, më 17.6.2004, subjekti ka pasur në dispozicion pagat e 4 muajve në shumën totale prej 246,638 lekësh dhe pagesat e 4 muajve asistencë në shumën 15,840 lekë. Me këto të ardhura subjekti ka pasur mundësi të paguajë shpenzimet jetike për 4 muaj në shumën 125,152 lekë dhe të depozitojë në bankë shumën 60,000 lekë.

18.6 Komisioni, gjatë hetimit administrativ ka konstatuar se:

- subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e depozitave në shumën 50,000 lekë më 22.1.2004, në shumën 2,000 USD më 5.2.2004 dhe në shumën 227,930 lekë;
- këto depozita nuk mund të shërbejnë si burim për blerjen e apartamentit me sip. 56 m² në Pogradec pasi janë tërhequr në datën 16.11.2005 pas blerjes së apartamentit në datën 20.6.2005.

Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjekti ka dhënë shpjegime se: *“Burimi i krijimit të depozitave është nga kursimet nga pagat. Po i referohem fillimisht vitit 2003, ku edhe sipas*

analizës financiare rezultoj me balancë pozitive 452,334 lekë. Unë kam qenë në marrëdhënie pune pranë Gjykatës Pogradec dhe bashkëshorti në marrëdhënie pune pranë Bankës së Kursimeve, dega Pogradec deri në korrik të vitit 2003 dhe mandej trajtuar me pagesë papunësie deri në qershor të vitit 2004 dhe shpenzimet për jetesë kanë qenë të ulëta. Këto shuma janë kursimet nga viti 1994 (dokumentacioni për të ardhurat është paraqitur në deklaratën Vetting) kur edhe ka filluar martesë e faktit dhe meqë kanë qenë shuma të vogla nuk janë deklaruar cash, por në momentin që janë vendosur në llogari bankare në vitin 2004.

Lidhur me tërheqjen e këtyre shumave në datën 16.11.2005 pas blerjes së apartamentit në datën 20.6.2005, si më sipër, kam shpjeguar se, është e vërtetë që në momentin e blerjes së apartamentit në datën 20.6.2005 këto shuma kanë qenë të depozituara në llogari dhe si të tilla nuk janë konsideruar si borxh nga ana e motrës, pasi siç kam shpjeguar, ka jetuar së bashku me familjen e saj me prindërit e mi dhe kemi rënë dakord që në një moment të dytë të tërhiqen nga ana ime për t'ua dhënë prindërve sipas nevojës diferencën që ka plotësuar kursimet familjare, gjithsej në shumën 300,000 (treqind mijë) lekë. Këtë e tregon edhe fakti që këto shuma janë tërhequr në një ditë për të shlyer diferencën dhe ndonjë shpenzim të vogël për banesën”.

18.7 Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykuës

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit, me të ardhurat e muajit janar, nuk ka pasur mundësi të krijojë depozitat në shumën 50,000 lekë dhe 2,000 USD, pasi ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 227,930 lekë.

Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion burimin e ligjshëm të krijimit të depozitave 50,000 lekë dhe 2,000 USD në vitin 2004, sipas përcaktimit të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

19. Në lidhje me zotërimin e aksioneve në shoqërinë “ALBtelecom” sh.a. nga shtetasit Etleva dhe A.T., secili nga 50 aksione me vlerë 50,000 lekë ose 0,00027 % pjesë e kapitalit të shoqërisë.

19.1 Nga përgjigja e administruar nga QKB-ja¹⁰⁶ konfirmohet se shtetasja Etleva Temo figuron aksionere me 0.000027 % të aksioneve në shoqërinë “ALBtelecom” sh.a. edhe shtetasi A.T. figuron aksioner me 0.000027 % të aksioneve.

19.2 Shoqëria “ALBtelecom” sh.a.¹⁰⁷ konfirmon se duke filluar nga data 23.4.2009 shtetasit Etleva dhe A.T. janë regjistruar në regjistrin e aksioneve të kësaj shoqërie dhe secili prej aksionerëve zotëron 50 aksione, me një vlerë totale prej 50,000 lekësh.

Në lidhje me të ardhurat nga dividendët e zotëruar, nga data 23.4.2009, në të cilën shtetasit Etleva dhe A.T. janë regjistruar në regjistrin e aksioneve të shoqërisë “ALBtelecom” sh.a., Asambleja e Përgjithshme ka vendosur mosshpërndarjen e dividendëve.

19.3 Komisioni ka hetuar edhe çështjen e konfliktit të interesit të subjektit Etleva Temo me shoqërinë “ALBtelecom” sh.a., duke kryer korrespondencë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec¹⁰⁸ dhe Gjykatën e Apelit Korçë¹⁰⁹.

19.4 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka vënë në dispozicion të Komisionit vendime gjyqësore që shoqëria “ALBtelecom” sh.a. ka pasur në këtë gjykatë, por nga verifikimi i tyre ka rezultuar se subjekti Etleva Temo ka gjykuar çështje gjyqësore me palë shoqërinë

¹⁰⁶ Përgjigja nr. *** prot., datë 6.2.2020, e QKB-së.

¹⁰⁷ “ALBtelecom” sh.a., me nr. *** prot., datë 15.4.2020.

¹⁰⁸ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, me nr. *** prot., datë 17.4.2020.

¹⁰⁹ Gjykata e Apelit Korçë, me nr. *** prot., datë 9.4.2020.

“ALBtelecom” sh.a., për periudhën 2000 – 2008, gjatë të cilës nuk ka qenë aksionere e kësaj shoqërie.

Nuk ka rezultuar që subjekti të ketë gjykuar çështje gjyqësore me palë shoqërinë “ALBtelecom” sh.a. në momentin që ajo dhe bashkëshorti kanë zotëruar aksione në datën 23.4.2009.

Gjykata e Apelit Korçë ka vënë në dispozicion të Komisionit vendime gjyqësore që shoqëria ka pasur në këtë gjykatë dhe nga verifikimi i tyre ka rezultuar që në 5 vendime gjyqësore¹¹⁰ subjekti Etleva Temo ka qenë anëtare e trupit gjykues që ka gjykuar çështjet civile, me palë shoqërinë “ALBTelecom” sh.a., të cilat kanë përfunduar në favor të kësaj shoqërie dhe një çështje pjesërisht në favor të saj. Ndërsa në një çështje gjyqësore¹¹¹ subjekti ka qenë kryesuese e trupit gjykues që ka gjykuar çështjen me palë “ALBtelecom” sh.a., e cila ka përfunduar në favor të kësaj shoqërie.

19.6 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se:

- subjekti dhe personi i lidhur/bashkëshorti A.T. nuk kanë deklaruar në deklaratën periodike vjetore të viteve 2009 - 2016 dhe në deklaratën *Vetting* zotërimin e aksioneve në shoqërinë “ALBtelecom” sh.a.;
- subjekti ka zhvilluar procese gjyqësore në situatë konflikti interesi me shoqërinë “ALBtelecom” sh.a., në periudhën 2016 – 2019;
- subjekti, me zotërimin e aksioneve në shoqërinë “ALBtelecom” sh.a., është në kushtet e papajtueshmërisë së ushtrimit të funksionit të gjyqtarit.

Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjekti ka shpjeguar se bashkëshorti i saj ka qenë punonjës në shoqërinë “ALBtelecom” sh.a., Pogradec dhe u janë kërkuar të depozitojnë letra me vlerë, të cilët kanë depozituar 50,000 lekë letra me vlerë, të përkthyer në aksione 0.00027, pjesë aksioni secili. Ky veprim është kryer në vitin 2009 dhe pa qenë të qartë për regjistrimin në regjistrin e aksioneve apo pjesën dhe për subjektin kanë qenë inekzistente. Shoqëria “ALBtelcom” sh.a. nuk ka shpërndarë dividendë, duke ligjëruar faktin se mbledhja e letrave me vlerë ka qenë një formalitet dhe jo me qëllim futjen si aksionerë të punonjësve në këtë shoqëri. Një element i rëndësishëm i konfliktit të interesit është edhe dijenia. Subjekti shpjegon që padijenja e këtyre aksioneve ka qenë aq e qartë, sa të gjitha kërkesat për heqje dorë nga gjykimi i çështjeve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec janë bërë vetëm për shkakun e qenies në marrëdhënie pune të bashkëshortit pranë kësaj shoqërie.

Kjo shpjegon edhe faktin që në gjykatën e apelit, pra, pas vitit 2014, subjekti ka marrë pjesë në gjykimin e çështjeve me palë “ALBtelecom” sh.a., Pogradec, në kushtet kur bashkëshorti kishte ndërprerë marrëdhëniet e punës me të dhe duke mos qenë kështu në situatën e nenit 72/5 të Kodit të Procedurës Civile.

19.7 Vlerësimi i çështje nga trupi gjykues

¹¹⁰ Vendimi nr. ***, datë 5.12.2017, me paditës R. T. dhe të paditur shoqërinë “ALBtelecom” sh.a., me objekt “dëmshtëpërblim page”; vendimi nr. ***, datë 15.11.2018, me paditës shoqërinë “ALBtelecom” sh.a. dhe të paditur Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Korçë, me objekt “përmbushje detyrimi”; vendimi nr. ***, datë 14.11.2018, me paditës shoqërinë “ALBtelecom” sh.a. dhe të paditur Bashkinë Korçë, me objekt “përmbushje detyrimi”; vendimi nr. ***, datë 17.11.2016, me paditës M. Sh. dhe të paditur shoqërinë “ALBtelecom” sh.a., me objekt “dëmshtëpërblim page”, duke vendosur pjesërisht në disfavor të “ALBtelekom” sh.a.; vendimi nr. ***, datë 22.1.2019, me paditës shoqërinë “ALBtelekom sh.a. dhe të paditur Bashkinë Devoll, me objekt “përmbushje detyrimi”.

¹¹¹ Vendimi nr. ***, datë 29.3.2017, me paditës shoqërinë “ALBtelecom” sh.a. dhe të paditur R. Z., me objekt “përmbushje detyrimi”.

19.7.1 Komisioni vëren se subjekti nuk ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me mosdeklarimin e aksioneve në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën *Vetting*, pavarësisht vlerës së vogël të tyre.

19.7.2 Në kushtet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit, i ndodhur në situatën e konfliktit të interesit, referuar nenit 3, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, ku është përcaktuar nocioni i konfliktit të interesit¹¹² që lidh gjendjen ndërmjet detyrës publike me interesat private të një zyrtari, në rastin konkret të subjektit, në të cilën ka interesa të drejtpërdrejta ose të tërthorta, duhej të kishte deklaruar heqjen dorë nga gjykimi i çështjeve gjyqësore ku shoqëria “ALBtelecom” sh.a. ka qenë palë, konform dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, që parashikon heqjen dorë të gjyqtarit nga gjykimi i çështjeve gjyqësore¹¹³.

Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me mosdeklarimin e aksioneve në shoqërinë “ALBtelecom” sh.a. (në deklaratat periodike vjetore dhe atë *Vetting*), pavarësisht vlerës së tyre të vogël.

Subjekti i rivlerësimit, me pjesëmarrjen në gjykimin e çështjeve të shoqërisë “ALBtelecom” sh.a., ndërkohë që ka qenë aksionere e saj, ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, referuar ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe duhet të kishte deklaruar heqjen dorë, sipas dispozitave të nenit 72/5 të Kodit të Procedurës Civile.

20. Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga personi i lidhur me subjektin/bashkëshorti A.T., në shumën 68,440 lekë si menaxher në shoqërinë “**” sh.p.k., për periudhën 12.11.2016 – 31.12.2016.**

20.1 Personi i lidhur me subjektin/bashkëshorti A.T. ka deklaruar në deklaratën *Vetting*: *Të ardhura si menaxher në shoqërinë “****” sh.p.k., për periudhën 12.11.2016 – 31.12.2016, në shumën 68,440 lekë.*

20.2 Nga verifikimi në faqen zyrtare të QKB-së rezulton se shoqëria “****” sh.p.k. është krijuar në datën 2.12.2004 dhe ka si ortak të vetëm shtetasin V.G., ndërsa shtetasit P., B. dhe B.G. kanë qenë administratorë të saj.

20.3 Komisioni ka hetuar edhe çështjen e konfliktit të interesit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe në Gjykatën e Apelit Korçë.

20.3.1 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec¹¹⁴ ka konfirmuar se nuk rezulton që shtetasit V., B., P. dhe B.G. të kenë qenë palë ndërgjyqëse në ndonjë proces civil apo penal për periudhën 1997 – 2014, ndërsa shoqëria “****” sh.p.k. ka pasur në këtë gjykatë dy çështje gjyqësore¹¹⁵, por nuk janë gjykuar nga subjekti i rivlerësimit.

¹¹² Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, që ndikojnë, mund të ndikojnë, ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike.

¹¹³ Neni 72 i Kodit të Procedurës Civile “Rastet e përjashtimit të gjyqtarit”, në pikën 1 parashikon se gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje kur: 1. ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë gjykim; dhe pika 6 parashikon: në çdo rast tjetër kur vërtetohen sipas rrethanave konkrete arsye serioze njëanshmërie.

¹¹⁴ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, me nr. *** prot., datë 27.4.2020.

¹¹⁵ Vendimi nr. ***, datë 12.10.2012, i gjykuar nga gjyqtari E. Ç.; vendimi nr. ***, datë 16.11.2012, i gjykuar nga gjyqtari S.

20.3.2 Gjykata e Apelit Korçë¹¹⁶ konfirmon se nuk rezulton asnjë çështje e regjistruar me palë shtetasit B., P. dhe B.G., ndërsa shoqëria “****” sh.p.k. ka pasur procese gjyqësore në dy prej të cilave subjekti ka qenë pjesë e trupit gjykues dhe, konkretisht, referuar:

- vendimit nr. ***, datë 18.10.2017, në çështjen me palë shoqërinë “****” sh.p.k., ku subjekti Etleva Temo ka qenë anëtare e trupit gjykues dhe në përfundim Gjykata e Apelit Korçë ka vendosur “lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 7.3.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec në favor të shoqërisë “****” në çështjen me palë shoqëria “****” sh.p.k., ku subjekti ka qenë anëtare e trupit gjykues dhe në përfundim Gjykata e Apelit Korçë ka vendosur “lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec në disfavor të shoqërisë “****” sh.p.k.”. Shtetasi V.G. ka marrë pjesë në dy procese të tjera gjyqësore ku subjekti ka qenë anëtare e trupit gjykues dhe konkretisht vendimi nr. ***, datë 7.6.2017, ku subjekti ka qenë anëtare e trupit gjykues dhe Gjykata e Apelit Korçë ka vendosur “lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, në favor pjesërisht të shtetasit V.G.”;

- vendimi nr. ***, datë 7.6.2017, ku subjekti ka qenë anëtare e trupit gjykues dhe Gjykata e Apelit Korçë ka vendosur “lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, në disfavor të shtetasit V.G.”.

20.3.3 Komisioni ka verifikuar në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (PPKKKO) nëse shtetasi V.G. ka qenë person nën hetim apo në procedim pranë kësaj prokurorie. PPKKKO-ja¹¹⁷ ka konfirmuar se shtetasi i mësipërm nuk rezulton të jetë i regjistruar si person nën hetim apo në ndonjë procedim penal.

20.4 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se:

20.4.1 Subjekti duket se ndodhet në një situatë konflikti interesi me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe shtetasin V.G., pasi në vitet 2017 - 2018 ka gjykuar disa çështje ku palë kanë qenë këto subjekte.

Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se bashkëshorti i saj ka qenë i punësuar për një periudhë shumë të shkurtër, 12.11.2016 – 31.12.2016, si menaxher në shoqërinë “****” sh.p.k., ku ka përfutur pagën prej 68,440 lekësh.

20.4.2 Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se në datat 18.10.2017 dhe 7.3.2018, kur edhe janë dhënë vendimet në gjykatën e apelit, bashkëshorti nuk ka qenë i punësuar pranë kësaj shoqërie, duke mos qenë kështu i lidhur në asnjë marrëdhënie me të. Në këto kushte, duke mos qenë e lidhur në asnjë marrëdhënie me shoqërinë “****” sh.p.k., nuk ka pasur shkaqe ligjore për heqjen dorë nga gjykimi, sipas nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile, përveç kësaj nga palët nuk është kërkuar përjashtimi i subjektit nga gjykimi i çështjes. Gjithashtu, edhe vendimmarrja¹¹⁸ në disfavor të kësaj shoqërie tregon se nuk ka kurrfarë qëndrimi subjektiv nga subjekti lidhur me zgjidhjen e çështjes.

20.4.3 Ndërsa, në lidhje me shtetasin V.G., subjekti shpjegon se ka qenë në përbërje të trupit gjykues në dy çështje (të lartpërmendur), ku tek njëra prej tyre gjykata e apelit ka vendosur në favor të këtij shtetasi dhe në tjetrën, duke lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë në disfavor të tij, vlen i njëjti shpjegim si për shoqërinë “****” sh.p.k., pasi, duke mos pasur lidhje apo marrëdhënie me këtë shtetas, subjekti nuk ka pasur shkaqe për heqjen dorë nga gjykimi, referuar parashikimit të nenit 72/5 të Kodit të Procedurës Civile.

20.5 Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

¹¹⁶ Gjykata e Apelit Korçë, me nr. *** prot., datë 30.4.2020.

¹¹⁷ PPKKKO-ja, me nr. *** prot., datë 21.9.2020.

¹¹⁸ Vendimi nr. ***, datë 7.3.2018

20.5.1 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me situatën e konfliktit të interesit dhe vlerëson se pavarësisht faktit se në periudhën e gjykimit të çështjeve, 2017 – 2018, bashkëshorti nuk ka qenë në marrëdhënie pune (12.11.2016 – 31.12.2016) – periudha e gjykimit të çështjeve nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve të punës është shumë e afërt. Po t’i referohemi datës së regjistrimit të çështjeve (dhe jo datës së dhënies së vendimit), diferenca e kohës nga shkëputje në regjistrimin e çështjeve në gjykatën e apelit që janë gjykuar nga subjekti, është periudhë e shkurtër¹¹⁹ dhe, konkretisht, 1 muaj, 5 muaj dhe 11 muaj, që janë gjykuar nga data e shkëputjes së shtetasit A.T. nga marrëdhëniet e punësimit me shoqërinë “***” sh.p.k.

Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, referuar ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, kur ka gjykuar çështjet gjyqësore të shoqërisë “*” sh.p.k. dhe administratorit V.G., ku bashkëshorti i subjektit ka qenë i punësuar, duke mos proceduar me heqjen dorë nga gjykimi, sipas dispozitave të nenit 72/5 të Kodit të Procedurës Civile.**

21. ANALIZA FINANCIARE

Në vijim të analizës financiare të kryer mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, si dhe në deklaratimet periodike ndër vite, duke përfshirë të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e tyre është vlerësuar dhe konkluduar mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare për çdo vit për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

21.1 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasurinë, në shumën prej - 5,247,417 lekësh.

Subjektit iu kalua barra e provës lidhur me konstatimet e mësipërme, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin D të Kushtetutës.

21.2 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ka prapësuar se:

- shpenzimet për udhëtimet janë kryer kryesisht për në Maqedoninë e Veriut, për disa orë, për shkak të afërsisë që ka me Pogradecin dhe për plotësimin e nevojave të ndryshme, si ato shëndetësore, etj;
- vlerat e përfituara nga shitja e automjeteve, për të cilat nuk është paguar tatimi pasi kanë pasqyruar vlerën e mirëmbajtjes së automjetit dhe jo fitimin;
- shpenzimet e mobilimit në shumën 384,000 lekë kanë mbetur nga shitja e apartamentit në shumën 1,700,000 lekë dhe nuk janë shpenzime nga pagat;
- shpenzimet për fëmijët pranë fondacionit “N.” për ushqim duhet të zbriten nga shpenzimet për jetesë;

¹¹⁹ Vendimi nr. ***, datë 7.6.2017, ka si datë regjistrimi akti 6.2.2017, pra diferenca nga data 31.12.2016 është 1 muaj; vendimi nr. ***, datë 7.6.2017, ka si datë regjistrimi akti 6.2.2017, pra diferenca nga data 31.12.2016 është 1 muaj; vendimi nr. ***, datë 7.3.2018, ka si datë regjistrimi akti 13.11.2017, pra diferenca nga data 31.12.2016 është 11 muaj; vendimi nr. ***, datë 18.10.2017, ka si datë regjistrimi akti 18.5.2017, pra diferenca nga data 31.12.2016 është 5 muaj.

- burimi i krijimit të shumës 8,000 euro dhënë hua nga shtetasi S.K. është i ligjshëm, e cila nuk është përdorur, por është kthyer me marrjen e vizës gjermane për shkollimin e djalit, pasi nevojitej si garanci.

- shpenzimet e shkollimit dhe jetesës për djalin A.T. për vitin 2015 janë në shumën 2,332 euro dhe jo 4,931 euro, pasi shuma 2,000 euro e mbajtur *cash* prej tij nga viti paraardhës (2015) është përdorur për të mbuluar shpenzimet e vitit 2016.

21.3 Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

21.3.1 Komisioni vëren se subjekti nuk ka provuar me dokumentacion ligjor shpenzimet e udhëtimeve të kryera prej tij, për të cilat ka pretenduar shpenzime me vlerë më të ulët se ato të llogaritura nga Komisioni.

21.3.2 Komisioni vëren se subjekti nuk ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me mospagimin e tatimit për vlerat e realizuara nga shitja e automjeteve.

21.3.3 Komisioni vëren se shpjegimet e dhëna në lidhje me shpenzimet e mobilimit të deklaruar nga subjekti, të kryera në vitet 2009 dhe 2010, përkatësisht në shumat 200,000 lekë dhe 184,000 lekë, me burim të ardhurat nga shitja e apartamentit në vitin 2008 dhe jo nga pagat, nuk qëndrojnë, pasi subjekti nuk ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore të viteve 2008 dhe 2009 kursime *cash* të krijuara nga të ardhurat nga shitja e apartamentit.

21.3.4 Komisioni vëren se pretendimi i subjektit në lidhje me shpenzimet e ushqimit të kryera në pagesën e fondacionit “N.” qëndrojnë dhe se ato duhet të zbriten nga shpenzimet e llogaritura të shkollimit, pasi janë përfshirë edhe të shpenzimet jetike.

21.3.5 Komisioni vëren se subjekti nuk ka provuar burimin e ligjshëm të shumës 8,000 euro, marrë hua nga shtetasi S.K., por duke qenë se kjo shumë e depozituar në llogarinë bankare është përdorur në një pjesë të vogël dhe më pas i është kthyer huadhënësit, nuk ka ndikim në analizën financiare.

21.3.6 Komisioni vëren se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimi në lidhje me shpenzimet e kryera në vitin 2015 nga djali i tij në Gjermani dhe kursimit *cash* të shumës 2,000 euro në vitin 2015 nuk qëndrojnë, pasi subjekti nuk ka deklaruar të kursyer këtë shumë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015.

21.3.7 Në përfundim, pas analizimit dhe vlerësimit nga trupi gjykues të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit dhe nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, pasi janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat duke filluar nga viti 2003, në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga subjekti në ILDKPKI, deri në vitin 2016, si rezultat i përgjithshëm dhe përfundimtar, ka rezultuar një bilanc negativ në shumën prej 3,216,314 lekësh, sipas tabelës si vijon:

Tabela nr. 7

Viti	Të ardhura	Detyrime	Shpenzime	Pasuri	Rezultati
2003	827,790	-	375,456	-	452,334
2004	819,157	-	375,456	183,259	260,441
2005	1,013,801	1,000,000	450,193	1,618,395	-54,787
2006	798,912	-	767,987	(68,371)	99,296
2007	1,119,229	-	938,694	245,714	-65,178
2008	3,053,993	3,052,500	1,184,309	4,228,803	693,382

2009	1,357,686	-	1,595,469	201,320	-439,103
2010	1,373,736	-	1,608,052	17,729	-252,045
2011	1,451,858	-	1,427,223	(21,267)	45,902
2012	1,524,840	-	1,312,950	(45,364)	257,254
2013	1,865,740	-	1,321,673	404,819	139,249
2014	2,125,324	-	1,978,519	567,554	-420,749
2015	2,197,224	-	2,829,813	965,102	-1,597,691
2016	2,050,908	-	2,702,640	(264,971)	-386,760

Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit rezulton për periudhën 2003 – 2016 me mungesë burimesh të ligjshme në shumën prej -3,216,314 lekësh.

B. KONTROLLI I FIGURËS

22. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka dërguar në Komision, me shkresën nr. *** prot., datë 2.7.2020, raportin mbi kontrollin e figurës nr. ***, datë 30.10.2017, për subjektin e rivlerësimit znj. Etleva Temo, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 30.6.2020, të KDZH-së.

22.1 Grupi i punës ka konkluduar se: *Për subjektin e rivlerësimit, znj. Etleva Temo, nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar dhe konstatohet përshtatshmëria për vazhdimin e detyrës.*

22.2 Vlerësimi i Komisionit në lidhje me kontrollin e figurës

Komisioni vëren se nga hetimi administrativ nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si gjyqtare, në lidhje me kriterin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE TË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

C.1 Rivlerësimi profesional sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 është i bazuar në raportin e përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.”

C.2 KLGJ-ja ka hartuar raportin vlerësues nr. *** prot., datë 27.2.2020, për subjektin Etleva Temo, ku janë analizuar: (a) aftësitë profesionale¹²⁰; (b) aftësitë organizative¹²¹; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale¹²²; dhe d) aftësitë personale dhe angazhimi profesional¹²³.

23. Grupi vlerësues pranë KLGJ-së ka analizuar tri dokumentet e paraqitura nga subjekti dhe konkretisht:

- i. vendimin administrativo-penal nr. ***, datë 28.6.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec¹²⁴, ku subjekti ka gjykuar si gjyqtare e vetme;
- ii. vendimin penal nr. ***, datë 16.12.2015, të Gjykatës së Apelit Korçë¹²⁵, ku subjekti ka qenë relatore;
- iii. vendimin civil nr. ***, datë 17.7.2016, të Gjykatës së Apelit Korçë¹²⁶, ku subjekti ka gjykuar në trup gjykues me tre gjyqtarë, ku ka qenë relatore.

23.1 Komisioni vëren se grupi i punës pranë KLGJ-së, lidhur me tri dokumentet e depozituara nga subjekti, ka konstatuar se:

- në dokumentet 1, 2 dhe 3 nuk janë përdorur gjithmonë të gjitha karakteret e gjuhës shqipe;
- në dokumentet 2 dhe 3 në dispozitiv nuk disponohet për shpenzime procedurale, si dhe nuk tregohet e drejta dhe afati i rekursit;
- në dokumentet 2 dhe 3 vendimi nuk pasqyron të dhëna nëse është ushtruar ose jo rekurs nga palët, por konstatohet se vendimi është i panëshkruar nga trupi gjykues dhe i pavulosur nga sekretaria e Gjykatës së Apelit Korçë.

Në lidhje me këto konstatime, subjekti ka dhënë shpjegimet si vijon:

- *mospërdorimi i të gjitha karaktereve të gjuhës shqipe ka të bëjë me mungesën e elementëve përkatës në tastierë dhe ky rregullim, për shkak të ngarkesës dhe respektimit të afatit të*

¹²⁰ a) *Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë* – subjekti i rivlerësimit ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë; b) *aftësia për të kryer procedurat gjyqësore* – subjekti i rivlerësimit ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim; c) *aftësia për të administruar dosjet* – subjekti i rivlerësimit ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim.

¹²¹ a) *Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë* – subjekti i rivlerësimit ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë; b) *aftësia për të kryer procedurat gjyqësore* – subjekti i rivlerësimit ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim; c) *aftësia për të administruar dosjet* – subjekti i rivlerësimit ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim.

¹²² a) *Etika në punë* – nuk ka të dhëna negative për etikën në punë të subjektit të rivlerësimit; b) *integriteti* – nuk ka të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm; c) *paanësia* – nuk janë evidentuar raste konflikti interesi apo kërkesa për përjashtim gjyqtari.

¹²³ a) *Aftësitë e komunikimit* – subjekti i rivlerësimit komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse; b) *aftësia për të bashkëpunuar* – nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar me kolegët dhe me administratën; c) *gatishmëria për t'u angazhuar* – subjekti i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit.

¹²⁴ Ky vendim gjyqësor i përket kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pogradec kundër të dyshuarit E. M., me objekt “vleftësim të ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

¹²⁵ Vendimi që i përket të pandehurve A. M., E. M., E. F., dhe M. F. të akuzuar për veprat penale “plagosje e rëndë me dashje” kundër dy ose më shumë personave e kryer në bashkëpunim dhe “plagosje e lehtë me dashje” në bashkëpunim, parashikuar përkatësisht nga nenet 88/2 dhe 89 e 25 të Kodit Penal.

¹²⁶ Vendimi civil nr. ***, datë 14.7.2016, i Gjykatës së Apelit Korçë, me paditës R. N. dhe e paditur M. N., me objekt “zgjidhjen e martesës dhe lënien për rritje dhe edukim të fëmijës, detyrimin ushqimor për fëmijën”, parashikuar nga nenet 32, 153 dhe 154 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenet 132, 154, 156, 192/b të Kodit të Familjes.

dorëzimit të dosjeve në moscenim të të drejtës të ankimit, ka qenë tejet i vështirë, pasi merr shumë kohë.

- lidhur me disponimin për shpenzime procedurale në dokumentin 2 nuk janë evidentuar shpenzime të tjera veç mbrojtësit të caktuar kryesisht nga gjykata, të cilat janë evidentuar. Në dokumentin 3 është lënë në fuqi disponimi për shpenzimet gjyqësore në shkallë të parë dhe në gjykim në apel nuk janë evidentuar shpenzime gjyqësore.

- për sa i përket të drejtës së rekursit dhe afatit në çështjet penale, neni 383 i Kodit të Procedurës Penale “Elementët e vendimit” nuk parashikohet shprehimisht si element i vendimit, ndërsa në çështjet civile, neni 310 i Kodit të Procedurës Civile e parashikon, por përdor termin “ankim”.

- në lidhje me konstatimet në dokumentet 2 dhe 3, ku vendimi nuk pasqyron të dhëna nëse është ushtruar rekurs, por konstatohet se vendimi është i panënkruar nga trupi gjykues dhe i pavulosur nga sekretaria, subjekti shpjegon se këto janë veprime të sekretarisë gjyqësore dhe jo të gjyqtarit, por thekson se ka bashkëngjitur vendimet, të cilat janë të nënkruar dhe vulosur.

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme dhe se këto mangësi janë të karakterit minimal, duke mos përbërë shkak për një vlerësim negativ të subjektit, që mund të çojë deri në masën disiplinore të largimit nga puna në lidhje me këtë kriter.

Grupi vlerësues pranë KLGJ-së ka analizuar edhe pesë dosjet e përzgjedhura me short

24. Çështja civile nr. * regj., datë 29.1.2014**, që i përket kërkuesses V. K. dhe person i tretë DRSSH-ja, me objekt “vërtetim i faktit juridik të qenies në marrëdhënie pune me...”, për periudhën 15.4.1990 – 1.1.1992 etj., përfunduar me vendimin nr. ***, datë 22.4.2014 – subjekti ka gjykuar si gjyqtare e vetme.

24.1 Komisioni vëren se grupi i punës pranë KLGJ-së ka konstatuar se gjykimi nga subjekti Etleva Temo ka zgjatur tej afatit 2-mujor të caktuar nga germa “j” e pikës 5 të aneksit 1 të sistemit të vlerësimit, në mosrespektim të standardit për proces të rregullt ligjor, të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

Në lidhje me këtë konstatim, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime se duke marrë parasysh ngarkesën e çështjeve dhe duke mos pasur afate procedurale për caktimin e seancës së radhës, seancat janë planifikuar me afat 20-ditor. Në asnjë rast nuk ka ndodhur shtyrja e seancës nga gjykata për shkak të mosmenaxhimit për kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për zgjidhjen brenda afatit të mosmarrëveshjes¹²⁷. Subjekti shpjegon se zgjidhja e drejtë e mosmarrëveshjes dhe marrja e të gjitha provave të nevojshme si më sipër, prevalon mbi tejkalimin me 25 ditë të afatit 2-mujor për përfundimin e çështjes, kjo në funksion edhe të standardit të procesit të rregullt ligjor, të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

24.2 Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni vlerëson se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me kohëzgjatjen e gjykimit tej afatit të përcaktuar ligjor. Zgjatja e procesit ka ardhur për arsye të përlijtura, ku një seancë është shtyrë për shkaqe shëndetësore të gjyqtares.

¹²⁷ Janë zhvilluar 5 seanca gjyqësore, ku njëra është shtyrë për shkaqe shëndetësore të gjyqtares dhe konkretisht seanca e parë. Seanca e dytë është zhvilluar rregullisht dhe është kërkuar kohe nga pala kërkuese për paraqitjen e një prove, kërkesë e cila është pranuar me vendim të ndërmjetëm. Seanca e tretë, ku edhe është paraqitur personi i tretë, është shtyrë mbi kërkesën e këtij të fundit për shkak se regjistrat ishin voluminozë dhe duhet të verifikonte pretendimin e kërkuesses lidhur me regjistrat. Në seancën e katërt gjyqësore ka përfunduar gjykimi.

Komisioni arrin në përfundimin se problematika e konstatuar nuk përbën shkak të mjaftueshëm për të ngarkuar subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore, në përputhje me nenin 58 të ligjit nr. 84/2016.

25. Çështja penale nr. * regj. them., datë regj. 7.6.2013**, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pogradec¹²⁸, ku subjekti ka gjykuar si gjyqtare e vetme.

Me seancën e datës 9.10.2013, gjykata ka shpallur vendimin: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit F. M. për kryerjen e veprës penale ‘mashtrim me sigurime’ dhe në bazë të nenit 145 të Kodit Penal dënimin e tij me 1 vit burgim. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të këtij dënimi për një afat kohor prej 3 vjetësh, me kusht që të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe brenda kësaj periudhe të mos kryejë vepër tjetër penale”.*

Në dispozitiv shpallet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për të pandehurin dhe vënia e tij në provë për një afat kohe prej 3 vjetësh, me kusht që të mbajë kontakte të rregullta me shërbimin e provës. Po kështu, është disponuar për shpenzimet procedurale, si dhe tregohet e drejta dhe afati i ankimit.

25.1 Komisioni vëren se grupi i punës pranë KLGJ-së konstaton se dispozitivi i vendimit nuk është i plotë. Në vendim disponohet për fajësinë e të pandehurit dhe caktimin e masës së dënimit me burgim, por gjykata nuk është shprehur lidhur me zbritjen e këtij dënimi me 1/3 për shkak të gjykimit të shkurtuar të pranuar nga gjykata në seancën e datës 4.9.2013, të argumentuar në arsyetimin e vendimit, në shkëlqe të germës “d” të nenit 383 të Kodit të Procedurës Penale “Elementët e vendimit”. Vendimi përmban: *d) dispozitivin, duke treguar nenet e zbatuara të ligjit.*

Në lidhje me këtë konstatim, subjekti ka dhënë shpjegime se është e vërtetë që gjykimi i shkurtuar është përmendur vetëm në pjesën arsyetuese të vendimit ku edhe është evidentuar dënimi me një vit burgim. Pikërisht, ky dënim është vënë edhe në dispozitivin e vendimit, pa u shënuar dispozita e gjykimit të shkurtuar. Sipas saj, në rastin konkret, kjo nuk ka sjellë asnjë pasojë për palët. Gjithashtu, ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim i pandehuri në Gjykatën e Apelit Korçë, e cila, me vendimin nr. ***, datë 4.2.2014, ka lënë në fuqi vendimi nr. ***, datë 9.10.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

25.2 Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime të mjaftueshme. Mungesa e vendosjes në dispozitivin e vendimit të dispozitës së gjykimit të shkurtuar, vendim i lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Korçë, nuk justifikon veprimin e gjykatës së apelit që ka lënë në fuqi vendimin me mangësi në dispozitiv, pa u shprehur për këtë mangësi.

Komisioni arrin në përfundimin se kjo mangësi nuk përbën shkak të mjaftueshëm për të ngarkuar subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore, në përputhje me nenin 58 të ligjit nr. 84/2016.

26. Çështja civile nr. * regj. them., datë regj. 11.9.2015**, në Gjykatën e Apelit Korçë, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 15.12.2015,¹²⁹ ku subjekti Etleva Temo ka qenë relatore e çështjes.

¹²⁸ Çështja penale nr. *** regj. themeltar, datë 7.6.2013 regjistrimi, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pogradec kundër të pandehurit F. M., i akuzuar për veprën penale “mashtrim në sigurime”, të parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. ***, datë 9.10.2013.

27. Çështja civile nr. * regj., datë 20.1.2016**, përfunduar me vendimin nr. ***, datë 7.6.2016¹³⁰, ku subjekti Etleva Temo ka qenë relatores e çështjes.

27.1 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. ***, datë 10.12.2015, ka vendosur: *“Pranimin e padisë së paditësit N. P. Zgjidhjen e martesës më të paditurën D. P. E paditura D. P. merr mbiemrin para martese H... Lënien për rritje dhe edukim nënës D. H., duke i njohur babait N. P. të drejtën për të takuar dhe qëndruar me fëmijën dy herë në muaj, fundjavën e parë etj.. Detyrimin e paditësit N. P. të paguajë në favor të fëmijës J. P. detyrimin për ushqim në masën 8,000 lekë/muaj”*.

Gjykata e apelit, me seancën e datës 7.6.2016, ka vendosur: *“Lënie në fuqi të vendimit nr. ***, datë 10.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë”*.

Në lidhje me këto dy dosje gjyqësore, Komisioni vëren se grupi i punës pranë KLGJ-së ka konstatuar se dosja gjyqësore dhe vendimi i arsyetuar janë dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në kryesekretarinë e gjykatës në tejkallim të afatit 10-ditor, të përcaktuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile.

27.2 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj, ka shpjeguar se dorëzimi i dosjeve të arsyetuara në gjykatën e apelit, meqenëse nuk ka pasur një afat të përcaktuar shprehimisht, është bërë duke mbajtur parasysh afatin e rekursit në Gjykatën e Lartë dhe moscenimin e këtij afati. Kjo ka qenë një praktikë e ndjekur gjerësisht në gjykatën e apelit, duke marrë parasysh edhe faktin që i njëjti qëndrim është mbajtur edhe nga KLD-ja në vlerësimin profesional të gjyqtarëve. Në asnjë rast, ka cituar subjekti, nuk ka cenuar të drejtën e palëve për të ushtruar rekurs.

27.3 Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit, përtej moscenimit të së drejtës së palëve për të ushtruar rekurs, duke qenë se vendimi i gjykatës së apelit është i formës së prerë, moszbardhja e tij sipas afateve ligjore ka pamundësuar ekzekutimin e vendimit në kohë reale.

Komisioni arrin në përfundimin se mosdorëzimi i vendimit të arsyetuar (i cili është i formës së prerë) nga subjekti i rivlerësimit, në referencë të nenit 308 të Kodit të Procedurës Civile, në bazë të parimit të proporcionalitetit, nuk vlerësohet deri në atë shkallë sa të përbëjë shkak të mjaftueshëm për të ngarkuar subjektin me përgjegjësi disiplinore, në përputhje me nenin 58 të ligjit nr. 84/2016.

28. Çështja penale nr. * regj. them., datë 12.4.2016 regjistrimi**, përfunduar me vendimin gjyqësor nr. ***, datë 20.7.2016, gjykuar nga subjekti Etleva Temo.

28.1 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit A. D. për veprën penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit rruqor dhe në bazë të nenit 290/3 të Kodit Penal të dënimit e tij me 5 vjet burgim.*

Deklarimin fajtor të të pandehurit A. D. për veprën penale të largimit nga vendi i aksidentit dhe në bazë të nenit 273 të Kodit Penal dhe dënimit me 6 muaj burgim.

Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal në bashkim të dënimeve i pandehuri A. D. të dënohet me dënim të vetëm prej 5 vjet burgim.

Në aplikimin e nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale i zbritet si përfitim ligjor për shkak të gjykimit të shkurtuar me 1/3 e dënimit, duke e dënuar përfundimisht me 3 vjet e 4 muaj burgim etj.”

¹³⁰ Çështja civile nr. *** regj. them., datë 20.1.2016, me paditës N. P., dhe të paditur D. P., me objekt “zgjidhje martesë, lënie për rritje dhe edukim të fëmijës, detyrimin ushqimor për fëmijën etj.”.

28.2 I pandehuri ka bërë ankim ndaj vendimit të gjykatës, ku ka kërkuar aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal për pezullimin e dënimit me burgim, duke paraqitur edhe rrethanat përkatëse.

28.3 Me seancën e datës 20.7.2016, gjykata e apelit ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 15.3.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, lidhur me deklarinimin fajtor të të pandehurit A. D. për veprën penale ‘shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor’ dhe ‘largimin nga vendi i aksidentit’, të parashikuara nga nenet 290/3, 273 të Kodit Penal, si dhe masën e dënimit.*

Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të këtij dënimi për një afat kohe prove prej dy vitesh, me kusht që gjatë kohës së provës i pandehuri të mos kryejë veprë penale tjetër, po kaq të rëndë apo më të rëndë se kjo.

Urdhërohet lirimi i të pandehurit A. D. nga dhomat e paraburgimit pranë IEVP-së Korçë, në qoftë se nuk mbahet për ve tjetër penale.

Lënien në fuqi të vendimit lidhur me llojin e burgut dhe shpenzimet gjyqësore.

28.4 Nga aktet në dosje rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Korçë ka ushtruar rekurs për këtë vendim, duke kundërshtuar vetëm aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim. Dosja ndodhet në pritje për t’u shqyrtuar në Gjykatën e Lartë.

28.5 Komisioni vëren se grupi i punës pranë KLGJ-së ka konstatuar se:

- dosja gjyqësore dhe vendimi i arsyetuar janë dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në kryesekretarinë e gjykatës, në tejkalim të afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale;

- nga seanca e datës 30.6.2016 është bërë shtyrja e seancës në një datë tjetër, më 20.7.2016, pra është caktuar pas 20 ditësh në shkelje të afatit maksimal 15-ditor të parashikuar nga neni 342/2 i Kodit të Procedurës Penale;

- në dosje nuk gjendet i administruar vendimi i gjyqtarit relator për caktimin e seancës gjyqësore të datës 20.7.2016, referuar nenit 333/1 të Kodit të Procedurës Penale;

- në vendim, gjykata ka argumentuar aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, por në dosje nuk gjendet i administruar asnjë akt shkresor që të pasqyrojë kushtet ligjore për aplikimin e kësaj dispozite mbi të cilat është mbështetur gjykata.

Në lidhje me këto konstatime, subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj, si dhe në seancën dëgjimore, ka shpjeguar se:

- *Dorëzimi i dosjeve të arsyetuara në gjykatën e apelit, meqenëse nuk ka pasur një afat të përcaktuar shprehimisht, është bërë duke mbajtur parasysh moscenimin e afatit të rekursit në Gjykatën e Lartë. Kjo ka qenë një praktikë e ndjekur gjerësisht në gjykatën e apelit, duke marrë parasysh edhe faktin që i njëjti qëndrim është mbajtur edhe nga KLD-ja në vlerësimin profesional të gjyqtarëve. Në asnjë rast nuk ka cenuar të drejtën e palëve për të ushtruar rekurs.*

- *Në gjykimin në apel jo gjithmonë ka qenë i mundur respektimi i afatit 15-ditor për shtyrjen e seancës, marrë parasysh këtu gjykimin me trup gjykues me tre gjyqtarë dhe planifikimet e bëra nga gjyqtarët, ngarkesën e çështjeve, si dhe komandimet e gjyqtarëve për gjykim në gjykata të tjera të vendit.*

- *Mungesa e vendimit për caktimin e seancës gjyqësore mund të ketë qenë pasojë e gjykimit me lista gjykimi sipas ligjit të kohës, duke u nxjerrë nga kryetari i gjykatës lista e çështjeve civile për gjykim përfshiheshin edhe çështjet penale. Ky veprim administrativ nuk ka sjellë asnjë pasojë në gjykimin e çështjes, ku palët janë njoftuar rregullisht për ditën dhe orën e gjykimit.*

Gjykata e apelit, mbi ankimin e të pandehurit, ka marrë në analizë kriteret ligjore për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal në rastin konkret. Konkretisht, në vendim, arsyetohet:

“... Neni 59 i Kodit Penal, përcakton: ‘Për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë vjet...’

Gjykata e apelit konkludon se rrethanat e mësipërme janë prezente në gjykim, duke filluar që nga kriteri ligjor i renditur i pari që është rrezikshmëria e pakët e personit.

- I pandehuri A.D. nuk ka qenë i dënuar më parë dhe as me precedentë të mëparshëm penalë. Ka shfaqur pendim për veprën e kryer, qëndrim i mbajtur si gjatë hetimit dhe gjykimit të çështjes, rrethana që tregojnë një rrezikshmëri të ulët të të pandehurit.

- Rrethanat e kryerjes së veprës penale janë të tilla që, pavarësisht së sipas aktit të ekspertimit autoteknik, shkakua determinant i aksidentit është përcaktuar shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor nga i pandehuri; në pikën 2 të aktit të ekspertimit përcaktohet edhe shkelja e rregullave të qarkullimit që ka kryer këmbësori.

- Sjellja pas kryerjes së veprës penale, në vijimësi duke kontaktuar me familjarët e viktimës dhe duke ndihmuar në pakësimin e dëmit të shkaktuar, çka rezulton me normalizimin e marrëdhënieve me palën e dëmtuar, sipas deklaratës noteriale të përmendur.

- Gjendja familjare si kryefamiljar me dy fëmijë të mitur. Në analizë të sa më sipër, Gjykata e Apelit Korçë vlerëson që kërkimi i të pandehurit A.D. për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal është ligjor, rrjedhimisht, duhet të pranohet duke urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim me kusht për dy vjet kohë, gjatë së cilës detyrohet të mbajnë kontakte me Zyrën e Shërbimit të Provës Korçë...”

Pra, kushtet ligjore për aplikimin e kësaj dispozite janë analizuar mbi vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe mbi aktet e shqyrtuara në gjykimin në shkallë të parë, si dhe janë përmendur në arsyetim. Kështu, si aktekspertimi autoteknik, ku siç arsyetohet, shkeljet kanë qenë edhe nga ana e këmbësorit, ashtu edhe deklarata noteriale nr. ***, datë 3.3.2016, për normalizimin e marrëdhënieve me të dëmtuarit, kanë qenë akte të administruara në gjykimin në shkallë të parë.

28.8 Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me aplikimin e dispozitës 59 të Kodit Penal, ku përcaktohet pezullimi i dënimit me burgim, duke analizuar të gjitha kushtet ligjore mbi të cilat është marrë vendimi nga trupi gjykues, ku subjekti Etleva Temo ka qenë anëtare e tij.

Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime shteruese për sa i përket konstatimeve të lartpërmendura dhe nuk ka shkaqe për ngarkimin me përgjegjësi disiplinore në lidhje me aspektin profesional.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLD-SË

29. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Etleva Temo janë paraqitur 4 ankesa (2 në vitin 2014 dhe 2 në vitin 2015) në Inspektoratin e KLD-së.

29.1 Rezulton se 4 ankesat janë arkivuar, 2 ankesa me arsyetimin se pretendimet zgjidheshin përmes apelit gjyqësor, 1 ankesë sepse rezultoi e përsëritur dhe 1 ankesë e paraqitur jashtë afatit.

29.2 Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Etleva Temo, përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

DENONCIMET NGA PUBLIKU

30. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Etleva Temo, janë administruar denoncime nga publiku si vijon:

30.1 Denoncimet:

1 - nr. *** prot., datë 26.1.2018, e shtetasës Xh. Q., e cila ankohet se vendimin e dhënë nga Gjykata e Apelit Korçë, ku subjekti Etleva Temo ka qenë pjesë e trupit gjykues, e konsideron në shkelje, pa marrë parasysh asnjë provë;

2 - nr. *** prot., datë 27.6.2018, e shtetasit S. Gj., i cili ka depozituar dokumentin “rekurs”, ku kërkon prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë si vendim të padrejtë dhe të pa mbështetur në ligj – Komisioni është vënë në dijeni të rekursit;

3 - nr. *** prot., datë 27.12.2018, i shtetasit A. M., i cili denoncon subjektin për fshehje pasurie, pasuri të pajustificuar;

4 - nr. *** prot., datë 14.8.2019, i shtetasve R. D. dhe M. D., të cilët ankohen për trupin gjykues të Gjykatës së Apelit Korçë, ku subjekti Etleva Temo ka qenë pjesë e saj, që ka marrë vendim pa marrë parasysh pretendimet e tyre dhe të pambështetur në ligj;

5 - nr. *** prot., datë 16.12.2019, denoncim “anonim”, i cili ankohet për paaftësi, korrupsion etj., për subjektin Etleva Temo;

6 - nr. *** prot., datë 21.2.2020, denoncim “anonim”, i cili denoncon subjektin për një rast konflikti interesi;

7 - nr. *** prot., datë 18.3.2019, i shtetasit P. D., i cili ankohet për një proces të parregullt ligjor nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, vendim i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë;

8 - nr. *** prot., datë 3.3.2020, është depozituar “kërkesë” po nga shtetasi P. D., i cili kërkon përjashtimin e subjekti Etleva Temo si anëtare e trupit gjykues në një çështje që po gjykohet në Gjykatën e Apelit Korçë;

9 - nr. *** prot., datë 25.7.2020, i shtetasit B. M., i cili ankohet për vendim të padrejtë dhënë nga Gjykata e Apelit Korçë, ku subjekti Etleva Temo ka qenë pjesë e trupit gjykues.

30.2 Komisioni, pasi mori në shqyrtim ankesat e mësipërme, konstaton se pretendohen fakte që kanë lidhje me korrektësinë e vendimeve, korrupsion, fshehje pasurie dhe themelin e çështjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, rrethana të cilat nuk provohen dhe, si të tilla, nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit E, fjalës e fundit, faqja 60 nga 64 e Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016.

Komisioni arrin në përfundimin se në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, këto denoncime nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

30.3 Denoncimi nr. *** prot., datë 8.10.2018, i shtetasës D. N., e cila ankohet në lidhje me trupin gjykues të Gjykatës së Apelit Korçë, ku subjekti Etleva Temo ka qenë pjesë, i cili ka zhvilluar seancat me fshehtësi dhe shpejtësi dhe ka rrëzuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë ku denoncuesja ka qenë fituese.

30.3.1 Komisioni ka administruar dosjen e plotë nga Gjykata e Lartë¹³¹, ku përfshihet edhe dosja e gjykimit në gjykatën e apelit, nga ku ka rezultuar se si datë gjykimi është caktuar seanca e datës 17.4.2018, që sipas dispozitave të nenit 460 të Kodit të Procedurës Civile njoftimi në gjykatën e apelit bëhet me shpallje. Seanca e datës 17.4.2018 nuk është zhvilluar pasi subjekti Etleva Temo, në cilësinë e relatores, nuk ka qenë prezente për arsye shëndetësore. Për sa i përket seancës tjetër të caktuar nga gjykata e apelit në datën 9.5.2018, nga dosja nuk rezulton që gjykata e apelit të ketë kryer njoftimin e palëve në proces (për seancën e shtyrë) apo që të konfirmohet marrja dijani e palëve për këtë seancë, sipas nenit 460 të Kodit të Procedurës Civile.

30.3.2 Komisioni vëren se pretendimi i denoncuases D. N. se nuk është njoftuar nga gjykata e apelit për seancën e datës 17.4.2018 (seanca e parë) nuk mund të vërtetohet, pasi sipas dispozitave të nenit 406¹³² të Kodit të Procedurës Civile palët interesohen pranë gjykatës përkatëse që kanë çështjen dhe njoftohen nga shpallja e publikuar, ndërsa seanca e dytë nuk është kryer sipas dispozitave procedurale.

30.3.3 Komisioni ka konstatuar se gjykata e apelit nuk ka bërë njoftimin e rregullt të palëve sipas dispozitave të parashikuara në Kodit të Procedurës Civile (nenet 129-133 dhe 460) për njoftimet, duke mos siguruar në këtë mënyrë një proces të rregullt gjyqësor.

30.3.4 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj dhe në seancën dëgjimore, ka shpjeguar se njoftimi i palëve është kryer rregullisht, konform nenit 460 të Kodit të Procedurës Civile. Gjithashtu, dispozita e mëparshme (neni 460) parashikonte se: *“Njoftimi për ditën dhe orën e gjykimit të çështjeve bëhet nga gjykata e apelit me shpallje pranë saj dhe në gjykatat përkatëse të shkallës së parë, jo më vonë se 10 ditë përpara shqyrtimit të çështjes”*. Njoftimi personalisht i palëve bëhet vetëm në kushtet e pikës 6 të dispozitës më sipër, të cilat nuk janë në rastin konkret.

Nën këtë arsyetim, pretendimi i denoncuases se nuk është njoftuar nga gjykata e apelit për seancën e datave 17.4.2018 dhe 9.5.2018, nuk qëndron, pasi sipas procedurës palët interesohen pranë gjykatës përkatëse që kanë çështjen dhe njoftohen nga shpallja e publikuar, si dhe nga publikimi në faqen zyrtare të gjykatës.

Pra, gjykata e apelit ka kryer njoftimin sipas ligjit të palëve dhe në asnjë rast nuk është cenuar pala paditëse në të drejtën për të qenë prezent në gjykim.

Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e relatores së çështjes, nuk ka bërë njoftimin e palëve për seancën e radhës, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile dhe konkretisht neneve 129-133 dhe 460, ku parashikohet njoftimi i palëve drejtpërdrejt me fletëthirrje dhe më pas me shpallje.

Kjo mangësi nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e subjektit, por mbetet një element i cili është konsideruar nga trupi gjykues, në vlerësimin tërësor, që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

30.4 Denoncimi nr. * prot., datë 1.11.2018, i shtetasit A. T., i cili ankohet ndaj trupit gjykues në Gjykatën e Apelit Korçë, ku subjekti Etleva Temo është anëtare, pasi në mënyrë abuzive tentojnë të rihapin një proces gjyqësor për të cilin ekziston një vendim i formës së prerë i Gjykatës së Lartë.**

¹³¹ Shkresë nr. *** prot., datë 10.7.2020, e Gjykatës së Lartë.

¹³² Neni 460 i Kodit të Procedurës Civile, në paragrafin III, përcakton: *“Sekretaria e gjykatës së apelit i njofton palët rregullisht (nenet 128 - 133) të paktën 10 ditë më parë, ditën e shqyrtimit të çështjes në apel, si dhe shpall listën përkatëse të çështjeve.”*

30.4.1 Ankuesi ka zhvilluar një seri procesesh gjyqësore të zhvilluara në të gjitha shkallët e gjyqimit¹³³. Pas këtyre proceseve Gjykata e Lartë, me vendimin datë 23.9.2015¹³⁴, ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 30.7.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe vendimin nr. ***, datë 20.12.2010, të Gjykatës së Apelit Korçë, si dhe pranimin e padisë së paditësit A.T., etj.”¹³⁵

30.4.2 Pala kundërshtare ka paraqitur ankesë në Gjykatën Kushtetuese kundër vendimit të datës 23.9.2015 dhe kërkesë “sqarim interpretimi vendimi” në Gjykatën e Lartë, por të dyja gjykatat kanë vendosur rrëzimin e këtyre kërkesave¹³⁶.

30.4.3 Më pas, nga palët e paditura V. Q., etj. në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë është ngritur padia me të paditur A.T., etj., me objekt “interpretim i kontratës së dhurimit nr. ***, datë 3.2.1995”. Në përfundim të shqyrtimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. ***, datë 27.3.2018, ka vendosur *pushimin e gjyqimit*, pasi ka vlerësuar se kjo mosmarrëveshje ka ekzistuar dhe ka gjetur zgjidhje me vendimin nr. ***, datë 23.9.2015, të Kolegjit të Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur *pranimin e padisë së paditësit A.T., etj.*

Gjykata ka konstatuar se midis të njëjtave palë dhe me të njëjtin objekt apo pretendim është zhvilluar një proces gjyqësor, i cili, me vendimin nr. ***, datë 23.9.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është zgjidhur përfundimisht, duke interpretuar nga të tjera aspekte të kontratës së dhurimit nr. ***, datë 3.2.1995, dhe jo referuar neneve 681 - 689 të Kodit Civil. Gjykata e Lartë ka vendosur që me kontratën e dhurimit nr. ***, datë 3.2.1995, është dhuruar vetëm ½ e banesës dhe jo ½ e truallit. Gjykata arsyeton se kemi gjë të gjykuar, pasi ndërmjet të njëjtave palë me të njëjtin objekt në thelb dhe me të njëjtin shkak ligjor Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka disponuar me vendimin nr. ***, datë 23.9.2015, i cili është i formës së prerë dhe jemi përpara një padie që nuk mund të ngrihet dhe gjykata vendos pushimin e gjyqimit.

¹³³ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. ***, datë 30.7.2010, ka vendosur: *Pranimin pjesërisht të padisë; detyrimin e të paditurve V. Q., B. Q. dhe Q. Q., të njohin bashkëpronarë për shkak trashëgimie paditësit A.T., E. G. dhe F. M., mbi pasurinë e paluajtshme me sip. 900 m² në Korçë, dhe konkretisht, të dorëzojnë pjesën prej 202.8 m² nga ky truall; rrëzimin e padisë për pjesët e tjera të saj etj.*

Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. ***, datë 20.12.2010, ka vendosur: *Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 30.7.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, për sa i përket pjesës së rrëzuar të padisë së paditësve A. T. etj.; ndryshimin e pjesës tjetër të këtij vendimi duke vendosur: rrëzimin e padisë së paditësve për sa i përket kërkesës për pasurinë trashëgimore në emër të trashëgimlënësës Dh. M. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë ka ushtruar rekurs paditësi A.T. etj.*

Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 8.2.2012, ka vendosur: *Mospranimin e rekursit të paraqitur nga A.T. etj. kundër vendimit nr. ***, datë 20.12.2010, të Gjykatës së Apelit Korçë.*

Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. ***, datë 5.12.2014, ka vendosur: *Pranimin e kërkesës së A. T.; shfuqizimin e vendimit nr. ***, datë 8.2.2010, të Gjykatës së Lartë; dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.*

¹³⁴ Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 23.9.2015.

¹³⁵ Gjykata e Lartë e ka konsideruar të bazuar përfundimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë pasi është marrë në interpretim të drejtë të përmbajtjes së kontratës së dhurimit me të cilën është disponuar vetëm për ½ pjesë takuese e banesës. Por ky kolegji, referuar dispozitivit të vendimit, e konsideron jo të drejtë, për sa ka vendosur ajo gjykatë, duke detyruar të paditurit të dorëzojnë pjesën prej 202.8 m² të truallit, pasi kjo pjesë është në bashkëpronësi të cilës mund t'i jepet fund vetëm nëpërmjet pjesëtimit të pasurisë dhe jo në këtë gjykim.

¹³⁶ Ndaj këtij vendimi kërkesit V. Q., B. Q. dhe Q. Q. kanë paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, ku kanë kërkuar shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. ***, datë 23.9.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. ***, datë 6.7.2016, ka vendosur: *rrëzimin e kërkesës.* Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 16.11.2016, ka vendosur: *Rrëzimin e kërkesës për sqarim dhe interpretim të vendimit nr. ***, datë 23.9.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.* Gjykata e Lartë ka argumentuar se pretendimet e ngritura nga kërkuesi V. Q. kanë qenë objekt shqyrtimi në gjykimin e çështjes dhe nuk mund të ringrihen në shqyrtimin e kësaj kërkesë për sqarim dhe interpretim vendimi gjyqësor etj.

30.4.4 Paditësi V. Q. ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Korçë, me trup gjykues ku subjekti Etleva Temo ka qenë anëtare dhe me vendimin nr. ***, datë 3.10.2018, Gjykata e Apelit vendosur: *“Prishjen e vendimit nr. ***, datë 27.3.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë të njëjtës gjykatë me tjetër trup gjykues”*. Gjykata e Apelit Korçë vëren se çështja duhet të kthehet për rigjykim pranë po asaj gjykate, por me një tjetër trup gjykues, për shkak të mosrespektimit të dispozitave procedurale mbi pranimin dhe gjykimin e padisë me pasojë mungesën e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes dhe mosshqyrtimit në themel të kërkimeve të parashtruara në padi. Gjykata e apelit vlerëson se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, në kundërshtim me nenet 126 dhe 310/II të Kodit të Procedurës Civile nuk ka marrë në analizë juridike kontratën e lidhur rregullisht, e cila sipas nenit 690 të Kodit Civil ka forcën e ligjit për palët.

30.4.5 Komisioni ka konstatuar se: (i) vendimi i Gjykatës së Apelit Korçë ka mangësi në arsyetim dhe përqendrohet vetëm në aspekte të interpretimit të kontratës së dhurimit, sipas dispozitave të Kodit Civil dhe nuk merr në analizë dhe konsideratë interpretimin e bërë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë për kontratën e dhurimit; (ii) vendimi i dhënë nga Gjykata e Apelit Korçë ka cenuar parimin e sigurisë juridike, pasi kemi një situatë juridike që tashmë është rregulluar dhe zgjidhur nga vendime gjyqësore të formës nga gjykata më të larta dhe nuk mund të cenohet me një vendim tjetër për të njëjtën situatë të analizuar në një kontekst tjetër; (iii) duket se vendimi i dhënë nga Gjykata e Apelit Korçë ka cenuar parimin e gjësë së gjykuar, pasi janë të njëjtat palë dhe është i njëjti dokument (kontratën e dhurimit) i cili është interpretuar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendim të formës së prerë dhe nuk mund të interpretohet përsëri nga një vendim tjetër.

30.4.6 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj dhe në seancë dëgjimore, ndër të tjera, ka shpjeguar se gjykata, nga shqyrtimi i çështjes, do të arrinte në përfundim se jemi përpara “gjësë së gjykuar” dhe duhet të vendoste rrëzimin e padisë, duke i dhënë zgjidhje përfundimtare çështjes, konform nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se: *“... Vendimi që ka marrë formë të prerë ka fuqi vetëm për çka është vendosur midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të gjykohej përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe”*. Duke vendosur pushimin e gjykimit, gjykata në fakt nuk i ka dhënë zgjidhje çështjes, pasi ky vendim, sipas nenit 127 të Kodit të Procedurës Civile, është vendim jo përfundimtar.

Meqenëse paditë në fjalë kanë qenë të ndryshme sa i përket objektit dhe meqenëse vetë gjykata e shkallës së parë pranon në arsyetim se me vendimin e Gjykatës së Lartë është interpretuar kontrata nga të tjera aspekte, ka qenë detyrim i gjykatës t’i japë përgjigje kërkimit të palës duke zhvilluar hetimin gjyqësor dhe duke arsyetuar se meqë këto padi nuk janë të njëjta sa i përket objektit ku qëndron parimi i “gjësë së gjykuar”, referuar pjesës arsyetuese të vendimit të Gjykatës së Lartë, pasi nëse nuk e gjejmë në objekt, mund ta konstatojmë në arsyetim, ku në mënyrë shteruese mund t’u jetë dhënë zgjidhje edhe kërkimeve në shqyrtim dhe nëse kjo konstatohet, gjykata vendos rrëzimin e padisë, si “gjë e gjykuar” dhe jo pushimin e gjykimit si padi që s’mund të ngrihet, sepse duke disponuar me pushim në fakt cenohet parimi i sigurisë juridike dhe “gjësë së gjykuar”, e cila pasohet gjithmonë me rrëzim padie.

Pra, gjykata e apelit ka prishur çështjen për shkaqe procedurale si më sipër, duke i lënë detyrë gjykatës së shkallës së parë të marrë në shqyrtim çështjen dhe të konkludojë për rrëzim apo pranim të padisë. Gjykata e apelit nuk i ka dhënë zgjidhje çështjes në themel dhe, për sa më sipër, nuk ka cenuar parimin e “gjësë së gjykuar” dhe “sigurisë juridike”.

30.4.7 Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga denoncuesi dhe shpjegimet e subjektit, vlerëson se pavarësisht se në pamje të parë Gjykata e Apelit Korçë analizon nën kontekstin procedural vendimmarrjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, arrin në përfundimin se thelbi i denoncimit ka të bëjë me vendimmarrjen e

gjykatës së apelit, ku subjekti është anëtare e trupit gjykues dhe, për pasojë, mban parasysh nenin 72¹³⁷ të ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit Komisioni nuk mund të gjykojë korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe nuk mund të zëvendësojë interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.

30.5 Denoncimi nr. * prot., datë 27.12.2018, i shtetasit A. M.,** i cili ankohet ndaj subjektit të rivlerësimit për fshehje pasurie, udhëtime jashtë vendit me kosto që duhen verifikuar, lëvizjet në sistemin *TIMS* me persona, duke iu krijuar favore në procese gjyqësore.

30.5.1 Komisioni i ka përfshirë shpenzimet financiare në analizën e viteve 2003 - 2016.

30.5.2 Për sa i përket pjesës së denoncimit të lëvizjeve në sistemin *TIMS* me persona që subjekti u ka krijuar favore në procese gjyqësore, Komisioni ka verifikuar në sistemin *TIMS* automjetet me të cilat subjekti dhe personi i lidhur/bashkëshorti A.T. kanë pasur hyrje-dalje jashtë territorit shqiptar.

30.5.3 Pas informacionit të administruar nga sistemi *TIMS* rezulton se personat e lidhur/bashkëshorti A.T. dhe djali A.T. kanë pasur hyrje-dalje nga territori shqiptar në datën 25.1.2015, në pikën kufitare të Kapshticës me automjetin me targa ***, i cili rezulton të jetë në pronësi të shtetasit A.B., i datëlindjes 10.9.1961 (A.T. hyrje-dalje, ndërsa A.T. vetëm dalje).

30.5.4 Në datën 8.1.2009 personat e lidhur me subjektin/bashkëshorti A.T. dhe djali A.T. kanë pasur hyrje-dalje nga territori shqiptar në pikën kufitare të Qafë-Thanës me automjetin me targa ***, ndërsa në datën 31.3.2009, subjekti, bashkë me personin e lidhur/A.T. kanë pasur dalje nga territori shqiptar në pikën kufitare të Qafë-Thanës me automjetin me targa ***, i cili rezulton në pronësi të shtetasit A.M. (ndërsa hyrja në territorin shqiptar rezulton me automjetin me targa ***)).

30.5.5 Nisur nga të dhënat e denoncimit, Komisioni i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe Gjykatës së Apelit Korçë, ku subjekti ka ushtruar detyrën e gjyqtarës dhe ka kërkuar nëse këta dy shtetas kanë pasur çështje gjyqësore me të.

30.5.6 Nga përgjigjja e administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec¹³⁸ rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, ka gjykuar çështje civile të shtetasve A.B. dhe A.M., ku gjykata ka vendosur në favor të tyre¹³⁹.

Nga përgjigjja e administruar nga Gjykata e Apelit Korçë¹⁴⁰ rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtare e trupit gjykues dhe ka gjykuar çështje civile të shtetasit A.B., ku gjykata ka vendosur në favor të tij¹⁴¹.

¹³⁷ Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.

¹³⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 6.7.2020, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, dërguar me postë elektronike.

¹³⁹ Me vendimin nr. ***, datë 29.9.1999, subjekti Etleva Temo ka qenë gjyqtarja që ka gjykuar çështjen civile me palë paditëse A.B. dhe të paditur KKKP-në Pogradec, me objekt “ndryshim vendimi”, ku është vendosur *pranimi i padisë së z. A. B., duke i kthyer një sipërfaqe trualli prej 371.2 m²*; me vendimin nr. ***, datë 5.10.2009, subjekti Etleva Temo ka qenë gjyqtarja e çështjes që ka gjykuar çështjen civile me paditëse L.M. dhe të paditur A.M., me objekt “detyrim njohje bashkëpronar dhe pjesëtim pasurie të luajtshme dhe të paluajtshme”, ku është vendosur *pjesëtimi në natyrë të apartamentit me sip. 35 m², duke i lënë në natyrë apartamentin A.M. dhe detyrimin e tij ti kthejë paditëses pjesën takuese prej ½ në vlerë lekësh 750,000 lekë. Garazhi ndahet duke marrës secili nga një pjesë të vijëzuar.*

¹⁴⁰ Gjykata e Apelit Korçë, me nr. *** prot., datë 6.7.2020.

¹⁴¹ Me vendimin nr. ***, datë 8.6.2016, subjekti Etleva Temo ka qenë anëtare e trupit gjykues që ka gjykuar çështjen civile me paditës A.B. me të paditur BKT, me objekt “detyrimin e të paditurit të përmbushë detyrimet e kontratës së sipërmarrjes etj.” dhe gjykata ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë në favor të paditësit A.B.

30.5.7 Komisioni ka konstatuar se personat e lidhur me subjektin/bashkëshorti A.T. dhe djali A.T. në vitin 2015 kanë udhëtuar me automjetin e shtetasit A.B. me të cilin subjekti ka gjykuar 1 çështje në vitin 1999 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe 1 çështje në vitin 2014, 2 çështje në vitin 2016, 1 çështje në vitin 2017 dhe 1 çështje në vitin 2018 në Gjykatën e Apelit Korçë, ku ka qenë pjesë e trupit gjykues, në të cilën është vendosur në favor të këtij shtetasi, duke u ndodhur kështu në situatën e konfliktit të interesit.

Gjithashtu, në vitin 2009 subjekti Etleva Temo dhe personat e lidhur me të/bashkëshorti dhe djali A.T. kanë udhëtuar me automjetin e shtetasit A.M., ku po në të njëjtin vit subjekti ka gjykuar një çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, ku ka vendosur pjesërisht në favor të tij, duke u ndodhur kështu në situatën e konfliktit të interesit.

30.5.8 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj dhe në seancën dëgjimore, ka shpjeguar se lidhur me shtetasin A.B., në datën 25.1.2015 ka udhëtuar vetëm bashkëshorti dhe djali A.T. brenda ditës në K., Greqi për shkak të afërsisë. Nga shpjegimet e bashkëshortit situata mund të ketë qenë që ai dhe djali, të ndodhur në Kapshticë, kanë kërkuar për taksidhe kanë parë këtë shtetas si pogradecar, i cili duke pasur vend automjet dhe të njëjtin destinacion i ka marrë në mënyrë krejt rastësore. Subjekti nënvizon se një element i rëndësishëm i konfliktit të interesit është dijenia ose situata që në kushte të logjikshme dhe normale një person të ketë dijeni për konfliktin e interesit. Bashkëshorti dhe djali, citon subjekti, nuk kanë pasur asnjë mundësi dhe as të jenë të detyruar të kenë dijeni se ka gjykuar çështje të ndryshme ku ky shtetas ka qenë palë. Në shumë gjykime gjyqtari vjen në dijeni të shkakut të përjashtimit vetëm mbi kërkesën e palëve dhe pasi bën verifikimet përkatëse sipas dispozitave procedurale mund të paraqesë heqjen dorë nga gjykimi, e cila konkurren me kërkesën për përjashtim. Nuk është kërkuar përjashtimi i subjektit për këtë shkak apo për shkaqe të natyrës së konfliktit të interesit.

30.5.9 Në lidhje me shtetasin A.M., nga sistemi *TIMS* rezulton në datën 31.3.2009, në dalje për në Maqedoni, e shënuar automjeti me targa *** dhe në hyrje në Shqipëri, pra në kthim nga Maqedonia, është shënuar automjeti i tyre me targa ***, gjë e cila nuk mund të ndodhë. Kjo mund të jetë pasojë e regjistrimit të gabuar në sistem.

30.5.10 Në datën 8.1.2009, referuar sistemit *TIMS*, rezulton se bashkëshorti dhe djali i subjektit të kenë kaluar në pikën kufitare me automjetin me këtë targë. Edhe për këtë rast qëndron i njëjti argument si për shtetasin A.B., ku mund të ketë qenë situatë me automjete rastësore etj. Subjekti

Me vendimin nr. ***, datë 10.02.2016, subjekti Etleva Temo ka qenë anëtare e trupit gjykues që ka gjykuar çështjen civile me paditës A.B. etj. me të paditur AKKP Tiranë, me objekt “kundërshtimin e vendimit nr. *** të vitit 1994 të KKKP-së Pogradec për pikën 3” dhe gjykata ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec në favor të paditësit A.B. etj.

Me vendimin nr. ***, datë 16.05.2018, subjekti Etleva Temo ka qenë anëtare e trupit gjykues që ka gjykuar çështjen civile me paditës A.B. dhe të paditur shoqërinë e ndërtimit “****” sh.p.k., etj., me objekt “detyrimin e të paditurit të përmbushë detyrimet kontraktore etj.” dhe gjykata ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë në favor të paditësit A.B.

Me vendimin nr. ***, datë 18.12.2014, subjekti Etleva Temo ka qenë anëtare e trupit gjykues që ka gjykuar çështjen civile me paditës A.B. dhe të paditur shoqërinë “****” sh.p.k., etj., me objekt “sigurim padie, detyrim të paditurit shoqëria “****” sh.p.k. të plotësojë detyrimet kontraktuale etj.” dhe me gjykata e apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe pranimin e padisë në favor të paditësit A.B.

Me vendimin nr. ***, datë 28.9.2017, subjekti Etleva Temo ka qenë anëtare e trupit gjykues që ka gjykuar çështjen civile me paditës A.B. dhe të paditur shoqërinë “****” sh.p.k. dhe BKT, me objekt “detyrimin e të paditurit shoqëria “****” sh.p.k. të përmbushë detyrimet kontraktore, marrjen e masës së sigurimit të padisë etj.” dhe gjykata ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të ndërmjetëm të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec në favor të paditësit A.B.

ka përmendur, si më lart, se element i rëndësishëm i konfliktit të interesit është dijenia apo nëse në rrethana logjike ka qenë e detyruar të ketë dijeni për konfliktin e interesit. Siç duket qartazi, subjekti deklaroi se nuk mund të ketë qenë në dijeni se me çfarë automjeti rastësor kanë kaluar bashkëshorti dhe djali për në Strugë. Siç rezultoi nga aktet, ky shtetas ka paraqitur për gjykim çështjen në fjalë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, sipas regjistrimit në datën 24.6.2009 (pra, pas 6 muajsh), ku edhe është disponuar me vendimin datë 5.10.2009. Siç rezultoi nga vendimi ky shtetas ka qenë i përfaqësuar në gjykim nga av. M.A. dhe gjykimi është zhvilluar në prani vetëm të përfaqësuesit, jo të shtetasit A.M. Pra, në asnjë rrethanë dhe për asnjë shkak, citon subjekti, nuk ka qenë në kushtet e nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes. Përveç sa më sipër, Pogradeci është një qytet i vogël dhe nëse do të kishte njohje apo miqësi me këtë shtetas pala tjetër, pra ish-bashkëshortja sipas vendimit, do të kishte kërkuar përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjes, gjë e cila nuk ka ndodhur. Gjithashtu, ky vendim ka marrë formë të prerë pa u ankimuar (citon subjekti).

30.5.11 Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me faktin që ajo apo personat e lidhur me të (bashkëshorti dhe djali i saj) kanë udhëtuar me automjetet e personave me të cilët ka pasur edhe procese gjyqësore. Për Komisionin nuk janë të besueshme shpjegimet e subjektit se në mënyrë rastësore të dy shtetasit A.B. dhe A.M. dhe në padijeni të saj, ndërkohë që në një rast ka udhëtuar edhe vetë subjekti, kanë kaluar rastësisht me automjetet e tyre dhe kanë marrë bashkëshortin dhe djalin e saj dhe rastësisht kanë pasur të njëjtin destinacion vajtje-ardhje jashtë territorit shqiptar, si dhe padijen e saj në lidhje me këto udhëtime.

30.5.12 Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me pretendimin se ka gabim në regjistrim të sistemit për datën 31.3.2009, ku figuron dalje nga territori shqiptar i subjektit dhe bashkëshortit të saj me automjetin me targa *** dhe kthimi (pra, hyrja) në territorin shqiptar është bërë me automjetin e tyre me targa ***, nuk paraqiti asnjë provë për të vërtetuar të kundërtën e këtij pretendimi, por duke mbetur vetëm në karakter deklarativ.

Subjekti nuk ka provuar nëse të dy këta shtetas ushtronin aktivitet shërbimi si taksi në mënyrë që të legjitimoheshin udhëtimet, qoftë edhe rastësore të subjektit dhe personave të lidhur me të, parë kjo në lidhje me situatën e konfliktit të interesit.

Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit është ndodhur në situatën e konfliktit të interesit kur subjekti apo personat e lidhur me to kanë udhëtuar me automjete të shtetasve me të cilët ka zhvilluar procese gjyqësore (në të shumtën e rasteve vendimmarrja ka qenë në favor të tyre), në kundërshtim me ligjin nr. 9367/2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar.

V. VLERËSIMI I ÇËSHTJES NGA TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

1. Trupi gjykues, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, kreut IV dhe nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo:
 - a. ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë;
 - b. ka kryer deklaram të rremë të pasurisë dhe veprime fiktive;
 - c. ka zhvilluar procese gjyqësore në situatë konflikti interesi;

d. nga analiza financiare rezulton se me të ardhurat e fituara nga punësimi saj, personave të lidhur me të, nuk ka pasur burime të mjaftueshme financiare për kryerjen e investimeve dhe të shpenzimeve të deklaruara në shumën -3,216,314 lekë.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

2. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, është e përshtatshme për vazhdimin e ushtrimit të detyrës.
3. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës, kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b, në pikat 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të pikës 1/c të nenit 58 dhe të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Temo, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Korçë.
2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 12.10.2020

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes SHULI
Kryesuese

Olsi KOMICI
Relator

Pamela QIRKO
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj